



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E DEÇANIT
MUNICIPALITY OF DEÇAN
OPSTINA DEÇAN



Raporti i Planit të Integritetit

Hartuese e raportit:

Ajne Iberhysaj

Komuna e Deçanit

2023

Hyrje.....	3
QËLLIMI DHE STRUKTURA E RAPORTIT.....	4
Aspektet organizative.....	4
Kultura organizative.....	4
Rreziqet specifike dhe cënueshmërisë.....	4
Prokurimi.....	5
Komunikimi dhe Informimi.....	5
Rezultatet e anketimit.....	6
Rekomandime.....	10
Shtojcë (Paraqitja rezultateve të anketimit në formë grafike).....	11

Hyrje

Plani i integritetit i përshkruan masat e bazuar në rrezik për arritjen e objektivave të veta brenda komunës së Deçanit, andaj ky plan ka për qëllim fuqizimin e sundimit të ligjit dhe vlerave e standardeve profesionale-zyrtareve. Ky plan konsiderohet pjesë e rëndësishme e proceseve të përgjithshme planifikuese të komunës, që ndërlidhen me planin strategjik për zhvillim institucional, i cili shton aspektin e menaxhimit të rrezikut, përshkruan masat e bazuara në rrezik për arritjen e objektivave të veta të integritetit dhe për fuqizimin e sundimit të ligjit si dhe të vlerave standardeve profesionale.

Plani i integritetit është një mjet për vendosjen dhe verifikimin e integritetit të organizatës dhe është një proces i dokumentuar për të vlerësuar nivelin e cënueshmërisë së një organizate dhe ekspozimin e saj ndaj praktikave jo etike dhe të korrupsionit. Plani është dokument operativ, që ofron masa të mbështetura tek rreziku për të arritur objektivat e integritetit të komunës së Deçanit. Plani paraqet përkushtimin e komunës për të shtuar dhe fuqizuar kontrollet ekzistuese operative në të gjitha aktivitetet, duke u fokusuar në ofrimin e shërbimeve efikase, transparente dhe të orientuar kah qytetari, gjithashtu përmes këtij plani komuna është në një pozitë me të mirë për të siguruar efikasitet, efektshmëri dhe transparencë dhe etikë. Plani përshkruan masat e bazuara në rrezik për arritjen e objektivave të komunës së Deçanit.

Plani i integritetit mundëson:

- Identifikimin e rreziqeve përkatëse të korrupsionit në fushën e punës;
- Vlerësimin e çfarëdo lloji rreziku që mund të paraqes rrezik për shfaqjen e korrupsionit;
- Përcaktimin e masave për të zvogëluar ose eliminuar rreziqet e korrupsionit.

Plani i Integritetit pritet të kontribuojë në mënyrë domethënëse në:

- Rritjen e mundësive që Komuna të arrijë objektivat e saja organizative të përmirësojë rezistencën organizative ndaj korrupsionit dhe do të zvogëlojë/eliminojë mundësitë për korrupsion;
- Përmirësimin e kontrolleve operacionale ndaj shkeljeve të integritetit që do të rrisin efektivitetin, efikasitetin dhe transparencën e të gjitha proceseve, përfshirë ofrimin e shërbimeve;
- Mbajtjen e një sistemi për të siguruar pajtueshmërinë me kërkesat dhe standardet përkatëse ligjore dhe procedurale;
- Krijimin e një mjedisi të brendshëm të favorshëm kundër korrupsion të gjithë stafit në procesin e zhvillimit, zbatimit dhe monitorimit të planeve të integritetit; Plani mbështetet në rezultatet e një planifikimi gjithëpërfshirës për integritetin dhe të një procesi të vlerësimit të rrezikut të bërë nga komuna. Procesi ka përfshirë identifikimin e pikave të dobëta.

QËLLIMI DHE STRUKTURA E RAPORTIT

1. ASPEKTET ORGANIZATIVE

- a) Ndarja/shpërndarja e funksioneve/përgjegjësi
- b) Përshkrimi i vendit të punës dhe detyrave;
- c) Rezultatet në punë, ngritja në pozitë dhe rekrutimi;
- d) Auditimi i brendshëm;
- e) Mekanizmi për ankesa publike;
- f) Mekanizmi i sinjalizuesit;

2. KULTURA ORGANIZATIVE

- a) Kodi i mirësjelljes dhe lidërsipi etik;
- b) Lufta kundër korrupsionit;
- c) Konfliktet e interesit;
- d) Mos-përshtatshmëria e funksioneve;
- e) Dhuratat apo mikpritja;

3. RREZIQET SPECIFIKE DHE CENUESHMËRITË

- a) Vlerësimi i rrezikut të integritetit komunal;
- b) Fushat e thelbësore të funksioneve komunale;
- c) Aktivitetet specifike komunale;
- d) Administrata e përgjithshme komunale;
- e) Llojet e shkeljeve dhe praktikat e dyshuara në aspektin etik me të cilat aktualisht përballlet komuna;

4. PROKURIMI

- a) Drejtësia dhe transparenca e sistemit të prokurimit;

5. KOMUNIKIMI DHE INFORMIMI

- a) Komunikimi;
- b) Informimi;

METODOLOGJIA

Për hartimin e këtij raporti, me autorizimin e kryetarit të komunës, është caktuar zyrtari raportues. Zyrtari është i autorizuar për të përcaktuar natyrën e raportit, për të identifikuar treguesit kryesor që e masin zbatueshmërinë e Planit të Integritetit, përpilimin e pyetësorëve, analizimin e të dhënave, interpretimin e tyre dhe prezantimin e raportit para asamblesë komunale.

Procesi i realizimit të raportit

- Si hap i parë është kryer identifikimi i treguesve që e masin zbtueshmërinë e Planit të Integritetit. Për identifikimin e treguesve është marrë për bazë plani i integritetit ku janë të përfshirë të gjithë treguesit;
- Në hapin e dytë janë nxjerr treguesit dhe është krijuar lista e treguesve;
- Në hapin e tretë janë shpërndarë pyetësorët nëpër drejtori dhe janë intervistuar zyrtarët publik;
- Në hapin e katërt, raporti është, shqyrtuar dhe përgatitur për raportin.

Rezultatet e anketimit

Mbledhja e të dhënave për të gjetur treguesit e integritetit janë bërë në formë të pyetësorit ku janë anketuar zyrtaret komunal me pozita të ndryshme qoftë ato udhëheqëse dhe sektorit të shërbyesve civil. Më poshtë janë llogarit përgjigjet në përqindje për gjithsecilën pyetje :

1) Sa është numri i personelit që ju menaxhoni?

- ✓ 0-5;21%
- ✓ 5-10;.....50%
- ✓ 10-15;.....27%
- ✓ Më shumë se 15.....2%

2) Përvoja juaj profesionale në Institucion është:

- ✓ Deri në 3 vite përvojë.....4%
- ✓ Prej 3 deri në 5 vite përvojë.....26%
- ✓ Prej 5 deri në 10 vite përvojë.....20%
- ✓ Mbi 10 vite përvojë.....50%

3.) Sipas mendimit tuaj, a ka fusha funksionale në Njësinë tuaj ku nuk dihet mirë se kush është përgjegjës për detyra të caktuara?

- ✓ Po.....2%
- ✓ Jo plotësisht.....2%
- ✓ Jo.....65%
- ✓ Nuk mund të bëjë ndonjë gjykim.....31%

4. A ka respektim të procedurave, rregullave të punës nga i gjithë personeli, duke përfshirë mbikëqyrësit?

- ✓ Po.....75%
- ✓ Jo plotësisht.....3%
- ✓ Jo.....2%
- ✓ Nuk mund të bëjë ndonjë gjykim.....20%

5. A ekziston kontroll efektiv të vazhdueshëm mbi zbatimin e detyrave – përmbushje të afateve kohore, duke siguruar cilësi të zbatimit të detyrave, etj.?

- ✓ Ekziston një kontroll rigoroz dhe i vazhdueshëm.....63%
- ✓ Jo gjithmonë.....15%
- ✓ Rrallëherë.....20%
- ✓ Nuk ushtrohet po thuaj asnjë kontroll i këtij lloji..... /
- ✓ Fare nuk ushtrohet një kontroll i tillë.....2%

6. A zbatohen procedurat dhe proceset e rekrutimit siç janë përcaktuara me legjislacionin në fuqi?

- ✓ Po.....80%
- ✓ Deri në një masë.....3%
- ✓ Jo.....7%
- ✓ Nuk mund të gjykoj.....10%

7. A është transparent dhe i drejtë sistemi aktual i shpërblimeve, duke përfshirë edhe nivelet e pagave dhe përfitimet?

- ✓ Po.....75%
- ✓ Jo plotësisht...../
- ✓ Jo...../
- ✓ Nuk mund të gjykoj.....15%

8. A e konsideroni trajnimin dhe proceset tjera të MBNJ si mjaftueshëm të drejta, transparente dhe që nuk mundësojnë shkeljen e integritetit?

- ✓ Po.....27%
- ✓ Jo të gjitha proceset.....13%
- ✓ Jo.....50%
- ✓ Nuk mund të gjykoj.....10%

9. Deri në çfarë mase menaxhmenti i lartë i Institucion është i përkushtuar për një sistem të fortë të kontrollit të brendshëm?

- ✓ Shumë i përkushtuar.....62%
- ✓ Shumë i përkushtuar me fjalë, por më pak me vepra.....2%
- ✓ Në mënyrë selektive.....16%
- ✓ Nuk është i përkushtuar fare.....5%
- ✓ Nuk mund të gjykoj.....15%

10. A i është nënshtruar puna juaj ndonjë inspektimi nga ana e Departamentit të Auditimit të Brendshëm gjatë 2 viteve të kaluara?

- ✓ Po.....98%
- ✓ Jo...../
- ✓ Nuk kam njohuri për këtë gjë.....2%

11. Si rezultat i këtyre auditimeve, a janë ndërmarrë veprime për të korrigjuar sistemet dhe praktikat?

- ✓ Po.....64%
- ✓ Po, pjesërisht.....16%

- ✓ Jo.....5%
- ✓ Nuk kam njohuri për këtë gjë.....15%

12. A ekziston rregullore, procedurë e brendshme për lajmërimin, së cilës i përmbahen në Institucion?

- ✓ Po.....56%
- ✓ Jo.....14%
- ✓ Nuk kam njohuri për këtë gjë.....30%

13. A ka ndonjë Kod të Etikës që zbatohet për punën tuaj?

- ✓ Po.....95%
- ✓ Jo...../
- ✓ Nuk mund të gjykoj.....5%

14. Në rast se ka, a mendoni se ky Kod është i zbatueshëm në punën tuaj të përditshme dhe se mund të ju ndihmojë në zgjidhjen e dilemave etike?

- ✓ Po.....52%
- ✓ Nuk ka zbatim të vërtetë të tij, janë thjeshtë fjalë boshe.....8%
- ✓ Pjesërisht i zbatueshëm.....20%
- ✓ Nuk mund të gjykoj.....20%

15. A ekzistojnë rregulla të qarta në Njësinë tuaj, apo për Institucion në tërësi, mbi kryerjen e aktiviteteve jashtë punës dhe deklarin e të ardhurave shtesë?

- ✓ Po.....80%
- ✓ Jo.....10%
- ✓ Nuk kam njohuri për këtë gjë.....10%

16. A ekziston sistem efikas për kontrollimin e këtyre çështjeve?

- ✓ Po, ekziston.....79%
- ✓ Jo, nuk ekziston sistem i tillë.....1%
- ✓ Ekziston një sistem, por nuk është efikas15%
- ✓ Nuk mund të gjykoj.....5%

17. A ekzistojnë udhëzime/rregullore të qarta në Njësinë tuaj, apo në Institucion mbi deklarin e konfliktit të interesit?

- ✓ Po.....90%
- ✓ Jo.....2%

- ✓ Nuk kam njohuri për këtë gjë.....8%

18.Sa jeni të sigurt që jeni në gjendje të identifikoni konfliktin e interesit kur paraqitet?

- ✓ Shumë i/e sigurt.....95%
✓ Deri diku i/e sigurt.....2%
✓ Nuk jam i/e sigurt.....3%
✓ Mungon/Nuk e di...../

19. Sipas mendimit tuaj, a janë politikat dhe praktikat e komunikimit në Institucion mjaftueshëm transparente?

- ✓ Po.....80%
✓ Deri në një masë; ka nevojë për përmirësime.....12%
✓ Jo.....3%
✓ Nuk mund të gjykoj.....5%

20. A bëhen publike rezultatet e performancës së administratës (p.sh. në Internet, raporte vjetore)?

- ✓ Po.....89%
✓ Pjesërisht, disa janë në dispozicion.....4%
✓ Jo...../
✓ Nuk mund të gjykoj.....7%

Rekomandime

Për të përmirësuar zbatueshmërinë e planit të integritetit, komuna e Deçanit, respektivisht udhëheqësia e saj duhet ta rrisë përkushtimin në secilin departament. Kryetari i komunës duhet të kërkoj nga secili drejtor që të gjejnë forma dhe t'i edukojnë, trajnojnë dhe motivojnë zyrtarët e drejtorisë së vetë për rritjen e zbatueshmërisë. Secili drejtor duhet të raportoj së paku një herë në muaj në këshillin e drejtorëve me problemet që i paraqiten në drejtori në lidhje me integritetin komunal.

Kryetari duhet të themeloj një mekanizëm i cili kujdeset për monitorimin e zbatueshmërisë së planit të integritetit. Zyrtarët përgjegjës për monitorimin e planit të integritetit duhet të jenë të fuqizuar nga kryetari në mënyrë që ata të mos pengohen gjatë kryerjes së detyres së vetë.


Duhet të planifikohen trajnime dhe tryeza të vazhdueshme me zyrtarët komunal me temen e integritetit dhe të korrupsionit në komunë në mënyrë që zyrtarët të mbahen të informuar me informata të freskëta për situatën e integritetit në komunë.

Raporti për progresin e zbatueshmërisë së planit të integritetit duhet të kryhet nga palë të jashtme të pavarura të cilat janë në gjendje të pasqyrojnë situatën reale të progresit.


Drejtoritë që kanë ngecur në zbatueshmërinë e planit të integritetit duhet të marrin masa të menjëhershme për përmirësimin e performances së tyre.

Shtojcë

Paraqitja e rezultateve te anketimit në formë grafike :




2. Përvoja juaj profesionale në Institucion është :







- a. Deri në 3 vite përvojë
- b. Prej 3 deri në 5 vite përvojë
- c. Prej 5 deri në 10 vite përvojë
- d. Mbi 10 vite përvojë



3. Sipas mendimit tuaj, a ka fusha funksionale në Njësinë tuaj ku nuk dihet mirë se kush është përgjegjës për detyra të caktuara?







- a. Po
- b. Jo plotësisht
- c. Jo
- d. Nuk mund të bëjë ndonje gjykim




























REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E DEÇANIT
MUNICIPALITY OF DEÇAN



DRAFT - PLANI LOKAL I TRANSPORTIT RRUGOR 2023-2027

Përmbajtja:

Fushëveprimi i planit.....	4
Korniza ligjore.....	4
Objektivat.....	5
Synimet.....	5
Deçani, qytet ekologjik- meprioritet çiklizmi dhe kultura në trafik.....	6
Infrastruktura e transportit.....	7
Transporti ndër-urban.....	9
Vend-parkingjet.....	9
Infrastruktura rrugore.....	10
Transporti publik.....	10
Transporti i pa motorizuar-këmbësor dhe biçikleta.....	11
Parkimi.....	11
Zhvillimi infrastrukturës.....	12
Analiza e gjendjes ekzituese.....	12
Siguria në trafik.....	12
Sinjalizimi horizontal dhe vertikal.....	13
Trafiku për këmbësorë.....	13
Trafiku për çiklistë.....	13
Transporti kolektiv (publiko-privat).....	15
Ngarkesa e trafikut.....	15
Infrastruktura rrugore për personat me nevoja ndryshe.....	16
Siguria në trafik në afërsi të shkollave.....	17
Infrastruktura moderne-qendra e qytetit të Deçanit.....	18
Krijimi i shtigjeve për çiklistë.....	24
Mirëmbatja.....	24
Plani i monitorimit.....	25
Plani i veprimit	26

Indeksi i hartave

- Harta 1: Rrjeti i rrugëve në komunën e Deçanit
- Harta 2: Transporti publik në komunën e Deçanit

Indeksi i grafikut

- Grafiku 1: Ngarkesa e trafikut

Indeksi i fotove

- Foto 1,2,3, 4,5,6 Qendra e qytetit

Indeksi i tabelave

- Plani i veprimit, prioriteti dhe aktivitetet për periudhën 2023-2027

1. FUSHËVEPRIMI I PLANIT

Plani Lokal i Transportit Rrugor është një plan strategjik zhvillimor nga fusha e komunikacionit për komunën e Deçanit. Me këtë plan, tentohet fillimi i planifikimit të transportit rrugor të qëndrueshëm dhe të sigurt për të gjithë pjesëmarrësit në komunikacion. Nga aspekti i komunikacionit, ky plan do të shërbejë si bazë e mirë për përpilimin e planeve dhe projekteve në komunën e Deçanit, të cilat ndërlidhen me fushën e komunikacionit.

Gjatë hartimit të planit janë marrë në konsideratë trendët dhe zhvillimet më bashkëkohore në fushën e komunikacionit të qëndrueshëm urban dhe rural. Në këtë mënyrë, realizimi i Planit Lokal të Transportit Rrugor për komunën e Deçanit ka për qëllim uljen e shkallës së motorizimit, duke promovuar forma të tjera të lëvizjes, si zhvillimin e çiklizmit dhe krijimin e hapësirave për ecje në këmbë, përkatësisht krijimin e kushteve infrastrukturore me qëllim të akomodimit të gjithë pjesëmarrësve në komunikacion. Sfidat e planifikimit bashkëkohor në pjesën urbane ka të bëjë me sfidat ditore për përmbushjen e kërkesave për lëvizje, përkatësisht gjetjen e alternativave ambientale të qëndrueshme dhe krijimin e kushteve për lëvizje të lirë dhe të sigurt për të gjithë pjesëmarrësit në trafik. Ndërgjegjësimi i rritur i qytetarëve lidhur me përdorimin e mënyrave aktive, të pastra dhe efikase të transportit, si ecja, çiklizmi dhe transporti publik, siguron një mënyrë më të efektshme për përmbushjen e kërkesave për lëvizje ditore.

Hartimi i Planit Lokal të Transportit Rrugor mundëson krijimin e një sistemi të qëndrueshëm të sistemit të transportit dhe lëvizjeve të tjera (lëvizjeve të motorizuara dhe të pa motorizuara) me qëllim që të krijojnë:

- sigurimin e qasjes sa më të lehtë për lëvizjet ditore dhe shërbime të tjera
- përmirësimin e shkallës së sigurisë
- zvogëlimin e ndotjes së ambientit
- rritjen e efikasitetit dhe ekonomikitetit gjatë transportit të njerëzve dhe të mallrave
- rritjen e atraktivitetit dhe kualitetin e mjedisit urban.

Në komunën e Deçanit, me këtë plan përcaktohen qartë objektivat për zhvillim të qëndrueshëm të infrastrukturës së transportit në tërësi, për ndërtimin e rrugëve funksionale, që lidhen me fshatrat dhe komunat e tjera, me çka do të krijohen kushte për transport të sigurt dhe respektimin e kriterëve të nevojshme për ruajtjen e mjedisit jetësor. Me këtë plan, përveç çështjeve thelbësore që kanë të bëjnë me infrastrukturën e transportit, me ndërtimin e kapaciteteve për zbatimin e saj, janë paraparë aktivitete të tjera përkatëse të Komunës së Deçanit.

2. KORNIZA LIGJORE

Plani Lokal i Transportit Rrugor për komunën e Deçanit është dokument i cili duhet të promovojë interesat përbashkëta të banorëve të Deçanit, për lëvizje të lirë dhe të sigurt për të gjithë pjesëmarrësit në trafik, për përmirësimin e cilësisë së jetesës, krijimin e ambientit të pastër dhe të shëndoshë mjedisor dhe social.

Plani Lokal i Transportit Rrugor për komunën e Deçanit bazohet në kornizën ligjore në fuqi në Kosovë si:

- Ligji Nr. 02/L-70 për Sigurinë në komunikacionin rrugor
- Ligji Nr. 2004/1 dhe Ligji nr. 04/L-179, 16 maj 2013, për Transportin rrugor
- Ligji Nr. 2003/11 mbi rrugët
- Ligji Nr. 03/L-040 për vetëqeverisje lokale
- Ligji Nr. 04/L-076 për policinë
- Ligji Nr. 2012/04-L-174 për planifikimin hapësinor
- Ligji Nr. 03/L-160 për mbrojtjen e ajrit nga ndotja
- Ligji Nr. 03/L-025 për mbrojtjen e mjedisit.

3. OBJEKTIVAT

- Lidhja me komunat e tjera dhe rrugët e komunës së Deçanit, përmirësimi, zhvillimi dhe mirëmbajta e infrastrukturës së transportit.
- Përmirësimi i kualitetit të shërbimeve, krijimi i ambientit të favorshëm dhe të sigurt rregullativë për ngritjen e cilësisë së shërbimeve në fushën e transportit.
- Përmirësimi i sigurisë në komunikacion dhe i mbrojtjes së mjedisit¹.

3.1 SYNIMET

- Ndërtimi i shtigjeve për çiklistë dhe këmbësorë përgjatë rrugëve
- Ndërtim i shiritave të gjelbër përgjatë rrugëve (Rr. Manastirit, Rr. Fatmir Nimonaj, Rr. Ulëzave që lidhë me fshatin Hulaj) etj.
- Zgjerimi i infrastrukturës rrugore për bjeshkët e Deçanit (bjeshka e Madhe), Rregullimi i Rrugës për vendbanimin e Pleqës me infrastrukturë përcjellëse, bjeshka e Roshkodolit etj.
- Mirëmbajta e rrugëve të bjeshkëve dhe hapja e rrugëve të reja dhe lidhja me shtetet fqinj (Mali i Zi –Shqipëri).
- Ndërtimi i qendrës së qytetit – infrastrukture moderne
- Sigurimi i një sistemi ambientaltë qëndrueshëm të lëvizjes duke dekurajuar përdorimin e automjeteve private dhe duke inkurajuar transportin publike, ecjen dhe çiklizmin.
- përkrahja e transportit me autobusë apo me minibusë me qëllim të përparimit dhe forcimit të tijsi formë kryesore e lëvizjes.
- largimi i ndotjes dhe zhurmës nga zonat e banimit, posaçërisht nga zona e ndjeshme urbaneme qëllim të rritjes së cilësisë të jetesës por edhe zvogëlimit të ndikimit të gazrave të rrezikshmenë mjedis.
- përkrahja e përdorimit të biçikletave si mjet transporti, sigurimi i hapësirës së nevojshme dhedhënia e përparësisë në trafik.

¹**Sqarim:** Pajisja e rrugëve me sinjalizim horizontal dhe vertikal, vendosja e tabelave informuese për vendbanimeve si dhe vendosja e qetësuesve të trafikut të institucioneve me rëndësi të veçanta (afërsi të shkollave policët e shtrirë)

4. DEÇANI , QYTET EKOLOGJIK-ME PRIORITET ÇIKLIZMIT DHE KULTURA NË TRAFIK

Vizioni:Deçani, qytet ekologjik me vlera të trashëgimisë kulturore dhe destinacion turistik, i cili siguron qasje të lirë dhe të sigurt për të gjithë pjesëmarrësit në trafik; me ambient të pastër dhe kushte të mira për jetë të shëndetshme.

Në kuadër të plotësimit të vizionit për komunën e Deçanit, janë përcaktuar pesë objektiva strategjike kryesore. Secila prej objektivave strategjike shtjellohet me anë të politikave përkatëse të cilat do të trajtohen gjatë hartimit dhe finalizimit të Planit i Transportit Lokal Rrugor 2023-2027.

Objektivi 1 - Rritja e sigurisë në trafik

Përcaktimi i masave teknike për rritjen e sigurisë në trafik dhe të çështjeve me interes do të ndihmojë institucionet në nivelin komunal në përcaktimin e prioritetëve, veçanërisht në afërsi të shkollave. Pas evidentimit të vendeve në afërsi të shkollave, të cilat konsiderohen si vende me rrezikshmëri të lartë, do të përdoren metodat dhe masat e përshtatshme për qetësimin e trafikut.

Objektivi 2 - Zhvillimin e sistemit për rregullimin dhe menaxhimin e trafikut

Cilësia e infrastrukturës në sektorin e transportit dhe rrugëve urbane është gjithashtu një nga objektivat e rëndësishëm për realizimin e projektit të qendrës dhe rregullimit të pjesës rurale.

Një plan i tillë duhet të realizohet për të siguruar në mënyrë të veçantë:

- Përmirësimin e kushteve të qarkullimit për të gjithë pjesëmarrësit në trafik (zvogëlimin e aksidenteve rrugore, vendosja e tabelave informuese, vendosja e ndriçimit të mjaftueshëm në pikate zeza) etj.
- zvogëlimin e ndotjes dhe respektimin e vlerave mjedisore
- zvogëlimin e shpenzimeve publike dhe private
- përshtatjen e infrastrukturës për personat me nevojë ndryshe (ndërtimi i hyrjeve dhe daljeve me laura dhe vendosja e sinjalistikës për personat me nevojë ndryshe).

Në rregullimin e udhëkryqeve të trafikut në pjesën rurale. Problemet e parkingjeve dhe dislokimi i tyre, si p.sh. parkingu në afërsi të rreth rrotullimit në qendër të Deçanit që do të jetë nëntokësor, përkatësisht në afërsi të objekteve tregtare, parkingu në institucionet publike dhe objektet e banimit kolektiv do të jenë në kuadër të rregullimit dhe menaxhimit të trafikut.

Rrjeti rrugor në komunën e Deçanit nuk i plotëson kushtet për lëvizje të lirë dhe një jetë më cilësore për persona me nevojë ndryshe dhe familjet e tyre. Kërkohej planifikim për shmangien e barrierave dhe për largimin e barrierave ekzistuese në ndërtim, transport dhe infrastrukturë rrugore, duke rishikuar dhe siguruar qasje të lehtë dhe të sigurt duke i ndërtuar hyrjet dhe daljet laura dhe vendosja e sinjalistikës për personat me nevojë ndryshe.

Objektivi 3 - Krijimi i sipërfaqeve të lira për lëvizje të pa motorizuara dhe rekreacion

Ecja në këmbë është forma më e vjetër dhe më universale e udhëtimit. Që njerëzit të ecin në mënyrë të sigurt, të përshtatshme, efikase dhe të qetë, u nevojitet një mjedis dhe infrastrukturë e projektuar mirë, e cila i përmbushë nevojat e tyre për lëvizje të lirë. Një vend i privilegjuar që zotëron qyteti i Deçanit është rruga e UÇK-së dhe shëtitorja përgjatë Lumëbardhit në të dy anët e saj, përkatësisht zona më atraktive e qytetit. Një pjesë e kësaj rruge, kryesisht gjatë verës shndërrohet në shëtitore dhe zonë të qetë që shërben si vend ecjepër qytetarët.

Objektivi 4 - Krijimi i shtigjeve për çiklistë

Një nga objektivat më të rëndësishëm në kuadër të këtij plani ka për qëllim rritjen e përdoruesve të biçikletave në qytetin e Deçanit dhe ndërlidhjen funksionale të shtigjeve për çiklistë me fshatrat. Me këtë objektiv synohet zvogëlimi i trafikut, rritja e cilësisë së ajrit, ulja e kërkesës për parkim dhe përmirësimi i shëndetit publik. Kjo do të arrihet duke krijuar shtigje të reja për çiklistë, duke përmirësuar sigurinë e çiklizmit dhe institucionalizimin e çiklizmit, ku komuna e Deçanit ka përfituar donacion për përdorim të biçikletave nga qytetaret gjatë ditës.

Objektivi 5 - Përshtatja e infrastrukturës rrugore për presona me nevoja ndryshe

Në kuadër të këtij plani, vëmendja është përqendruar më tepër në përshtatjen e infrastrukturës rrugore për personat me nevoja ndryshe, sidomos në kalimet në rrugë dhe në vendkalimet për këmbësorë (vendosja e sinjalistikës për personat me nevoja ndryshe).

5. INFRASTRUKTURA E TRANSPORTIT

Transporti i njerëzve dhe i mallrave në territorin e komunës së Deçanit bëhet përmes transportit rrugor ndërsa ai hekurudhor nuk është i pranishëm. Komuna e Deçanit posedon një rrjet të rrugëve që ofrojnë lidhje të mira me komunat e tjera dhe shtetet fqinje.

Rrjeti i rrugëve nacionale dhe rajonale që administrohen nga niveli qendror, është: 69.5 km në total brenda komunës është në gjatësi prej 405 km. Rrugët lokale janë në gjatësi prej 335.5 km dhe janë përgjegjësi e komunës. Të asfaltuara në komunën e Deçanit janë: 280 km dhe të pa asfaltuara janë: 55.5 km.


Gjithsej rrugë të emëruara në komunën e Deçanit janë: 593 rrugë nga këto 19 rrugë të pa emëruara me kode dhe të emëruara gjithsej janë: 574 rrugë, ku në total gjatësia e tyre është: 405 km.

Kompanitë private të licencuara nga Ministria e Infrastrukturës Rrugore u ofrojnë shërbime qytetareve për linjat urbane dhe linjat ndërurbane, ndërsa nuk ofron shërbim nga stacioni i autobusëve, i cili ekziston si objekt por nuk shfrytëzohet kurse shërbim urban brenda territorit të komunës së Deçanit realizohet edhe nga komibuset privat dhe taksitë private (veturat e vogla).

Analizës së transportit për komunën e Deçanit i paraprin studimi i projektit Mobkos, duke analizuar zhvillimet dhe formën urbane-rurale dhe ndërurbane: shfrytëzimin e tokës, qasjen në pjesë të ndryshme të qytetit, fshatrat, pjesët malore-bjeshkët përparësitë, potencialet dhe sfidat për zhvillim të ardhshëm.²


²Draft Plani Zhvillimor Komunal 2023- 2028

Harta 1-RrjetirrugorënëKomunëDeçani



6. TRANSPORTI NDËR-URBAN

Transporti ndër-urban i udhëtarëve ka për shërbim një mini-stacion të autobusëve si dhe disa vend parkingje për taxi. Linjat e autobusëve që qarkullojnë dhe shërbejnë për qytetarët e Deçanit, janë kryesisht ato të linjave tranzite Pejë-Gjakovë-Prizren dhe disa linja Deçan-Pejë-Prishtinë, ku mbledhja e udhëtareve behet ne mini stacione të cilat me përfundim e qendrës se qytetit do të ndryshohen këto mini stacione (fshatin Strellc i Epërm, Lëbushë, Isniq, Carrabreg, Prejlep, Rastavicë dhe Baballoq) etj...



Harta 2-Transporti publik në Komunën Deçan

7. VEND-PARKINGJET

Në komunën e Deçanit janë katër lokacione të parkingjeve, prej cilave dy parkingje janë publike (hapësira në komune dhe hapësira te objekti i postës) kurse dy parkingje të tjera janë: përballë objektit të banimit kolektiv “Gogaj” në Rrugën “Jashar Salihu” dhe tjetri në rrugën “Sali Çeku”, këto katër lokacione me parkingje kanë hapësirë për prej 280 vend parkingje. E domosdoshme në komunën e Deçanit, të planifikohen, lokacione për parkingje.

8. INFRASTRUKTURA RRUGORE

Pozita gjeografike e komunës së Deçanit në të cilën kalojnë rrugë të rëndësishme rajonale dhe nacionale, si dhe rrjeti rrugor lokal mundëson komunikim të mirë dhe mjaft efikas me të gjitha vendbanimet e territorit.

Në komunën e Deçanit ekziston niveli i katër kategorive të rrugëve (të klasifikuara në Kosovë), duke filluar prej rrugëve nacionale e deri tek ato të pa kategorizuara.

Rrjeta e rrugëve në komunën e Deçanit përbehet nga:

- **Rrugët nacionale** – R 107 (Deçan-Mali i Zi), kjo rrugë lidh Deçanin me shtetin fqinjë Malin e Zi.
- **Rrugë regjionale** – në territorin e komunës së Deçanit, është rruga Deçan-Pejë-Gjakovë dhe Rruga Deçan-Junik-Shqipëri, të cilat lidhin me qendrat me rëndësi ekonomike të dy apo me tepër rajoneve, apo qendrave administrative brenda, apo jashtë vendit.
- Gjithashtu edhe planifikimi i autostradës së Dukagjinit ka mbetur si projekt propozim që duhet të bëhet fizibiliteti dhe hapat e mëtejshme konkrete për realizmin e këtij projekt propozimi nga niveli qendror ku në draftin e PZHK –së është bashkëngjitur në rrjetin rrugor të komunës.
- **Rrugë lokale**-rrugët të cilat lidhin 38 vendbanime, duke përfshirë edhe rrugët që lidhin lagjet më të rëndësishme të vendbanimeve, këto rrugë lidhin qendrën e qytetit me të gjitha pjesët e zonave rurale, po ashtu, krijojnë qasje të mirë edhe për rrugët nacionale/regjionale.
- **Rrugë të pa kategorizuara**- të cilat lidhin me rrjetin e rrugëve urbane dhe rurale me të gjitha hapësirat në të cilat zhvillohen aktivitete socio-ekonomike brenda territorit të komunës.

9. TRANSPORTI PUBLIK

Transporti publik bëhet nëpërmes autobusëve dhe minibusëve, nga operatorët privatkurse me vendbanimet e komunës bëhet edhe me minibus.

Në tërë territorin e komunës së Deçanit pika ndaluese për automjete e transportit publik janë gjithsej 72, kurse pika ndaluese të pajisura me shenjëzim për automjetet e transportit publik lokal janë 70, kurse numri i automjeteve motorike të regjistruar si taksi-kombibus janë 13.

Transporti publik do të vazhdojë të ofrojë shërbim nga operatorët privatë, sidomos në drejtim të zonës urbane dhe zonave rurale, si dhe qendrave të tjera.

10. TRANSPORTI I PA MOTORIZUAR- KËMBËSORË DHE BIÇIKLETA

Rrjeti i shtigjeve për këmbësore, biçikleta dhe hapësira publike duhet t'i kushtohet një planifikim i detajuar sipas modelit multimodal (avancim i transportit) dhe ndërlidhjes përmes hapësirave publike, parqeve dhe shtigjeve gjithashtu t'i kushtohet rendësi edhe lëvizjes së personave me nevojë ndryshe.

Komuna e Deçanit duhet të parasheh edhe këto kushte planifikuese:

- Infrastruktura rrugore duhet të planifikohet në shkallë të përshtatshme në harmoni me funksion të qendrave dhe kërkesave kombëtare e regjionale.
- Gjatë procesit të përcaktimit të zonave të ndërtimit, duhet të dëshmohet se është shmangur kostoja e lartë në masat zhvillimore dhe mirëmbajtje. Ndërtimi duhet t'i respektojë rregullativat për një ndërtim të qëndrueshëm – orientimi, mbrojtje të mjedisit etj.
- Koncepti detaj i mobilitetit (përfshirë edhe transportin publik, këmbësor dhe trafikun për çiklist) Ky koncept duhet të përcillet me plan detaj për zhvillim turistik.
- Problemet teknike lidhur me sigurinë e rrugëve (gjerësia e rrugëve, kalimet e rrezikshme, pjerrtësia), dukshmëria duhet të përfshihen dhe të lehtësohen me masa të përshtatshme.

11. PARKIMI

Në përgjithësi në komunën e Deçanit parkimi është problem që paraqitet në pjesën urbane, konkretisht në qendër të qytetit ku dihet se nuk ka një hapësirë të përcaktuar që i plotëson kushtet dhe kriteret për parkim publik kjo gjendje është si pasojë e mungesës së pronave komunale.

Hapësirat ekzistuese që shërbejnë si parkime janë në pronë private dhe ndërtesave të banimit kolektive dhe qendrave tregtare-bizneseve.

Komuna e Deçanit parasheh që në të ardhmen në qendër të qytetit do të ketë një parkim nëntokësor me dy etazhe, ku parashihet zgjidhja e problemit të parkimit publik. Ky projekt parashihet të realizohet nga viti 2024.

12. ZHVILLIMI I INFRASTRUKTURËS

Është njëra ndër segmentet bazike për zhvillimin e kësaj hapësire e cila ndikon direkt në përmbushjen e objektivave të parashikuar në të gjitha fushat. Këtu shihet nevojë për ndërtimin e autostradës së Dukagjinit, ndërtimi i rrugës Deçan-Kufiri me Maline Zi si aortë kryesore e zhvillimit të kësaj komune, pastaj ndërtim i rrugëve në zonat e bjeshkëve zgjerimi i tyre, vazhdimi dhe përmirësimi i të gjitha rrugëve ekzistuese, shtigjeve të ecjes dhe koordinimit me pikat ndërkufitare.

Me arritjen e zhvillimit efikas të infrastrukturës do të thotë jo vetëm mundësia e një qarkullimi të lirë dhe furnizimi të kërkuar, por edhe arritja e një ambienti të pastër pa ndotje me menaxhimin e duhur të mbeturinave, ngritjen e standardit me garantimin e energjisë elektrike duke stimuluar

energjinë e ripërtërishme dhe një zhvillimi të integruar të arrihet kualiteti i një jete me standardet më të larta ku zënë vend edhe sistemi teknologjik i avancuar i cili e kategorizon në të ardhmen Qytetin e Deçanit në rangun e “ Qytet i mençur”. Rol të rëndësishëm që komuna e Deçanit të jetë në grupin e qyteteve të mençura mundësohet përmes rrjetëzimit të qendrave informuese turistike dhe bashkëpunimit ndër komunal dhe ndërkufitar të transportit rrugor.

13. ANALIZA E GJENDJES EKZISTUESE

Gjendja ekzistuese e trafikut në komunën e Deçanit është vlerësuar e mirë. Gjatë analizës së gjendjes ekzistuese në trafik janë trajtuar problemet kryesore nga fusha e trafikut dhe transportit në komunën e Deçanit. Nga analiza e bërë, si dhe bazuar edhe në vërtetimet e pjesshme të bëra në terren nga inxhinieret komunal, është evidentuar se disa pjesë të rrugëve kanë nevojë për mirëmbajtje dhe rehabilitim.

Këto rrugë për momentin mirëmbahen me fonde të kufizuara, sidomos mirëmbajtja e sinjalizimit të rrugëve. Mund të pritët që, gjendja e tyre të përqendësohet shumë shpejt dhe të ulët shkalla e sigurisë rrugore, nëse në vitet e ardhshme nuk vihen në dispozicion fonde të mjaftueshme për këtë qëllim.

14. SIGURIA NË TRAFIK

Me qëllim që të kemi një pasqyrë më të qartë të gjendjes ekzistuese të sigurisë në komunën e Deçanit, nga Policia e Kosovës janë marrë të dhënat për numrin e aksidenteve, pasojat dhe faktorët të cilët kanë shkaktuar aksidente. Prandaj, burimi i statistikave të prezantuara në këtë kapitull është siguruar nga sistemi informativ i Policisë së Kosovës - Stacioni Policor në Deçan. Gjithnjë duke u bazuar në të dhënat e Policisë së Kosovës, numri i përgjithshëm i aksidenteve në komunën e Deçanit është në formë tabelore e paraqitur.

	2019	2020	2021	2022	2023	Totali
Aksidente me dëme materiale	21	17	17	25	9	89
Aksidente me lëndime	92	89	107	120	61	469
Aksidente fatale	2	2	0	2	2	8
Persona të lënduar	255	192	255	267	156	1125
Persona të vdekur	2	2	0	2	2	8
Totali	115	108	124	147	72	566

15.SINJALIZIMI HORIZONTAL DHE VERTIKAL

Gjendja e sinjalizimit horizontal dhe vertikal në komunën e Deçanit nuk është në nivel të duhur. Sinjalizimi horizontal në shumicën e vendkalimeve për këmbësorë në disa vendkalime është konsumuar dhe ka pjesë të rrugëve mezi vërehet si vend i caktuar për kalimin e këmbësorëve. Vijat gjatësore të rrugëve dhe shigjetat e drejtimit vërehen jo aq dukshëm. Në disa pjesë të rrugëve në pjesën rurale mungon sinjalizimi horizontal, rrjeti rrugor në komunën e Deçanit në pjesë rurale ka disa fshatra që nuk janë të pajisur me sinjalizimin përkatës vertikale.

Në pikat karakteristike të rrjetit rrugor gjithashtu në pjesën rurale është vërejturedhe mungesa e shenjave të drejtimit,përkatësisht emërtimi i vendbanimeve-tabela të dëmtuara. Vlen të theksohet se edhe disa prej shenjave ekzistuese të drejtimit nuk i përgjigjen niveleve të informimitjanëdëmtuar, me këtë rast shkaktohet konfuzitet në orientim, sidomos për drejtuesit mjeteve të cilët nuk kanë njohuri paraprake me kushtet e rrugës dhe të terrenit.

16.TRAFIKU PËR KËMBËSORË

Në qytetin e Deçanit, sipërfaqet për lëvizje të këmbësorëve janë relativisht të kënaqshme. Trotualet shtrihen përgjatë rrugës kryesore në të dy anët e rrugës dhe janë të ndara fizikisht nga pjesa e rrugës në të cilën lëvizin automjetet dhe mundësojnë lëvizje të lirë dhe të sigurt.

Zona më e frekuentuar e qendrës së qytetit është me gjerësi të mjaftueshme dhe në sipërfaqet e dedikuara për këmbësorë mundësohen lëvizje për këmbësorë por mungojnë shtigje të përshtatshme të shënuara për çiklistë. Me ndërtimine qendrës së qytetit t'i jepet prioritet shtigjeve për çiklistë.

Nga ana tjetër, në disa pjesë periferike dhe pjesën rurale të qytetit të Deçanit mungojnë trotualet po ashtu në disa pjesë të rrugëve, konsiderohet si e rrezikshme.

17.TRAFIKU PËR ÇIKLISTË

Qytetarët e Deçanit janë të favorizuar nga terreni i rrafshët i qytetit dhe shtrirja e madhe e këtij terreni në drejtim të fshatrave përreth. Por, përkundër këtij terreni mjaft tëpërshtatshëm për zhvillimin e çiklizmit, një formë e tillë e lëvizjes nuk është promovuar sa duhet. Nëkuadër të draft Planit Zhvillimor Komunal që është duke u hartuar ku janë paraparë shtigjet për çiklistë, ku është ndërtuar shtegu me gjatësi 2km për çiklist.Nga disa të dhëna të përafërta të siguruara nga Shoqata e Çiklistëve në Deçan rrjedh se numrii çiklistëve aktiv në këtë komunë është rreth 30 çiklistë, por me qëllim që të masivizohet në tëardhmen lëvizja me biçikleta, është kërkuar krijimi i kushteve për lëvizje të sigurt, ku Qendra për Turizëm afron biçikleta për dashamirët e natyrës, ku numri i tyre është simbolik.

Me qëllim të analizës dhe vlerësimit të elementeve gjeometrike të rrugës, ku planifikuesit në terren duhet për të vlerësuar si të domosdoshme dhe prioritet që profilet të jenë të mjaftueshëm të rrugëve dhe ndërlidhjen funksionale të qytetit të Deçanit me fshatrat me anë të shtigjeve për biçikletë, lidhjen e vendeve me trashëgimi kulturore, Dranoc, Isniq, Dubovik dhe Gllogjan.

Drejtoria për Zhvillimin Ekonomik, shtigjet për biçikleta i ka paraqitur në platformat më të kërkuara siç është OpenStreetMap, aty ku orientohen pothuajse i tërë komuniteti bjeshkatar e në veçanti komuniteti i çiklistëve! Tani edhe më tej po punohet në pjesën teknike që këto shtigje të jenë së shpejti të qasshme për dashamirët e sportit të çiklizmit!


Kjo nismë përfshinë katër shtigje, të cilat janë emëruar si në vijim:

1. Shtegu i “Fluturave”
2. Shtegu “Liçeni i Dukagjinit”
3. Shtegu “Rruga e Gurtë”
4. Shtegu “Gushavci”.

Nga kjo nismë përfitojnë të gjithë qytetarët dhe turistët, ku tani e tutje kanë mundësi që këtë sport ta ushtrojnë edhe në qytetin e Deçanit!

Deçani po përmbushet çdo ditë dhe po merr formatin e një destinacioni favorit turistik dhe vendor!

Deçani, një destinacion i shkëlqyer i natyrës!



18. TRANSPORTI KOLEKTIV(PUBLIKO-PRIVAT)

Pas viti 1999, në komunën e Deçanit transporti publik ishte organizuar përmes kompanisë publike për transportin publik, me ato mjete që kishin mbetur nga N.T.P. “Kosovatransi” deri në privatizim të kësaj kompanie, pastaj në mënyrë graduale filluan që të operojnë edhe transportuesit privat. Sot në komunën e Deçanit operojnë disa kompani të transportit privat, të cilat e mbulojnë territorin e Komunës së Deçanit. Operatorët transportues privat respektojnë linjat e caktuara duke respektuar edhe orarin i cili paraprakisht është i publikuar.

Linjat brenda territorit të komunës janë:

- Deçan – Gramqel-Shaptej-Glllogjan-Irznik-Prejlep
- Deçan –Pobergjë-Voksh-Dranoc-Sllup
- Deçan –Isniq-Prapaqan-Papiq
- Deçan-Irznik-Ratishë.

Linjat jashtë territorit të komunës janë:

- Deçan- Pejë-Prishtinë
- Deçan-Gjakovë-Prizren

Transporti me autobus organizohet në disa forma dhe atë: transport ndërkombëtar, transport nder urban dhe transport urbano-periferik.

Këto kategori janë të ndara edhe sipas menaxhimit, ku transporti ndërkombëtar dhe nder urban menaxhohet nga Ministria e Infrastrukturës, kurse transporti urbano-periferik menaxhohet nga komuna. Përveç linjave të rregullta, gjatë sezonit të verës kemi linjat për shumicën e qyteteve bregdetare të Shqipërisë dhe për Ulqin. Linjë e rregullt ditore është edhe linja Deçan– Tiranë dhe Deçan-Durrës. Në mungesë të autobusëve nëpër disa fshatra ku ka lëvizshmëri më të vogël, linjat janë të mbuluar me kombibus privat, të cilët pajisen me leje nga DMSHSH.


19. NGARKESA E TRAFIKUT

Për nevojat praktike janë të rëndësishme së veçantë karakteristikat e mospërputhshmërisë kohore të qarkullimit të automjeteve në periudha të ndryshme kohore. Periudha dhe zgjatja e numërimit varet nga qëllimet dhe mënyra e planifikimit. Rezultatet më të mira do të fitohen kur numërimi të bëhet përmes numëruesve automatik, në periudha më të gjata kohore (12 ose 24 orë në tërësi). Në mungesë të kohës dhe kufizimeve të tjera, për nevojat të ngarkesës së trafikut në komunën e Deçanit është bërë numërimi manual.

Janë përpiluar formularët e numërimit në të cilët është bërë ndarja e intervaleve kohore 15 minutëshe dhe ndarja e mjeteve varësisht nga struktura.

Është zgjedhur një ditë karakteristike brenda javës (një ditë më e ngarkuar) dhe matjet janë realizuar në periudha të ndryshme kohore brenda ditës: nga ora 7.00-8.00 dhe nga ora 12.00-13.00. Me qëllim të mbledhjes së të dhënave për fluksin e automjeteve në qytetin e Deçanit, janë zgjedhur pikat karakteristike në të cilat është bërë matja e numrit të automjeteve në rrugë dhe në hyrje të udhëkryqeve. Përpos automjeteve motorike, me qëllim të caktimit të strukturës së qarkullimit, janë bërë edhe matjet e numrit të këmbësorëve dhe biçikletave të cilat qarkullojnë brenda orës.

Sa i përket strukturës së qarkullimit, automjetet e udhëtarëve dominojnë me rreth 65%, ndërsa automjetet e rënda dhe autobusët përbëjnë rreth 15%. Nga lëvizjet e pa motorizuara, lëvizjet kryesisht realizohen duke ecur në këmbë (18% këmbësorë), ndërsa rreth 2% e lëvizjeve realizohen me biçikleta (Fig. 1)



20. INFRASTRUKTURA RRUGORE PËR PERSONAT ME NEVOJA NDRYSHE

Një sfidë e vazhdueshme që e vështirëson kërkimin në këtë fushë është mungesa e të dhënave të sakta për personat me nevoja ndryshe. Megjithatë Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit

Hapësinor ka nxjerrë një udhëzim administrativ me anë të cilit obligohet rregullimi i kushteve teknike dhe mënyra e sigurimit të qasjes së papenguar, lëvizjes, qëndrimit dhe punës së personave me nevoja ndryshe. Andaj, Drejtoria e Shërbimeve Publike në bashkëpunim me Drejtorinë e Urbanizmit dhe në partneritet me organizatat përkatëse për persona me nevoja ndryshe, duhet të marrin masat adekuate në përshtatje me kriteret teknike në mënyrë që të gjitha vendkalimet në rrugë dhe vendkalimet për këmbësorë, t'u mundësojnë qasje edhe personave me nevoja të veçanta.

Në projekt e ardhshme duhet të kenë në konsideratë këto prioritetet:

- Qasja e lirë dhe e sigurt për të gjithë pjesëmarrësit në trafik, në punë, në shkollë, objektet e rëndësishme veçantë, shërbimet e nevojshme ditore, etj.
- Siguria në trafik: qytetarët me nevoja ndryshe duhet të ndihen plotësisht të sigurt gjatë lëvizjes në hapësirat publike, rrugë, sheshe, parqe, vende rekreative, etj.
- Ruajtja e ambientit: zhvillimi dhe promovimi i lëvizjeve të pa motorizuara do të ndikojë në uljen eshkalës së motorizimit dhe mbrojtjen e ambientit.
- Shëndeti dhe komoditeti i qytetarëve me nevoja ndryshe.

21. SIGURIA NË TRAFIK NË AFËRSI TË SHKOLLAVE

Siguria në trafik në përgjithësi dhe siguria e nxënësve në afërsi të shkollave në veçanti ka ngjallur shqetësim publik dhe është vlerësuar njëra prej brengave kryesore në komunën e Deçanit. Me qëllim të rritjes së sigurisë në afërsi të shkollave, në kuadër të këtij plani janë paraparë metodat fizike për kontrollin e trafikut, përkatësisht pengesat fizike të cilat ndikojnë në qetësimin e trafikut. Me nocionin metoda fizike për kontrollin e trafikut nënkuptojmë të gjitha ato procedura të cilat në thelb janë veprime të trafikut dhe të cilat ndikojnë në sjelljen e drejtuesve të automjeteve. Ato përfshijnë edhe qetësimin e trafikut në udhëkryqe dhe në akse rrugore, si dhe përparësitë për këmbësorë dhe për çiklistë.

Masat më të shpeshta për zvogëlimin e shpejtësisë dhe rritjen e sigurisë në trafik janë masat për qetësimin e trafikut. Në parim, qetësimi i trafikut është kombinim i një numri më të madh masash që kanë për qëllim zvogëlimin e efekteve negative nga përdorimi i automjeteve motorike dhe çojnë deri te ndryshimi i sjelljes së ngasësve dhe zvogëlimi i shpejtësisë maksimale të lëvizjes në trafik, duke përfshirë këto masa për qetësimin e trafikut:

- zvogëlimi i shpejtësisë në afërsi të shkollave dhe në zonat tjera të rëndësishme;
 - krijimi i kushteve në rrugë për paralajmërimin dhe detyrimin e ngasësve që të ngasin në mënyrë të qetë dhe me kujdes;
 - përmirësimin dhe mbjellja e gjelbërimit në dy anët e rrugëve, përmirësimi i mjedisit;
-

- zvogëlimin e numrit aksidenteve të trafikut.

22. INFRASTRUKTURA MODERNE-QENDRA E QYTETIT TË DEÇANIT

Për ndërtimin e qendrës së qytetit të Deçanit janë planifikuar pesë projekte, që përfshin:

- Ndërtimin e nënkalimit, rreth rrotullimit dhe lidhjes së gjitha rrugëve në qendër nëntokë.
- Ndërtimin e sheshit të qytetit
- Ndërtimin e parkingut nëntokësor dhe anësor
- Ndërtimin e lapidarëve të rinj të dëshmorëve dhe memorialin e gjithë dëshmorëve të kombit në një hapësirë të unifikuar.
- Ndërtimin e një mini qendre tregtare, me elemente tradicionale, etj.
- Ndërtimin e një objekti të përbashkët të administratës komunale, Gjykatës dhe qendrës për dokumente.



Foto: Paraqitja 3D e qendrës së qytetit

Skenari i parë – është skenar i cili e ruan gjendjen ekzistuese të ndërtuar, mirëpo duke i bërë ndryshimet në hapësirat publike, rritjen e funksionalitetit të hapësirës, rritjen e gjallërisë me aktivitetet e ndryshme, lehtësimin e qasjes për këmbësorët, çiklistet dhe personat me aftësi të kufizuara, largimin e mjeteve të motorizuara dhe përmirësimin e peizazhit arkitektonik të ndërtesave ekzistuese. Po ashtu, rëndësi duhet ti jepet trashëgimisë kulturore dhe rregullimin e monumenteve të cilat e rrethojnë këtë lokacion, përcjellë me aktivitetet dhe manifestimet e

ndryshme që organizohen në Deçan.

Skenari i dytë – skenari i dytë është skenari i cili bazohet në transformimin e tërësishëm të lokacionit. Kjo nënkupton se të gjitha ndërtesat të cilat janë pronë komunale (siç është ndërtesa e komunës, gjykata, shtëpia e kulturës etj.) do të rrënohen dhe të ndërtohen të reja. Po ashtu lejohet zhvendosja e tyre në ato prona ku komuna është pronare. Gjithashtu, ky propozim merr parasysh edhe ndërhyrjet në infrastrukturën e trafikut dhe atë teknike. Pra, lejohet zhvendosja e rrugës me qëllim të rritjes së hapësirës publike me qëllim të promovimit të lëvizjes aktive dhe uljes së lëvizjes pasive. Po ashtu, shikohet edhe mundësia e futjes së transportit të motorizuar nën tokë me qëllim të krijimit të lidhjeve vetëm për këmbësor, çiklist e personat me aftësi të kufizuara në të gjitha drejtimet. Në këtë drejtim duhet të merren parasysh edhe fuqizimi i aktiviteteve dhe manifestimeve të ndryshme në hapësirën e re të krijuar duke e promovuar trashëgiminë kulturore dhe monumentet që ndodhen aty.



Foto: Unaza lidhëse e qytetit

Skenari i tretë – është kombinimi i skenarit të parë dhe skenarit të dytë, që do të thotë se në këtë rast lejohet që i gjithë lokacioni t'i nënshtrohet një analize ku mund të vlerësohet se cilat ndërtesa mund të rrënohen, përmirësohen apo të mbesin siç janë ndërsa hapësira publike mund të përmirësohen, apo ti nënshtrohen një ndryshimi fundamental me funksione të reja. Kjo nënkupton se edhe rrjeti teknik dhe rrjeti rrugor mund t'i nënshtrohen ndryshimeve sikurse është zhvendosja e rrugës, ndërtimi i nënkalimit për mjetet e motorizuara mirëpo edhe mund të mbetet ashtu siç është me synim të përmirësimit të qarkullimit të mjeteve të motorizuara, rritjen e sigurisë në trafik, ofrimin e lëvizjeve alternative etj.

Për të tre skenarët, është dakorduar që rregullimi i ri duhet të përmbajë funksionet e reja tregtare të cilat do të menaxhohen nga Komuna me synim të rritjes së fondit të pronës komunale nëpërmes të cilave do të bëhet promovimi i vlerave, traditës, kulturës vendase.

Sipas vlerësimit, Skenari i Tretë është skenar më i përshtatshëm i cili përpos ofrimit të zgjidhjeve të reja funksionale, ajo gjithashtu edhe i mundëson konkurruesve të janë ma kreativ të ofrojnë zgjidhje ma bashkëkohore dhe funksionale. Andaj, bazuar në skenarin e tretë zgjidhja e propozuar do të merr parasysh


- a) *Mjedisin e ndërtuar* – duke ofruar zgjidhje urbane dhe arkitektonike për lokacionin e propozuar.
 - b) *Peizazhin urban* – duke iu referuar zhvillimit të hapësirave publike, brenda lokacionit mirëpo duke mos e anashkaluar edhe zonën ma të gjerë (jashtë lokacionit). Me qenë se ky lokacion karakterizohet më shumë përmendore atëherë duhet pasur kujdes që të bëhet trajtimi i tyre në mënyrën e duhur duke u bazuar në historinë të cilën ato e përfaqësojnë. Nuk përjashtohet që edhe elementi ujqor – fontana shatërvanë të janë prezentë në këtë lokacion, me qenë se në të kaluarën Deçani njihej si qytet me shumë vija uji. Gjellbërimi duhet të jetë prezent sa ma shumë. I mbetet konkurruesve të vendosin se cili lloj i gjellbërimit (i ulët, mesëm, apo i lartë) do të jetë prezent në lokacion. Kanalet e hapura ujore duhet të trajtohen me kujdes dhe të vendosen në pah. Kjo do të thotë se krahas rrjedhjes ekzistuese të ujit, lejohet të bëhen ridizajnimet e reja me qëllimin të rritjes së atraktivitetit në hapësirat publike. Mirëpo, duhet të merret parasysh se vëllimi i sasisë së ujit nuk lejohet në asnjë rast të zvogëlohet apo sasia e ujit të humbet. Të mendohet për novitete për uljen e shpenzimeve të mirëmbajtjes, pra duke ofruar zgjidhje të cilat do të ulin çmimin e mirëmbajtjes së lokacionit duke filluar nga infrastruktura teknike e deri të gjellbërimi. Rëndësi është që ti jepet ndriçimit publik, i cili duhet të jetë atraktiv dhe tërheqës sidomos në orët e mbrëmjes. Për këtë duhet të mendohet edhe për inventarin urban që të jetë atraktiv dhe funksional duke iu larguar dizajneve standarde dhe të përditshme. Hapësira e marketingut po ashtu lejohet mirëpo vetëm në pikat e caktuara duke mos e penguar lëvizjen e lirë të këmbësorëve, çiklisteve dhe personave me aftësi ë kufizuara di dhe mjeteve te motorizuara. Këto pika marketingu duhet të janë atraktive dhe bashkëkohore duke i anashkaluar llojet ekzistuese dhe të përditshme. Me ofrimin e zgjidhjes përfundimtare, organizatorët synojnë që të fillojnë me veprime konkretë të cilat do të kanë ndikim në uljen e ndotësve mjedisor respektivisht uljen e CO2 duke kontribuar në uljen e ndryshimeve klimatike.
 - c) *Lëvizshmëria* – është një nga problemet madhore në Deçan. Duke e marr
-

parasysh që ky qytet është pikë lidhje mes pjesës jugorë të Dukagjinit, me atë veriore, i gjithë transporti motorik kalon nëpërmes qytetit. Andaj është më se nevojshme që të fillohet të mendohet për rritjen e sigurisë së këmbësoreve, çiklisteve dhe personave me aftësi të kufizuara, krijimi e qasjes së lehtë dhe promovimin e lëvizjes aktive. Për këtë arsye si alternative mendohet edhe nënkalimi i mjeteve motorike me synim të rritjes së hapësirës publike dhe krijimin e lidhshmërisë së lagjeve në mes veti. Është e rëndësishme që të merren parasysh konceptet push andpull dhe sharedspace. Propozimi duhet të jetë pikënisje e zhvillimi të politikave të lëvizjes aktive respektivisht ecjes dhe çiklizmit. Rrugët kryesore duhet të analizohen dhe të jepet propozim se si do të zhvillohen në të ardhmen (një drejtimesh, dy drejtimesh, ridizajnim etj.) e po ashtu edhe analizimi i nyjës qendrore respektivisht rreth rrotullimit. Rëndësi duhet t'i jepet qasjeve sekondare, apo krijimit të qasjeve të reja. Në asnjë rast nuk lejohet që krijimi i qasjeve të reja dhe dytësore të mendohet vetëm për mjetet e motorizuara duke i anashkaluar këmbësorët, çiklistet dhe personat me aftësi të kufizuara.

Gjendja ekzistuese e parkingut nuk është në nivelin e duhur përkundrazi është kaotike. Parkingjet me pagës nuk po e japin efektin e duhur andaj duhet të mendohet për alternativat të cilat to të sjellin rezultatet e duhura duke i marr parasysh riorganizimin e parkingjeve sipërfaqësore apo edhe nëntokësore, organizimin e parkingjeve për taksit me qenë se ne qendër ndodhen mjaft ndërtesa në shërbim të qytetarëve siç është komuna, shtëpia e kulturës, gjykata etj. Të mendohet për bus ndaljen e autobusëve me synim të promovimit të transportit publik në të ardhmen. Kjo bus ndalje mundet të përdoret edhe si ShuttleBus për vizitat organizuara në zonat malore me synim të uljes së lëvizjeve pasive në këtë zonë.

- d) *Zhvillimi i njësive funksionale* – për këtë pikë është propozuar që të merren parasysh edhe riorganizimi i ri funksional brenda lokacionit. Riorganizimi nuk i përjashton edhe dislokimet e ndërtesave ekzistuese me synim të rritjes së funksionalitetit dhe shërbimeve për qytetarët. Andaj, ofrohet mundësia që të bëhet dislokimi i ndërtesës së komunës, gjykatës, qendrës për pajisje me letërnjoftim e patenta shofer dhe shtëpisë së kulturës. Këto nuk janë obliguese por me qëllim të rritjes së funksionaliteti lejohet që të bëhen dislokimet. Sa i përket ndërtesës së shtëpisë së kulturës, kjo ndërtesë mundet të mos ndërtohet fare me qenë se një ndërtim i ri dedikuar rinisë dhe kulturës ka përfunduar në një zonë tjetër të qytetit. Në kuadër të lokacionit ndodhet edhe Mulliri i cili është atraktiv për nga aspekti arkitektonik, mirëpo jo tërheqës për nga aspekti funksional. Ky Mulli është
-

duke iu nënshtruar presioneve të vazhdueshme të zhvillimeve dhe duhet të mendohet se si të integrohet në zgjidhjen përfundimtare, mirëpo edhe të merret parasysh dislokimi i tij në një vend ma të mirë, ku mendohet se mund të jetë ma atraktiv. I gjithë ky proces duhet të zhvillohet bazuar në praktikat e mira bashkëkohore. Duke u bazuar në historinë e Deçanit, rekomandohet të mendohet edhe për zhvillimin e Çarshisë artizanale ku jepet mundësi promovimit të vlerave, traditave dhe kulturës deçanasve. Kërkohet të jetë një kombinim në mes të kaluarës dhe bashkëkohores dhe esesi mos të janë ndërtime të reja të çarshive të vjetra siç janë ne Gjakovë, apo në Pejë. Rekomandohet që të mendohet edhe për Muzeun historik – etnografik i përcjellë me ndërtesa afariste dedikuar gastronomisë tradicionale. Të gjitha këto duhet të janë të menduara mirë dhe të kanë lidhshmëri me organizimin e tregut ditor (në ditët e caktuara) ku mund të shiten produktet vendore ndërsa gjatë pangjyrëve të ndryshme vjetore, qendra e qytetit të jetë pikë e takimeve të promovimeve të ndryshme të produkteve vendore. Me synim të promovimit të kohezionit social, qendra e qytetit nuk duhet të jete refuzues për kategoritë e shoqërisë. Përkundrazi duhet të jete gjithëpërfshirës, social ku të gjitha kategoritë shoqërore duhet ta gjejnë hapësirën e vet. Andaj, duhet të mendohet për të gjitha gjeneratat e shoqërisë duke filluar nga familjet, të cilave duhet t'i ofrohet këndi i lodrave e deri të të moshuarit ku mund të përjetojnë hapësirën dhe të shoqërohen në mes veti. Për organizimin e aktiviteteve dhe manifestimeve të ndryshme kulturore mund të rekomandohen edhe ndërtimi i amfiteatrit të hapur bazuar në praktikat e mira bashkëkohore. Foto: Pamja 3 D e Qytetit



- e) *Trashëgimia e Komunës* se Deçanit duhet të jetë e promovuar në Deçan. Elementet tradicionale duhet të janë prezent në zgjidhjen e propozuar me synim që të promovohet sa më shumë ky sektor me qëllim të zhvillimit të qëndrueshëm të turizmit në të ardhmen.
- f) *Promovimi i aktiviteteve kulturore*, shoqërore dhe tradicionale duhet të janë pjesë përbërëse e zgjidhjes së propozuar. Konkurrenti duhet të ofrojë ide të reja se si mundët ndryshimi i ri i pjesës qendrorë të qytetit të ketë ndikim në rritjen e aktiviteteve të lartë përmendura.
- g) Përpos rregullimit të ri dhe funksional të pjesës qendër, është e rëndësishëm që *qendra e qytetit të jetë e gjenerator ekonomik* i cili mund të zhvillohet ekonomikisht nëpërmes funksioneve afariste të cilat do të rrisin atraktivitetin e qendrës. Foto: Qendra tregtare



23. KRIJIMII SHITIGJEVE PËR ÇIKLISTË

Plani për rritjen e përdoruesve të biçikletave në qytet synon zvogëlimin e trafikut, rritjen e cilësisë së ajrit dhe përmirësimin e shëndetit publik. Kjo do të arrihet duke krijuar shtigje të reja për çiklistë, duke përmirësuar sigurinë e çiklizmit dhe institucionalizimin e çiklizmit.

Një pjesë simbolike e qytetarëve të Deçanit lëvizin rregullisht me mjete ekologjike transporti si, ecja në këmbë dhe ngasja e biçikletave. Prandaj, me qëllim të promovimit dhe avancimit të kësaj forme të lëvizjes, rekomandohet:

- ndërhyrje përmirësuese në rrjetin rrugor duke marrë në konsideratë krijimin e shtigjeve përçiklistë dhe duke siguruar jo vetëm zgjerimin e tyre, por edhe vazhdimësinë e tyre.
- krijimi i vend parkimeve të biçikletave më pranë akseve kryesore të shtigjeve për çiklistë, si dhe pranë objekteve të rëndësisë së veçantë, duke siguruar përdorimin e disa llojeve të transportit.
- Lidhjen e objekteve të trashëgimisë kulturore me shtigje të çiklistëve

- krijimi i programeve për edukimin e fëmijëve dhe të rinjve për përdorimin e biçikletave, si njëmënyrë e shëndetshme dhe argëtuese udhëtimi.
- krijimi i shtigjeve për çiklistë siç është zona e lumit dhe shtigje për bjeshkët e Deçanit

24. MIRËMBATJA

Është e rëndësishë së veçantë që komuna të bëjë edhe planifikimin e duhur buxhetor në lidhje me mirëmbajtjen projekteve të propozuara, por edhe të investimeve të mëhershme që janë bërë në fushën e transportit rrugor. Në mënyrë që të arrihet kjo, komuna duhet që patjetër ta bëjë inventarizimin e aseteve në fushën e infrastrukturës rrugore si dhe të ketë një data baze të saktë të digjitalizuar duke krijuar edhe këto kushte:

- Krijimi i një sistemi për këmbësorët, një sistemi të sigurt të përshtatshëm dhe të integruar me të gjitha aspektet e tjera të sistemit të transportit.
- krijimi i lehtësirave për lëvizje të këmbësorëve duke u dhënë këmbësorëve të njëjtën rëndësi mellojet e tjera të transportit gjatë shpërndarjes së hapësirës së përbashkët publike.
- përmirësimi i infrastrukturës së këmbësorëve që përfshinë, ndërhyrjen nëpër udhëkryqe për t'ibërë më të sigurt për kalimtarët,
- përmirësimi i trotuareve dhe pajisja e tyre me ndriçim,
- përmirësimi dhe plotësimi i sinjalizimit horizontal dhe vertikal në vendkalimet për këmbësorë, përpilimi i një udhërrëfyesi dhe hartave për ecje në këmbë.
- Sigurimi i hartave për vendet me interes për t'u vizituar në tërë komunën e Deçanit,
- organizimi i ditëve të veçanta, këtu përfshihet organizimi i “Ditës pa automjete të motorizuara”

25. PLANI I MONITORIMIT

Plani i monitorimit është një dokument me të cilin monitorohet realizimi i masave të propozuara në kuadër të planit. Për përcjelljen e realizimit të planit është përgjegjës përkatësisht Drejtoria për Mbrojtje Shpëtim dhe Shërbime Publike. Ky plan për komunën e Deçanit është një dokument strategjik dhe realizimi i tij varet nga përshtatja dhe dinamika e realizimit të planeve tjera në nivel komunal në përputhshmëri me draftin ePZHK-ës dhe hartat zonale si dhe duke pasur parasysh faktin se monitorimi dhe realizimi e këtij plani është e nevojshme mbështetja jo vetëm nga drejtoritë e tjera në nivel komunal, por edhe nga niveli qendror.

Me miratimin e këtij plani, drejtoria për Mbrojtje Shpëtim dhe Shërbime Publike, së paku një herë brenda vitit i raporton Kuvendit Komunal lidhur me realizimin e masave të parapara për periudhën e caktuar.

14. Plani i veprimit, prioriteti dhe aktivitetet për periudhën 2023-2027³

Qëllimi	Prioriteti	Aktiviteti:	Akte rët vendimmarrës	Përgjegjës për zbatim	Afati kohor	Burimi financiar	Çmimi euro
		Projekti					
Projekte propozimet							
		Ndërtimi i qendrës së qytetit	Komuna	Komuna	2004-2027	Komuna	
		Qetësimi i trafikut në afërsi të shkollave në 18 shkolla	Komuna	Komuna	2024	Komuna	5400€
		Sinjalizimi horizontal dhe vertikal	Komuna	Komuna	2024 -2025	Komuna dhe donator	15000€
		Ndërtimi shtigjeve për çiklistë	Komuna	Komuna	2024-2026	Komuna dhe donator	25000€
		Sipërfaqe të lira për lëvizje të pa motorizuara dhe rekreacion(shëtitorja në dy anët e Lumëbardhit të Deçanit)	Komuna	Komuna	2023-2027	Komuna dhe donatoret	100000€
		Ndërtimi i parkingjeve	Komuna	Komuna	2023-2027	Komuna dhe donatoret	
		Infrastruktura rrugore për personat me nevoja ndryshe	Komuna	Komuna	2024-2025	Komuna	50000€
		Parkingjet për biçikleta	Komuna	Komuna	2024-2026	Komuna dhe donatoret	10000 €
		Brezi gjelbëruespërgjatërrugëve L=3 km	Komuna	Komuna	2024-2027	Komuna dhe donatoret	30000€
		Vendosja, përmirësimi dhe mirëmbajtja e sinjalistikës Rrugore	Komuna	Komuna	2024-2027	Komuna dhe donatoret	30000€
		Ndërtimi i trotuareve pjesë rurale	Komuna	Komuna	2024-2027	Komuna dhe donatoret	100000€
		Mirëmbajtja e rrugëve verore dhe dimërore	Komuna	Komuna	2024-2027	Komuna dhe donatoret	1,000000 €
		Mirëmbajtja e rrugëve të bjeshkëve	Komuna	Komuna	2024-2027	Komuna dhe donatoret	200000€

³Plani i veprimit do të specifikohet çdo vit me planin e punës- planifikimet e projekteve konkrete



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E DEÇANIT
MUNICIPALITY OF DEÇAN
OPSTINA DEÇAN



DRAFT - PROGRAMI KOMUNAL
PËR
BANIM SOCIAL

2023-2026

Deçan-2023

TABELA E PËRMBAJTJES:

1.Hyrje.....	4
2.Qëllimi.....	5
- Objektivi.....	5
- Synimi.....	6
- Vendimi.....	7
- Komisioni për hartimin e Programit Tre Vjeçar për Banim Social.....	8
3.Korniza Ligjore.....	9
4. Programi i Hartuar në Nivelin Qeveritar.....	10
5. Profili i Komunës së Deçanit.....	10
6. Karakteristikat Demografike.....	12
- Popullsia.....	12
- Vendbanimet.....	13
- Banimet Stoku-Banesor.....	14
- Fondi Banesor.....	14
- Migrimi.....	15
- Shtimi natyror.....	16
- Jetëgjatësia.....	17
7. Treguesi i zhvillimit njerëzor.....	18
8. Punësimi.....	20
9. Papunësia	21
10 Ambienti biznesor	22
11. Të ardhurat	22
12. Të ardhurat mesatare/gjendja sociale	23
13. Ekonomia/potenciali i komunës – Buxheti.....	24
14. Planifikimi hapësinor dhe infrastruktura	25
15. Procesi i hartimit të programit	26
16. Gjendja faktike-Analiza.....	27
17. Kërkesa faktike për përkrahje	28
18. Kategoritë e synuara.....	29
19. Kriteret e përcaktimit të radhës së përparësisë.....	30
20. Klasifikimi i nevojave sipas urgjencës së trajtimit të tyre.....	32
21. Veprimet kryesore që do të ndërmerren.....	33
22. Justifikimi i veprimeve dhe shpjegimin e rezultateve të pritshme	38
23. Themelimi i sektorit të banimit.....	40
24. Mënyrat e financimit të programeve tre vjeçare.....	40
25. Burimet për financimin e programeve të financimit të programeve tre vjeçare të banimit.....	42
26. Përputhja programeve me planet zhvillimore të komunës.....	43
27. Instrumentet e mbikëqyrjes.....	43
28. Instrumentet e garantimit të realizueshmërisë së programeve	43
29. Masat që janë marrë për respektimin e kuadrit ligjor.....	44
30. Përfshirja e publikut në procesin e sigurimit të transparencës.....	44

31. Çështje të tjera.....	45
32. SWOT analiza.....	45
33. Plani i veprimit – programeve tre vjeçare.....	47
34. Përfundimi.....	52
35. Burimi të dhënave	53

1. HYRJE

Programi Komunal Trevjeçar për Banim Social, i adresohet zgjedhjes së çështjes së banimit social në Komunën e Deçanit, ngase e drejta për banim është njëra ndër të drejtat elementare të njeriut që garantohet me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, me Konventën Ndërkombëtare të Drejtave të Njeriut, si dhe me Kartën Evropiane të Drejtave të Njeriut. Në këtë kontekst qasja në banim është një disiplinë multi-sektorale mjaft komplekse që kërkon nga autoritetet qendrore dhe komunale përkushtim dhe vullnet politik për të adresuar me kompetencë këtë çështje.

Me miratimin e Ligjit për Financimin e Programeve të Veçanta të Banimit NR. 03 /I-164, ofron një kornizë më të avancuar për autoritetet vendimmarrësve lokale, duke ofruar banim të qëndrueshëm për popullatën në territorin e komunave të Kosovës.

Komuna e Deçanit në programet e saj zhvillimore ka për qëllim përmirësimin e banimit social për banoret e saj.

Programi Komunal për Banim Social 2023-2026, do të mundësoj kushte për banim të përshtatshëm dhe të qëndrueshëm për familjet, të cilat nuk e kanë të zgjidhur çështjen e banimit ende ose jetojnë në Qendra të Përkohshme Kolektive dhe që jetojnë nën normat minimale të banimit.

Programi është punuar sipas metodologjisë përshkruese dhe interpretuese duke u bazuar me të dhëna konkrete të gjendjes ekzistuese. Procesi i hartimit ka kaluar nëpër këto faza:

- a) Vendimi i kryetarit për hartimin e Programit Komunal për Banim Social 2023-2026
- b) Komisionit i përbërë nga pesë veta për hartim të Programit si dhe grupi punues,
- c) Analiza e gjendjes, identifikimi i problemeve, Swot Analiza
- d) Planifikimi i zonave për ndërtim të objekteve për banim social
- e) Kriteret bazë për familjet që bëjnë kërkesë për të përfituar nga programet e veçanta të banimit.

Institucionet përgjegjëse për monitorim dhe zbatim e programit e bëjnë këto Institucione:

Në nivel qendror:

- Departamenti i Banimit dhe Ndërtimit në Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor,
- Departamenti i Planifikimit Hapësinor e Mjedisit dhe banimit Ministrisë së Mbrojtjes së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH),
- Ministria e Administratës së Pushtetit Lokal (MAPL)

Në nivel komunal:

- Drejtorati për Shëndetësi dhe Mirëqenjë Sociale
- Drejtorati për Buxhet dhe Financa
- Drejtorati për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit
- Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër
- Drejtorati për Shpëtim, Mbrojtje dhe Shërbime Publike

2. Qëllimi

Qëllimi i hartimit të Programit Komunal për Banim në Komunën e Deçanit është adresimi i çështjeve të banimit në territorin e saj, bazuar në politikat të banimit, së pari duke: Identifikuar pasqyrën reale të problemeve në Komunën e Deçanit, që kanë të bëjnë me çështjen e banimit.

Për të zhvilluar politika adekuate përfshirë specifikat lokale, veçoritë gjeografike, demografike dhe institucionale për zbatimin e tyre me qëllim që të mundësohet zgjidhja e nevojave për banim për grupe të caktuara të cilat nuk kanë forcë ekonomike për të siguruar banim me çmime të tregut. Për të krijuar kushte për banim të përshtatshëm dhe të qëndrueshëm në harmoni me standardet dhe normat minimale evropiane të banimit.

Gjetjen e mënyrave të financimit për realizimin e zbatimit të Programit të Banimit. Dokumenti është përgatitur në përputhje me Udhëzuesin për Programeve Komunale, bazuar në Ligjin Nr. 03/L-164, Për Financimin e Programeve të Veçanta të Banimit dhe njëkohësisht, i nënshtrohet zbatimit të metodës së planifikimit strategjik që nënkupton dhënien e përgjigjes në pyetjet:

- **Ku?** E që ka të bëjë me analizën e gjendjes ekzistuese;
- **Kur?** E që ka të bëjë se kur do të arrihet;
- **Çka?** Synimet, apo objektivat;
- **Si të arrijmë atje?** Idetë, veprimet, projektet etj.
- **Përse?** Që ka të bëjë me monitorim dhe vlerësim.

2.1 Objektivi

Tërheqja e investimeve dhe përmirësimi i vazhdueshëm i nivelit të jetesës në përgjithësi që rezulton në reduktimin e numrit të familjeve që kanë nevojë për mbështetje në fushën e banimit social. Planifikimi dhe shfrytëzimi i mjeteve financiare për zhvillimin e banimit social, dhe

përmirësimi vazhdueshëm i nivelit të jetesës në përgjithësi, procedurat e qiramarrjes, qiradhënies, administrimi dhe menaxhimi e ndërtesave për banim social

2.2 Synimi

Krijimin e kushteve për banim të përshtatshëm dhe të qëndrueshëm në harmoni me standardet dhe normat evropiane të banimit, me qëllim që të mundësohet zgjidhja e nevojave për banim për grupe të caktuara, të cilat nuk kanë forcë ekonomike që këtë problem ta zgjidhin sipas parimeve të tregut.

Me hartimin e këtij programi synojmë plotësimin e obligimeve ligjore, e që Hartimi dhe zbatimi i këtyre politikave të banimit në Komunën e Deçanit ndërlidhet me procesin e integritetit evropian me kriteret për anëtarësim në BE duke respektuar Konventat Evropiane, Kartën Sociale Evropiane dhe Deklaratën Universale për të drejtat e Njeriut.

- Përcaktimi i parcelave për ndërtim në pronën komunale
- Ndërtimi i objektit banesor për dhënien me qira joprofitabile
- Rivlerësimi i gjendjes ekonomike të familjeve në përputhje me UA, nr. 18/2010 Për Përmbajtjen e Kontratës Për Banesën Me Qira Joprofitabile, bazuar në Ligjin nr. 03/L-164
- Administrimi dhe mirëmbajtja e ndërtesave në bashkëpronësi

2.3 VENDIM

Në bazë të nenit 25 dhe 26 të Ligjit me Nr. 03/L-164 Për Financimin e Programeve të Veçanta të Banimit, në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 17 pika k, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr. 03/L-040 si dhe nenit 14 pika 11, nenit 56 pika 20 të Statutit të Komunës së Deçanit, Kryetari i Komunës, me dt. **03/04/2023** merr këtë:

VENDIM

PËR HARTIMIN E PROGRAMIT KOMUNAL PËR BANIM SOCIAL 2023-2026

Neni 1

Sipas nevojave të identifikuara të popullsisë për banim në komune bëhet hartimi i Programit Komunal për Banim Social 2023-2026.

Neni 2

Hartimi i Programit dhe projekteve tre (3) vjeçare për banim social, komuna do të ndaj burime financiare.

Neni 3

Komuna do të siguroj zonat për ndërtim dhe pajisjen e truallit me infrastrukturë, në zbatimin e programeve të banimit.

Neni 4

Paraqitjen e kërkesave për financimin e investimeve dhe subvencioneve në Ministri.

Neni 5

Krijimin dhe administrimin e bazës së të dhënave për familjet që përfitojnë nga programet për banim.

Neni 6

Sigurimi i ndërtimit komuna, ministria, dhe donatore.

Neni 7

Administrimi dhe mirëmbajtja e banesave me qira përmes organit kompetent komunal, Drejtori për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale dhe Drejtorin për Urbanizëm, Planifikimit Hapësinor dhe Mbrojtje të Mjedisit.

Neni 8

Ky vendim hyn në fuqi me ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës Bashkim Ramosaj.

Deçan: **03/04/2023**

Kryetari i Komunës
z. Bashkim Ramosaj

2.4 KOMISIONI PËR HARTIMIN E PROGRAMIT TREVJEÇAR PËR BANIM

Komisioni për hartimin e Programit Komunal për Banim Social 2023-2026 është i përbërë nga këta 5 anëtarë:

1. **Bashkim Ramosaj - Kryetar i Komunës**
2. **Agnesa Vokshi** - Drejtoreshë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale
3. **Dafina Cacaj** -Drejtore për Buxhet dhe Financa
4. **Ramë Melaj** - Drejtore për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit
5. **Agron Muslija**- Drejtore për Gjeodezi dhe Kadastër

GRUPI PUNUES:

1. **Jashar Dobraj** - Drejtore i Drejtoratit për Administratë të Përgjithshme
2. **Dafina Cacaj** - Drejtore i Drejtoratit për Buxhet dhe Financa
3. **Ajne Iberhysaj** - Inspektore për Mbrojtje të Mjedisit
4. **Ajshe Qorraj** - Zyrtare e Lartë për Urbanizëm
5. **Shkelzen Goçi** –Inspektor i Ndërtimit
6. **Edone Kameraj** - Zyrtare për Informim
7. **Shkelzen Shehu** - Shef për Planifikim
8. **Zoje Selmonaj** - Zyrtare për Shpenzime
9. **Xhevat Lufaj** - Zyrtare per Sherbimet Publike

3. KORNIZA LIGJORE

Treguesit kryesor të sektorit të banimit dhe ndërtimit janë:

- ❖ Ligji për Financimin e Programeve të Veçanta të Banimit Nr. 03/L-164.
 - ❖ Ligji Nr. 08/L-011 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-061 Për Shitjen e Banesave për të cilat ekziston e drejta banesore, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-247.
 - ❖ Ligj për ndërtesat e banimit në bashkëpronësi Nr. 04/L-134 2013.
 - ❖ Ligji për Vetëqeverisjen Lokale, Nr. 03/L-040.
 - ❖ Ligji Nr. 04/L-134 për ndërtesat e banimit në bashkëpronësi.
 - ❖ Ligji për ndërtim, Nr. Nr. 04/L-110.
 - ❖ Ligji për trajtimin e ndërtimeve pa leje, Nr. 06/L-024.
 - ❖ Ligji për Inspektoratin e produkteve të ndërtimit, Nr. 02/L-62.
 - ❖ Ligji Nr. 05/L-031 për procedurën e përgjithshme administrative.
-
- Udhëzimi Administrativ Nr. 18/2010 për Përmbajtjen e kontratës për banesat me qira joprofitabile;
 - Udhëzimi Administrativ Nr. 19/2010 për Përmbajtjen e bonusit të banimit;
 - Udhëzimi Administrativ Nr. 21/2010 për Kriteret e përcaktimit të radhës së përparësisë për kategoritë e familjeve që mund të përfitojnë nga programet e veçanta të banimit;
 - Udhëzimi Administrativ Nr. 22/2010 për Procedurat për përfitimin nga programet e veçanta të banimit;
 - Udhëzimi Administrativ Nr. 23/2010 për Procedurat e shpalljes së programeve të veçanta të banimit;
 - Udhëzimi Administrativ Nr. 24/2010 për Normat minimale të banimit për banesat nga programet e veçanta të banimit;
 - Udhëzuesi për hartimin e programeve të veçanta për banim.
 - Statuti i Komunës së Deçanit i datës 31/10/2019.

4. STRATEGJITË E HARTUARA NË NIVELIN QËNDROR

- Draft Strategjia dhe Plani i Veprimit për përfshirjen e komuniteteve Rom dhe Ashkali në shoqërinë kosovare 2022-2026,
- Strategjia Kombëtare për Riintegrim të Qëndrueshëm të Personave të Riatdhesuar në Kosovë 2018-2022
- Plani i Veprimit dhe Rregullore QRK Nr.20/2013 për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar dhe Menaxhimin e Programit të Riintegrit
- Strategjia për Komunitete dhe Kthim 2014-2018 dhe Plani i veprimit për strategjinë për komunitet dhe kthim 2014 – 2016.

5. PROFILI I KOMUNËS SË DEÇANIT - POZITA GJEOGRAFIKE

Komuna e Deçanit ka një pozitë mjaftë të mirë gjeografike. Ndodhet në pjesën perëndimore të Kosovës dhe të Rrafshit të Dukagjinit.

Gjendët pothuajse në qendër të Ballkanit, në vijën ajrore nga Deti Adriatik më gjatësi 90 km, kurse 220 km gjatësi nga Deti Egje.

Në perëndim kufizohet më Republikën e Shqipërisë që shtrihet prej PT-1660 deri PT-2366 në gjatësi prej 13850 m.

Në veri-perëndim kufizohet me Malin e Zi PT-2366 deri 2424 me gjatësi 9750 m.

Në veri kufizohet me Komunën e Pejës PT-2424 deri 460 [Maznik] me gjatësi prej 50550m.

Në jug-lindje dhe jug kufizohet me Komunën e Gjakovës dhe Junikut nga PT-460 deri PT- 1660 [Rajoni i gjerë i Rrasës së Koshares].

Komuna e Deçanit shtrihet në një sipërfaqe prej 293,948,468.50 m² ose 293,94 km² dhe përfshinë 136 banorë për km²

- 5504.53 sipërfaqe e shfrytëzuar e tokës bujqësore/sipërfaqe ha
- 4302.07 tokë e punueshme /arë sipërfaqe ha
- 198.6 ha kopshte ha
- 1873 livadhe ha
- 150.4 tokë bujqësore e pa përdorur sipërfaqe ha
- 15995.4 tokë pyjore sipërfaqe ha-Parku Kombëtar Bjeshkët e Nemuna
- 790.7 Zona e veçantë e mbrojtur rreth manastirit të Deçanit ha
- 378.6 tokë jo bujqësore sipërfaqe ha

- 200.75 tokë e degraduar (depone, ndërtime) sipërfaqe ha Komuna e Deçanit ka një qendër administrative dhe 38 fshatra. Qyteti i Deçanit nga kryeqyteti (Prishtina) ka një largësi prej 90 km.

Në këtë hapësirë jetojnë rreth 40,019 banorë, sipas regjistrimit të popullsisë të vitit 2011.

Lartësia mbidetare varion nga 412 lartësi mbidetare në fshatin Maznik deri në 2530m lartësi mbidetare në majën e Marjashit. Në sajë të krijimit të reliefit Komuna e Deçanit ndahet në dy pjesë:

- Në ultësi që është pjesë e rrafshit të Dukagjinit;
- Dhe në lartësi që përfshin masivin e Bjeshkëve të Nemuna (Alpet Shqiptare)

Rrafshi i Dukagjinit është krijuar në periudhën gjeografike – neogjen. Nga lëvizjet tektonike krijohet një liqe që përfshinë tërë Rrafshin e Dukagjinit. Nga mesi i Laçerit, niveli i ujit të liqenit fillon të ulet dhe më vonë, fillon të tërhiqet përmes luginës të Drinit të Bardhë .

Bjeshkët e Nemuna apo Alpet Shqiptare, shtrihen në pjesën perëndimore të Komunës së Deçanit që i takon nga siperfasqja e përgjithshme e parkut ka përfshirje me kete sipërfaqe prej 16,786 ha apo 27% nga territori i Bjeshkeve të Nemuna.

Lartësitë e Bjeshkëve të Nemuna pak ndryshojnë nga lartësia e vargmaleve alpike. Këto janë pjesët më të larta dhe më shkëmbore të vargmaleve të siujdhesës Ballkanike, me ç'rast shkëmbinjtë e bardhë dhe të dhëmbëzuar formojnë pamje imponante. Nga masivi i Bjeshkëve të Nemuna, në komunën e Deçanit mund të veçojmë këto maja më të larta me lartësi mbi detare:

- Maja e Rupes 2501 m
- Maja e Qenit 2406 m
- Maja e Strellcit 2377 m
- Maja e Marjashit 2530 m

Karakteristikat klimatike Deçani ka klimë kontinentale me ndikim të klimës mediterane. Gjatë vitit në Deçan ka 1,975 orë me diell. Viset e ulëta të Deçanit karakterizohen me temperatura relativisht të larta me vlerë mesatare vjetore më tepër se 11°C, me muajt më të nxehtë gushtin dhe korrikun 21.7°C dhe 21.68°C dhe me muajin më të ftohtë janarin – 0.5°C.

Lagështia mesatare e ajrit gjatë vitit është 70.2% në të cilin rast rritja është dukshëm më e madhe prej verës kah dimri për 17.5% se sa zvogëlimi prej dimrit në drejtim të verës.

Në këtë rajon vranësitat mesatare vjetore janë 58% gjatë së cilës frekuenca e ditëve të kthjellëta është 60.5 (16.6%) në vit, ndërsa e ditëve pa dille 119,3 ditë (32.6%). Zgjatja mesatare vjetore e zënies së diellit për shkak të ndikimeve orografike është më e vogël se sa mesatarja për Kosovë dhe është 1,972 orë, nga e cila në Korrik 293,6 orë ose 72.1% diell në vit.

Sasitë e të reshurave në këtë rajon janë ndër më të mëdhatë në Kosovë. Në viset e ulëta është 724,6 lit/m², në viset malore të Bjeshkëve të Nemuna sasitë mesatare të të reshurave arrijnë më tepër se 1.300 lit/m².

Era, frekuencën më të madhe e ka gjatësia / 398 0/00/, ndërsa nga erërat ato perëndimore/W/ dhe jugperëndimore /SW/ me 122° 0`00``/ dhe 113° 0`00``, ndërsa më të rrallat janë ato lindore /E/ me 55° 0`00``/

6. KARAKTERISTIKAT DEMOGRAFIKE

6.1 POPULLSIA

Gjendja e popullsisë shikuar në periudhën 1948-1981 është me disa dallime nga ajo e Kosovës. Sipas regjistrimit të vitit 1948 në Komunën e Deçanit kishte 39 vendbanime, 2794, ekonomi familjare me 20672 banore. Sipas regjistrimit të vitit 1953, në kuadër të Rrethit të Pejës, bënin pjesë Këshilli Popullor i Komunës – Strellc i Epërm. Deçani me 10 fshatra, 874 shtëpi ka 6.834 banore. KPK i Irzniqit me 16 fshatra, me 786 familje dhe me 5865 banore. Sipas shënimeve të përpunuara Komuna e Deçanit kishte 39 vendbanime me 2.912 ekonomi familjare me 22218 banore. Bazuar në regjistrimet e vitit 1961, Komuna e Deçanit kishte këtë strukturë: Vendbanimet 39, ekonomi familjare 3386 dhe 25582 banore. Nga ky numër 22472 ose 87.8 % ishin shqiptare, 413 ose 1.6 % serbe, 2534 ose 9.9 % malazeze, 51 ose 0.2 % myslimane, 6 turq ose 0,5 %.

Sipas regjistrimit të vitit 1971, Komuna e Deçanit kishte 39 vendbanime me 3.975 ekonomi familjare me 31335 banore, nga të cilat 29474 ose 94.2 % shqiptare, 310 ose 1.0 % serbe, 1357 ose 4.3 % malazeze, 133 ose 0.4 %, myslimane. Sipas regjistrimit të vitit 1981, Komuna e Deçanit kishte 40 vendbanime me 40640 banore, nga të cilat 39179 ose 96.4 % shqiptare, 234 ose 0.6 % serbe, 898 ose 2.2 % malazeze, 217 ose 0.5 %, myslimane, 112 ose 0.3 % të tjerë.

Sipas regjistrimit të vitit 2011, numri i banoreve në Komune është 40,019 , ndërsa i ekonomive familjare 5887:

Tab. 1.-Popullsia sipas përkatësisë etnike/kulturore,gjinisë dhe komunës

Komuna Deçan	Përkatësia etnike/ kulturore										
	Nuk janë në dispozicion	Shqiptar	Serb	Turk	Boshnjakë	Rom	Ashkali	Egjiptian	Goran	Të tjerë	Preferon mos të përgjigjet
	64	39,402	3	0	60	33	42	393	1	19	2

Tab. 2. Struktura gjinore e popullsisë

Komuna Deçan	Struktura gjinore		
	Femra	Meshkuj	Gjithsej
	19,894	20,125	40,019

6.2 VENDBANIMET

Tab.1

KOMUNA E DEÇANIT			
Nr. i popullsisë			40,019
Zonat rurale			36216
Zonat urbane			3803
Nr. i fshatrave/nr. i lagjeve			37 vendbanime
Banimi individual	Nr. objekteve para 1999		1407
	Nr. objekteve pas 1999		2381
	Etazhiteti mesatar		P+2
Banimi kolektiv	Para 1999	Nr. Objekteve	/
		Nj. banimi	/
	Pas 1999	Nr. objekteve	/
		Nj. banimi	/
	Etazhiteti mesatar		P+6
Statusi pronësor [banim kolektiv] para 1999		Privat [nj. banimi]	/
		Shoqëror [nj. banimi]	/
Raporti banim individual/banim kolektiv në [%]			/
Kyçje në infrastrukturë të objekteve të banimit në [%]			80%
Nr. i objekteve të pabanuara			/
Nr. i objekteve me vlerë kulturo historike që shfrytëzohen për banim			/
Aplikimi i masave termo-izoluese në objektet e banimit në [%]			/
Ndërtimet ilegale	Mbindërtimet		n/a
	Ndërtimet tjera		n/a
	Ndërtimet në pronë shoqërore		
Numri i kërkesave për zgjidhjen e çështjes së banimit			10
Lokacionet (sipërfaqja e tokës) për programet e veçanta të banimit			n/a

Nr. i objekteve/nj. banimi e ndërtuara nga Komuna Qeveria dhe donatorët		8 objekte
Nr. i objekteve/nj. banimi me qira nga dhe vlera mes. e qirasë		n/a
Nr. i objekteve/nj. banimi të disponueshëm për qira të ulëta të tregut		n/a
Nr. i objekteve/nj. banimi ne pronësi te Komunës që mund të adaptohen		n/a
Qendrat e përkohshme kolektive (QPK)	Numri i QPK	n/a
	Vendndodhja /emërtimi	n/a
	Nr. i familjeve	n/a
	Nr. i banorëve	n/a

6.3 BANIMET-STOKU-BANESOR

Komuna e Deçanit	1960	1960-1969	1970-1979	1980-1989	1990-1999	2000-2009	2010	2011	Gjithsej
	83	132	564	1,154	1,407	2,381	119	7	5,847

Në investimet në fushën e ndërtimit të banimit sociale janë bërë në vitin 2003/2004 është realizuar Projekti i financuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Komuna e Deçanit dhe donatorit Swiss Cooperation Office-SDC, me përmbajtje të objektit 16 banesa dhe 4 lokale afariste.

6.4 FONDI BANESOR

Nr. i objekteve të banimit	Njësi të banimit
Nr. i banesave në pronësi komunale	Në qender të qytetit -1/ 105 njësi banimi Rr. “Sali Çeku” 4/ 70 njësi banimi Rr. “Luan Haradinaj”, 1 / 35 njësi banimi Ndërtesa të posta 1/ 6 njësi banimi etj.
Me partneritet publik privat	5 objekte banimi-dhënia e tokës komunale me qira afatgjate për 99 vjet. Këto ndërtime me destinim banim dhe afarizëm ku në bazë të konkursit të shpallur për këto ndërtime Komuna përfiton nga secili ndërtim 21 % vlerë materiale
Qendra për banim social	1 /16 njësi banesore
QK (Qendra kolektive)	Lagja Baballoq me 14 objekte formale të banimit

6.5 MIGRIMI

Problemi i njëjtë si në gjithë Kosovën qëndron edhe më Komunën e Deçanit, ku kemi emigrime dhe migrime të shumta, por asnjëherë nuk mund të japim shifrat e sakta se sa është numri i qytetarëve tanë që jetojnë punojnë dhe veprojnë jashtë territorit të Komunës, sidomos atyre që jetojnë jashtë Kosovës.

Sipas të dhënave nga Agjensionit të Statistikave të Kosovës- migrimi dhe emigrimi në vitin 2021 në nivel komune, popullsia e Deçanit është:

Përfundimisht, migrimi i fuqisë punëtore dhe lëvizshmëria në Evropë do ta ndihmonin në masë të madhe zhvillimin njerëzor në Kosovë gjithashtu edhe në komunën e Deçanit. Vendet potenciale nikoqire duhet ta marrin parasysh krijimin e mundësive shtesë për emigrantët e punës nga Kosova, ndërsa autoritetet e Kosovës duhet, si çështje me prioritet, ta zbatojnë udhërrëfyesin e BE-së për liberalizimin e vizave, do të lehtësonte lëvizjen ndërkombëtare për studim, punë, trajtim mjekësor dhe turizëm.

Tab. 3. Popullsia e Komunës së Deçanit për vitin 2021 dhe migrimi për vitin 2021

Komuna Deçan	Popullsia e vlerësuar (31 dhjetor 2020)	Migrimi ndërkombëtar (2021)			Emigrimi ndërkombëtar (2021)			Balanci i përgjithshëm i migrimit kombëtar	Gjithsej popullsia dhe migrimi (31.12-2021)
		Imigrimi	Emigrimi	Bilanci migrimit ndërkombëtar 2021	Imigrimi	Emigrimi	Bilanci migrimit kombëtar		
	42,480	59	289	-230	108	143	-35	-265	42,215 15

6.6 SHTIMI NATYROR

Baza e të dhënave për ta vlerësuar numrin e popullsisë për vitin 2021 është marrë numri i vlerësuar i popullsisë rezidente në Deçan, në fund të vitit 2021 duke bazuar nga të dhënat e Agjensionit të Statistikave të Kosovës. Për ta vlerësuar numrin e popullsisë rezidente në nivel kombëtar/komunal, popullsia është e ndikuar nga nataliteti, mortaliteti dhe migrimi (NMM).

Vlerësimi i popullsisë: popullsia bazë+nataliteti-mortalitetit± migrimi i jashtëm/brendshëm. Të dhënat mbi numrin e popullsisë në nivel komune janë llogaritur sipas procedurave të mëposhtme:

Pn- numri i banorëve të përlllogaritur për vitin e dhënë 2021

N-Numri i lindjeve të gjalla (Nataliteti),01 janar-31 dhjetor 2021

M-Numri i vdekjeve (mortaliteti),01 janar-31 dhjetor 2021

I-Imigrimet, 01 janar-31 dhjetor 2021

E- Emigrimet,01 janar-31 dhjetor 2021

Tab. 4. Popullsia e komunës e vlerësuar për vitin 2021

Komuna Deçan	Gjithsej popullsia e vlerësuar (31 dhjetor 2021)	Shtimi natyror (31.12.2021)	Bilanci i migrimeve (31.12.2021)	Rritja e përgjithshme për vitin 2021	Gjithsej popullsia e vlerësuar për vitin 2021 (31 dhjetor 2021)
	42,480	275	-265	10	42,490

Tab. 5. Popullsia e Komunës së Deçanit dhe shtimi natyror për vitin 2021

Komuna Deçan	Gjithsej popullsia e vlerësuar (31 dhjetor 2020)	Lindjet/Nataliteti (2021)	Vdekjet/Mortaliteti (2021)	Shtimi natyror (2021)	Gjithsej popullsia dhe shtimi natyror (31 dhjetor 2021)
Nr.	42,480	554	279	275	42,755

6.7 JETËGJATËSIA

Indikatori themelor që mat nëse njerëzit kanë një jetë të gjatë dhe të shëndoshë është indeksi i jetëgjatësisë. Ky indeks është themelor në llogaritjen e I. ZH. Nj. Sipas A. ZH. Nj-së jetëgjatësia mesatare në Kosovë është 67.8 vjet për meshkujt, 69.9 për femrat.

Jetëgjatësia është indeksi më i ndjeshëm, siç janë konfliktet dhe epidemitë. Kështu duhet të kalojë një kohë shumë e gjatë që ky indeks të përmirësohet dhe të manifestohet në statistikat e përmbledhura agregate, krahasuar me trendet që manifestohen menjëherë.

Që nga mesi i viteve nëntëdhjeta mesatarja e jetëgjatësisë kanë rënë për pesë vjet, për shkak të konfliktit të vitit 1998-1999. Për shkak të shumë përmirësimeve sa i përket kushteve jetesës dhe kushteve ekonomike gjatë 4-5 vjetëve të fundit trendi rënës i jetëgjatësisë është i ndalur.

Tab. 6. Popullsia sipas moshës

Komuna	MOSHA								
	0-9	10-19	20-29	40-49	50-59	60-69	70-79	80+	GJITHSEJ

Deçan	6,856	8,496	7,573	5,575	3,596	2,294	1,495	556	42,480
--------------	--------------	--------------	--------------	--------------	--------------	--------------	--------------	------------	---------------

7. TREGUESI I ZHVILLIMIT NJERËZOR

Zhvillimi mund të vlerësohet si një proces i vazhdueshëm i rritjes dhe përparimit. Si i tillë zhvillimi nënkupton ekzistencën e një procesi të vendosur, që ka për qëllim përmirësimin e jetës së qytetarit dhe shoqërisë. Matja më e mirë e zhvillimit njerëzor është indeksi i Zhvillimit njerëzor (IZHNJ)¹.

Ky indeks për herë të parë është përdorur në Raportin e Zhvillimit Njerëzor të botuar nga Programi për Zhvillimi i OKB-së (UNDP) më 1990. Ky indeks është krijuar për të matur zhvillimin edhe me mjete të tjera përveç indekseve rritjes ekonomike siç janë Bruto Prodhimi Vjetor (GDP) apo të ardhurat. IZHNJ në vete përmban edhe GDP-në por në të llogaritet edhe jetëgjatësia dhe arsimimi.

Krijuesit e këtij indeksi kurrë nuk kanë menduar se ky indeks do të jetë njësi e mjaftueshme matëse, por e kanë konsideruar se kjo do të jetë një mjet që do të ndihmonte që vëmendja të drejtohej në brengat e njerëzve, e jo vetëm në rritje ekonomike. IZHNJ mund të ketë vlerën prej 0 deri në 1. Vendet janë të radhitura në nivel të ultë të mesëm dhe të lartë të zhvillimit njerëzor, varësisht nga vlera e indeksit. Vendet që kanë rezultat më të afërt me 1 janë më të zhvilluara. Komponentët e IZHNJ janë:

- Jetëgjatësia, indikatorë që tregojnë nëse njerëzit janë duke jetuar një jetë të gjatë (për këtë) edhe të shëndetshme, por gjithashtu këtu implikohet edhe vendi se ku shkojnë resurset dhe a janë ato duke shkuar në drejtim të duhur, a janë duke u shfrytëzuar për shëndetësi preventive dhe primare, apo për shëndetësi kurative;
- Analfabetizmi dhe mesatarja e viteve të shkollimit, një indikatorë nëse njerëzit janë të gatshëm që të përfitojnë nga frytet e zhvillimit, dhe
- Bruto Prodhimi Vjetorë për kokë banori, që reflekton të ardhurat mesatare, por të llogaritura për fuqi blerëse.

- Mjetet tjera statistikore për të matur zhvillimin janë Indeksi i Varfërisë Njerëzore dhe Indeksi I Zhvillimit Gjinnorë, këto janë të detajuara në vazhdim të raportit.

8. PUNËSIMI

Institucioni: Komuna e Deçanit-ADMINISTRATA

komuna	Totali	Struktura kualifikuese				Struktura etnike									Struktura gjinore		personat me af- tesi te kufizuar		postet politike	
		fakulteti	nk. e lar	shk. e mesme	nk.fillo	sh	s	b	t	g	a	e	r	tj	m	f	m	f	m	f
nepunes i shërbimit civil	136	90	4	42		133	1	2							106	30	2	1		
nepunes i shërbimit publik	13	12		1		13									9	4				
nepunes ad. dhe mbeshitetes	5			5											5					

Institucioni: ARSIMI

DKA	Totali	Struktura kualifikuese				Struktura etnike									Struktura gjinore		personat me af- tesi te kufizuar		postet politike	
		fakulteti	nk. e lar	shk. e mesme	nk.fillo	sh	s	b	t	g	a	e	r	tj	m	f	m	f	m	f
nepunes i shërbimit publik	430	427	3			429		1							167	263				
nepunes ad. dhe mbeshitetes	126	42		27	56	125		1							113	13			1	

Institucioni: SHENDETESIA

DKSH	Totali	Struktura kualifikuese				Struktura etnike									Struktura gjinore		personat me af- tesi te kufizuar		postet politike	
		fakulteti	nk. e lar	shk. e mesme	nk.fillo	sh	s	b	t	g	a	e	r	tj	m	f	m	f	m	f
nepunes i shërbimit publik	116	37	2	74	3	115							1		26	90				
nepunes ad. dhe mbeshitetes																				

Legjenda: Struktura etnike, shkurtesat : sh-shqiptar, s-serb, b-boshnjak; t-turq; g-goran; a-ashkalinje; e-egjiptian; r-rom; tj-tjerë; m-meshkuj; f-femra

9. PAPUNËSIA

Të dhënat për shkallën e papunësisë për komunën e Deçanit janë marr nga Anketa e Fuqisë Punëtore për vitin 2015, publikuar nga Agjensioni i Statistikave të Kosovës (ASK).

Tab. 9. Popullsia e moshës 15 vjeçe e mbi sipas statusit të aktivitetit aktual, gjinisë dhe komunës².

Komuna Deçan	Ekonomikisht aktive	Të punësuar	Të papunësuar, Ka punuar më parë	Të papunësuar, Nuk kanë punuar kurrë më parë	Të papunësuar, Presin të fillojnë punën në të cilën janë pranuar	Ekonomikisht jo aktivë	Gjithsej
	10,728	4,396	1,379	4,737	216	18,820	29,548

Tab. 10. Pjesëmarrja në fuqi punëtore dhe papunësia (popullsia e moshës 15-64 vjeçare)³

Komuna Deçan	Shkalla e pjesëmarrjes,%			Shkalla e Papunësisë,%		
	Meshkuj	Femra	Gjithsej	Meshkuj	Femra	Gjithsej
	73.6	28.8	50.5	60.6	74.6	64.7

2. POPULLSIA, EKONOMITË FAMILJARE DHE NJËSITË E BANIMIT NË KOMUNAT E KOSOVËS-Agjencionit i Statistikave të Kosovës

3. RAPORTI I ZHVILLIMIT NJERËZOR NË KOSOVË 2012 - UNDP

10. AMBIENTI BIZNESOR

Resurset ekonomike dhe burimet njerëzore të Deçanit janë shumë të favorshme për një zhvillim të qëndrueshëm dhe prosperitet ekonomik në sajë të pasurive natyrore që posedon. Në Komunën e Deçanit veprojnë rreth **1039** biznese. Nga bizneset e regjistruara, shumica prej tyre kanë 1-3 punëtor, pastaj ato të mesme të cilat kanë nga 10-100 punëtor, numri i tyre është i vogël. Investimet e huaja në vitet e fundit kanë përkrah dhe financuar projekte, të cilat kanë ndikuar në zhvillimin lokal dhe përmirësimin e ambientit biznesor.

Komuna e Deçanit ka mundësi dhe perspektiva zhvillimi duke u bazuar në resurset natyrore dhe trashëgimisë kulturore, të cilat mund të shfrytëzohen për krijimin e një ambienti biznesor të favorshëm dhe për zhvillim ekonomik gjithashtu bujqësia me sektorët si: blegtoria, pemëtaria, perimtaria, bletaria si dhe industria përpunuese e prodhimeve bujqësore ofrojnë mundësi të jashtëzakonshme zhvilluese.

Pozita gjeografike dhe bukuritë natyrore të Bjeshkëve të Nëmura ofrojnë kushte shumë të mira për zhvillimin e turizmit dimëror dhe veror. Afërsia me tregjet e rajonit dhe pika kufitare me Shqipërinë dhe Malin e Zi janë mundësi e aktiviteteve ekonomike dhe shërbyese me theks të veçantë për zhvillimin e turizmit.

11. TË ARDHURAT

Indeksi i të ardhurave është projektuar për të kapur dhe krahasuar standardet e njerëzve që jetojnë. Një tregues i rëndësishëm i të ardhurave paraqet edhe relacioni i vogël por i qartë në mes të nivelit mesatar të arsimit dhe të ardhurave mesatar për kokë banori. Sa më e madhe të jetë përqindja e popullsisë në një komunë që ka kryer shkollën e mesme, shkollën e lartë universitetin, aq më e madhe do të jetë mesatarja e të ardhurave për kokë banori në komunën.

Komunat Sipas anketës Mozaiku përfshinë variabëlin për shpenzimet për kokë banori në familje, që është përdorur si variabël Proxy për indeksin e treguesit kombëtar (Ardhurat Kombëtare Bruto) AKB. Meqë ky tregues mat drejtpërdrejt shpenzimet e familjeve, është Proxy e mirë e standardeve të jetesës, me kushte që çmimet lokale nuk ndryshojnë në masë të madhe.

Në tab. janë përmbledh mesataren për shpenzimet e familjeve për kokë banori në komunën e Deçanit, të përdorur për indeksin AKB

Tabela. 11. Indeksi i Zhvillimit njerëzor në nivelin komunal

Komuna e Deçanit	Indeksi shëndetësisë	Indeksi i arsimit	Indeksi i të ardhurave	IZHNJ	Shëndetësi	Arsimimi		Të ardhurat
					Pritshmëria e jetëgjatësisë (përafërsisht)	Vitet mesatare të shkollimit	Vitet e pritura të shkollimit	Të ardhurat bruto shtetërore (ABSH) për frymë banori PPP, përafërsisht
	0.897	0.818	0.632	0.774	76.8	10.5	14.4	6.731

12. TË ARDHURAT MESATARE/GJENDJA SOCIALE

Nga të dhënat statistikore Agjensionit të Statistikave të Kosovës, shihet se numri i përfituesve të asistencës sociale në komunën e Deçanit ka ndryshuar nga viti në vit. Përkrahja sociale është e orientuar kryesisht drejt ndihmës monetare mujore për familjet e varfra, për personat me aftësi të kufizuar, përfshirë edhe fëmijët, për pensionistët të cilët e gëzojnë të drejtën e pensionit sipas ligjit në fuqi dhe për kategoritë e invalidëve të luftës dhe familjeve të dëshmorëve. Këto grupe të përmendura janë trajtuar si kategori sociale edhe përmes politikave qeveritare.

Tab. 12. Shpenzimet e familjes për kokë banori në Komunë

Komuna e Deçanit	Shpenzimet mestare të familjeve për kokë banori, euro në muaj	Kufiri i ultë	Kufiri i sipërm
	60.6	55.8	65.4

NUMRI I FAMILJEVE PËRFITUESE TË ASISTENCËS SOCIALE

Tab. 13. Numri i familjeve sociale

NR.	Periudha	Numri i familjeve
1	2017	380
2	2018	319
3	2019	312
4	2020	332
5	2021	328
6	2022	316
7	2023	316

13. EKONOMIA/POTENCIALI I KOMUNËS

13.1 BUXHETI

Tab. 14. Skema buxhetore sipas granteve dhe THV-Komunale

NR.		2023	2023	2025	2026
1	Granti i përgjithshëm	5,583,593	6,225,959.00	6,690,088.00	7,126,186.00
2	Granti për arsim	3,781,507	4,611,056.00	4,749,387.38	4,891,869.00
3	Huamarrja në arsim	0.00	0.00	0.00	0.00
4	Granti për shëndetësi	1,473,221	1,400,735.00	1,716,944.00	1,802,971.00
5	Shërbime rezidenciale	180,000.00	200,000.00	200,000.00	200,000.00
6	Gjithsej HVK (hyrat vetanake komunale)	1,108,485	1,021,505.00	1,076,000.00	1,112,099.00
	GJITHSEJ	12,129,805	13,459,255.00	14,432,419.38	16,933,125.00

Bazuar në trendët zhvillimore në komunë, planifikimi i buxhetit për vitin në vijim, mund të v'ie në konsideratë ndarja e buxhetit për programin e banimit kryesisht nga THV, shëndetësia dhe Grandi i përgjithshëm..... 1% e buxhetit total.

14. PLANIFIKIMI HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURA

Tab. 15. Sipërfaja e përfshirë në plane urbane

Nr.	Zonat - territori i mbuluar me plane urbane	Sipërfaqja totale e Komunës /ha	Sipërfaqja e zones me PU	Raporti %
1.	Qyteti i Deçanit dhe rrethina e ngushte PZHU dhe PRRU	29700 ha	99 ha	0.33 %
2.	Vendbanimet PZHU	37	//	//

Bazuar në të dhënat nga Planet Urbane për zonat urbane janë definuar rregullat e shfrytëzimit të tokës – parametrat urban si: ISHP max = 40%, 50%, banimi kolektiv dhe zonat ekonomike ISHP max 70% dhe 90%.

Në kuadër të PZHKU dhe PZHU janë definuar përmbajtjet për zonat dhe vendbanimet, kështu që në kuadër të zonave banimore, fokusohen zonat e caktuara për zhvillimin e banimit sipas programeve, si Zona në interes të veçantë potencial për zhvillimin e programeve të banimit social parashihen të ndërtohen objektet bonus banim në Rr.” Manastirit” në afërsi të objektit ekzistues.

Zonat e tilla do të jenë pjesë e zonave ekzistuese të banimit.

15. PROCESI I HARTIMIT TË PROGRAMIT

- Vendimi i Kryetarit të Komunës për formimin e Komisionit për hartimin e Programit Komunal për Banimin Social për periudhën 2023-2026 (5 anëtarë)
- Definimi i detyrave të punës së Komisionit.
- Drejtoratet mbështetëse - mbledhja e informatave për fushën e banimit nga sektorët që ndërlidhen me të brenda Komunës dhe nga institucionet e ndryshme,
- Dokumentet Komunale
- Struktura e buxhetit komunal
- Identifikimi i grupeve të synuara
- Përgatitja e dokumentit
- Procedurat e miratimit të dokumentit,
- Shqyrtimi publik
- Aprovimi nga Kuvendi i Komunës,
- Zbatimi dhe Monitorimi

16. GJENDJA FAKTIKE-ANALIZA

KOMUNA E DEÇANIT			
Nr. i popullsisë			40019
Zonat rurale			37
Zonat urbane			1
Nr. i fshatrave/nr i lagjeve			/
Banimi individual	Nr. objekteve para 1999		N/A
	Nr. objekteve pas 1999		Për informatat qe nuk ekzistojnë – largohen tabelat
	Etazhitet mesatar		/
Banimi kolektiv	Para 1999	Nr. objekteve	/
		Nj. banimi	/
	Pas 1999	Nr. objekteve	1
		Nj. banimi	16
	Etazhitet mesatar		P+3
Statusi pronësor (banim kolektiv) para 1999		Privat [nj. banimi]	//
		Shoqëror [nj. banimi]	//
Raporti banim individual/banim kolektiv në [%]			//
Kyçje në infrastrukturë të objekteve të banimit në [%]			100 %
Nr. i objekteve të pabanuara			Nuk ka
Nr. i objekteve me vlerë kulturo historike që shfrytëzohen për banim			Nuk ka
Aplikimi i masave termo-izoluese në objektet e banimit në [%]			PO
Ndërtimet ilegale	mbindërtimet		Nuk ka
	ndërtimet tjera		Nuk ka
	ndërtimet në pronë shoqërore		
Numri i kërkesave për zgjidhjen e çështjes së banimit			
Lokacionet (sipërfaqja e tokës) për programet e veçanta te banimit			Podi i Gështenjave-Deçan
Nr. i objekteve/nj. banimi e ndërtuara nga Komuna, Qeveria dhe Donoret			1
Nr. i objekteve/nj. banimi me qira nga dhe vlera mes. e qirasë			//
Nr. i objekteve/nj. banimi te disponushëm për qira te ulëta te tregut			//
Nr. i objekteve/nj. banimi ne pronësi te Komunës që mund të adaptohen			//
Qendrat e përkohshme kolektive (QPK)	Numri i QPK		1
	Vendndodhja /emërtimi		//
	Nr. i familjeve		//
	Nr. i banorëve		//
Planet rregulluese - sa janë bërë dhe sa janë që duhet të bëhen			Proces

17. KËRKESAT FAKTIKE PËR PËRKRAHJE

Gjendja sipas kërkesave dhe rastet aktuale për banim

	Kategoritë:		Gjendja faktike:	Të dhënat:
1.	Me asistencë sociale dhe nevoja		Kërkesa	32(2023)
2.	Kategoritë e dala nga lufta Familjet e dëshmorëve, invalidëve , veteranëve dhe martirëve		Te realizuara nga Komuna PPP kërkesa	
3.	Te kthyerit		Kërkesa	/
4.	Të riatdhesuarit		Te realizuara MPB dhe Komuna Kërkesa	0
5.	Të moshuarit		Kërkesa	/
6.	Të rinjtë		Kërkesa	8
7.	Të punësuarit nga buxheti shtetëror në komunën e Deçanit në: administratë, arsim dhe shëndetësi		Kërkesa	?
8.	Minoritetet sipas Agjensionit të Statistikave të Kosovës		Kërkesa për përmirësimin e kushteve të banimit	553
9.	Tregu i banimit	Qiraja mujore për objektet publiko- private	Deçan	/
10.	Shitja e banesave në treg		Aktuale	Çmimi sipas vlerës së tregut
11.	Të dhëna me qira	/	Objekti ne Rugën e Manastirit-banim social MMPH Komuna	//
12.	Me qira në kushte të caktuara	/	Te riatdhesuarit	
13.	Pa qira		Kategoritë	2
			Objekti ne Rugën e Manastirit-Banim Social	Objekti ne Rugën e Manastirit-Banim Social

			Banesa tjera në kuadër të objekteve ekzistuese	//
--	--	--	--	----

18. KATEGORITE E SYNUARA

Programet e veçanta të banimit

1. Sigurimi i banimit bëhet përmes financimit të programeve të veçanta të banimit me qira, ku përfshihen:

1.1. Banesat e ndërtuara nga Komuna, Qeveria dhe donatorët të cilat jepen me qira;

1.2. Banesat ekzistuese në pronësi të personave fizikë apo juridikë, të cilat mund të jepen me qira për familjet që posedojnë bonus të banimit;

1.3. Banesat tjera në pronësi të komunës, që mund të adaptohen për shfrytëzim në bazë të programeve të veçanta për banim.

Kategoritë e familjeve që mund të përfitojnë nga programet e veçanta të banimit

1. Kategoritë e familjeve që mund të përfitojnë nga programet e veçanta për Banim përfshijnë familjet që:

1.1. Nuk kanë banesë apo shtëpi në pronësi individuale;

1.2. Kanë mbetur pa banesë-shtëpi, si rezultat i dëmtimit të shtëpive gjatë luftës së fundit në Kosovë,

1.3. Posedojnë sipërfaqe banimi nën normat e banimit, të përcaktuara për atë kategori sociale dhe ekonomike.

2. Administrimi i kërkesave për programet e veçanta për banim bëhet nga organi kompetent komunal.

3. Normat e banimit sipas nën-paragrafit 1.3. të paragrafit 1. të këtij neni, Përcaktohen me Udhëzim Administrativ.

Përparësi në përzgjedhjen e përfituesve për subvencionim të qirasë kanë:

- 1.1. Familjet me shumë fëmijë;
- 1.2. Familjet që në përbërjen e tyre kanë persona me aftësi të kufizuara;

- 1.3. Familjet ku kryefamiljari është grua-mbajtëse e familjes;
- 1.4. Bashkëshorti ose bashkëshortja e shkurorëzuar që ka në përkujdesje fëmijë;
- 1.5. Fëmijët me statusin e jetimit.

19. KRITERET PËR PËRCAKTIMIN E RADHËS SË PËRPARËSISË

Në pajtim me dispozitat e Ligjit për financimin e programeve të veçanta të banimit kriteret e përparësisë për sigurimin e banimit për kategoritë e cekura në pikën 7.1 janë:

- Statusi i banimit;
- Lartësia e të ardhurave
- Gjendja shëndetësore
- Invaliditeti
- Struktura e familjes

Sipas, Udhëzimi Administrativë Nr. 21/2010 për Përcaktimin e Radhës së Përparësisë për Kategoritë e Familjeve që Mund të Përfitojnë nga Programet e Veçanta të Banimit janë 25 kriteret bazë të cilave familjet mund të përfitojnë banimin social, e ato janë si më poshtë:

Nr	Tabela e vlerësimit sipas kriterëve të përparësisë.			Pikët	
I	Stuatusi i Banimit	1.1	Familjet që jetojnë ne objekte te rrezikshme ose te përshtatshme për banim	10	
		1.2	Familjet që jetojnë ne objekte që janë nen normat minimale te banimit	8	
		1.3	Familjet që jetojnë ne objekte te huaja	6	
		1.4	Familjet që jetojnë me qira te tregut për me shume se 5 vjet.	4	
II	Lartësia e te ardhurave	2.1	Familjet me te ardhura mbi kufirin minimal mbi 150 euro .	10	
		2.2	Familjet me te ardhura nga 150-250.	8	

		2.3	Familjet me te ardhura nga 250-350.	6	
		2.4	Familjet nën kufirin minimal te të ardhurave te përcaktuara sipas nenit 6, të Ligjit, qe subvencionohen nga komuna	10	
III	Gjendja Shëndetësore	3.1	Familjet me përkujdesje te personavem fëmijëve me çrregullime te përhershme shendetesore	8	
		3.2	Sëmundje te renda kronike konsiderohen: Sëmundjet malinje, sëmundjet e renda te gjakut, diabeti deri tek rastet me isulinë, sëmundjet e ndryshme kronike te veshkave ne dializë dhe pas transplanteve te veshkës, forma të rënda të astmës, sëmundjet kronike të papërcaktuara të mushkrive, tuberkulozi, skleroza, sëmundjet e sistemit imunitar, format e renda të çrregullimeve te metabolizmit, epilepsia, sëmundjet e tjera të rënda të zemrës dhe neurozat.	6	
IV	Invaliditeti	4.1	Invalid me mbi 80% te dëmtimit trupor, të cilëve për jetë normale u nevojitet përkujdesja dhe ndihma e një personi tjetër	10	
		4.2	Invalid me 71% deri 80 % të dëmtimit trupor.	9	
		4.3	Invalid me 61% deri 70 % të dëmtimit trupor.	8	
		4.4	Invalid me 51% deri 60 % të dëmtimit trupor.	7	
		4.5	Invalid me 41% deri 50 % të dëmtimit trupor.	6	
		4.6	Invalid me 31% deri 40 % të dëmtimit trupor.	5	
		4.7	Invalid me 21% deri 30 % të dëmtimit trupor.	4	
		4.8	Invalid me 10% deri 20 % të dëmtimit trupor.	3	
V	Struktura e Familjës	5.1	Të moshës 0-5 vjet qe kane nevojë per përkujdesje te plote	8	
		5.2	Ndërmjet moshës 6-18 vjeqar, qe janë ne shkolla	6	
		5.3	Ndërmjet moshës 18-25 vjeqar, qe janë ne shkolla	4	
		5.4	Të moshës mbi 65 vjeqar.	3	
VI	Kriteret Shtesë	6.1	Familje dëshmor.	10	
		6.2	Familje e kryesuar nga një prind.	9	
		6.3	Familje ne përkujdesje te fëmijëve jetim.	8	

--	--

Familjët më të ardhura nën kufirin minimal të përcaktuara sipas nenit 6 të Ligjit, vetëm në raste kur Komuna subvencionon qiranë joprofitabile sipas paragrafit 3 të nenit 7 të këtij Udhëzimi Administrativ.

20. KLASIFIKIMI I NEVOJAVE SIPAS URGJENCËS SË TRAJTIMIT TË TYRE

Periudha afatshkurtër 1 -6 vite me mundësi vazhdimi

- Rastet sociale të cilat do të klasifikohen me bonus banimi – Komisionet komunale dhe Vendimi të Komunës.
- Te riatdhesuarit.

❖ Raste me prioritet në fazën e parë

1. Për shfrytëzimin e banesave lidhet kontrata me shkrim për qira, ndërmjet autoriteteve komunale dhe familjes përfituese.
2. Përmbajtja e kontratës për qiranë, përgjegjësitë e palëve nga kjo kontratë si dhe çështjet tjera rreth shfrytëzimit të banesave me qira, rregullohen me
3. Udhëzim Administrativ të Ministrisë përgjegjëse për fushën e banimit.

Administrimi dhe mirëmbajtja e banesave

1. Banesat me qira nga programet e veçanta të banimit administrohen nga Organi Kompetent Komunal.
2. Mirëmbajtja e banesave me qira nga programet e veçanta të banimit kryhet nëpërmjet kontraktimit të personave juridik të licencuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

21. VEPRIMET KRYESORE QË DO TË NDËRMERRËN

Komuna e Deçanit në harmoni me Planin Zhvillimor Komunal dhe Hartën Zonale do të planifikoj ndërtimin e objekteve për banim social, i cili planifikim do vij në shprehje pasi komuna të përmbyll procesin e pronësisë në pronat mbi të cilat është shpallur interesi komunal.

21.1 PROGRAMET

Duhet te merren parasysh tre mënyra te ndihmës si ne vijim:

- banesat e ndërtuara nga Komuna, Qeveria dhe donatorët të cilat jepen me qira;
- banesat ekzistuese në pronësi të personave fizikë apo juridikë, të cilat mund të jepen me qira për familjet që posedojnë bonus të banimit;
- banesat tjera në pronësi të komunës, që mund të adaptohen për shfrytëzim në bazë të programeve të veçanta për banim

Programet e identifikuara më lartë mund të jenë i adekuate për nevojat e banimit në Komunën e Deçanit.

20.1.1 Adaptimi i objekteve ekzistuese për banim

- Objektet në pronësi komunale janë 14 shtëpi në fshatin Baballoq, të cilat mund të shfrytëzohen për banim social.

20.1.2 Banesat me Bonus Banimit

Banesa ekzistuese, në pronësi të personave fizik apo juridik, të cilat do të klasifikohen nga autoritetet kompetente si banesa për programe të veçanta të banimit që mund të jepen me kontratë qiraje - qira të tregut më të ulët për familjet që përfitojnë bonus banimi- objektet kolektive me bashkëfinancim të përbashkët publiko-private.

1. Kuvendi komunal çdo vit aprovon shumën e qirasë vjetore për banesat me qira e cila përcaktohet sipas formulës:

$$Q_{jm} = \frac{V_b \times 0.04}{12}$$

ku: Q_{jm} - Qiraja jo profitabile mujore

2. Qiraja e grumbulluar nga banesat shfrytëzohet për mbulimin e kostos së administrimit, mirëmbajtjes, amortizimit, riparimet e rregullta dhe investuese të objektit të banimit .

3. Qiramarrësi, përveç qirasë, paguan edhe të gjitha shpenzimet tjera që lidhen me shfrytëzimin e zakonshëm të banesës.

4. Vlera vjetore e qirasë nuk duhet të jetë më e madhe se katër përqind (4%) e kostos së ndërtimit të banesës së shtetit, për ndërtim të ri, apo katër përqind (4%) e vlerës së banesës në treg.

5. Kur banesat e programeve të veçanta financohen nga burime tjera të përcaktuara me nën-paragrafin 1.3 të nenit 15 dhe me nën-paragrafin 1.3 të nenit 19 të këtij ligji vlera e qirasë e shprehur me Euro/m², përcaktohet për çdo rast specifik në bashkëpunim në mes subjekteve që financojnë dhe komunës ku zbatohet projekti dhe miratohet me vendim të Kuvendit Komunal.

20.1.3 Subvencionimi i qirasë:

1. Për familjet të cilat nuk kanë mundësi financiare të bëjnë pagesën e qirasë, Komuna subvencionon deri në pesëdhjetë përqind (50%) të shumës së qirasë që duhet ta paguajë familja. Subvencionimi jepet vetëm pas verifikimit të gjendjes ekonomike të familjes, sipas nenit 12, të këtij ligji.

2. Subvencionimi i qirasë, që përfiton çdo familje, bëhet nga të ardhurat e komunave dhe me aprovimin e Kuvendit Komunal. Komunat që nuk arrijnë të realizojnë të ardhura të mjaftueshme mund të financohen nga Buxheti i Republikës së Kosovës.

20.1.4 Sigurimi i banimit me kushte të volitshme për financim

Ndërtimi i objekteve në pronësi komunale apo private me bashkëfinancim, ku autoritetet komunale mund të marrin pjesë me hartimin e dokumenteve planore dhe pajisjen e lokacionit me infrastrukturë dhe menaxhimin, apo forma tjera lehtësuese duke krijuar partneritet me subjektet private apo donatorët, kjo vjen në shprehje edhe në rastet e shpronësimit, legalizimit, dhe vendbanimeve joformale, dhe ndarja e banesave (sipërfaqes së ndërtimit) bëhet në raport me vlerën financiare të pjesëmarrjes.

20.1.5 Menaxhimi administrimi dhe realizimi i projekteve për përmirësimin e kualitetit të banimit

Realizimi i projekteve për përmirësimin e kushteve të banimit në objektet ekzistuese të banimit kolektiv dhe individual në bashkëpunim me pronaret sipas bazës ligjore - bashkëfinancim, përmes sektorit të banimit apo subjekt i kontraktuar i licencuar për këtë veprimtari.

1. Përfitimi nga programet e banimit bazohet në verifikimin e gjendjes ekonomike të familjes.
2. Verifikimi i gjendjes ekonomike të familjes bëhet nga organi kompetent komunal.
3. Procedurat për përfitim nga programet e banimit përcaktohen me Udhëzim Administrativ nga Ministri i Ministrisë që mbulon fushën e banimit.
4. Organi kompetent komunal e njofton familjen për rezultatet e verifikimit të gjendjes ekonomike. Pas verifikimit të gjendjes dhe vlerësimit të familjeve përfituese lëshohet vendimi në afat prej tridhjetë (30) ditësh kalendari

20.2 ANALIZA E FAKTEVE DHE PROJEKTET NË BAZË TË PROGRAMEVE

Të dhënat		
I.	Llojet e programeve të konsideruara si të nevojshme	Ndërtimi i njësive të reja banesore të cilat do të jepen me qira joprofitabile
		Adaptimi i objekteve ekzistuese për banim -14 objekte në Lagjen Baballoq- fshati Baballoq
		Banesat me Bonus Banimit - Një objekt 16 njësi të banimit.
		Sigurimi i banimit me kushte të volitshme për financim Sigurimi i pronësisë për ndërtimin e objektit, rregullimi i procedurave administrative-dokumentacionit investive-teknik. - Një objekt me 16 njësi të banimit
		Menaxhimi administrimi dhe realizimi i projekteve për përmirësimin e kualitetit të banimit. Menaxhimi i objekteve me bashkëfinancim publiko-privat, komuna e ka pjesëmarrjen me 21 %. Komuna me pjesëmarrjen prej 21 % përfiton mjete materiale(finaciare) si dhe kompensim të banorëve për objektet ekzistuese gjithashtu bëhet kompensim i banesave në m² kurse pjesa e mbetur kthehet në vlerë finaciare.
	Prezantimi i gjendjes faktike	Ndërtesa të banimit kolektiv që ndërtohen në pronësi të komunës dhe me PPP, një pjesë e të cilave jepen me kontrate qiraje - qira joprofitabile për kategori të ndryshme në Rr. ‘Manastiri’, afërsi të objektit ekzistues për banim social.
		Objektet e dala jashtë funksionit si rezultat i mbylljes së ndonjë veprimtarie të cilat mund të adaptohen në funksion të banimit për programet e veçanta të banimit, të cilat janë në pronësi komunale apo pronësi shoqërore tjetër që mund të transferohet (Objektet ekzistuese në fshatin Baballoq), prej të cilave 14 objekte menaxhohen nga komuna kurse të tjerat nga UNHABITAT.
		Banesa ekzistuese, në pronësi të komunës, të cilat do të klasifikohen nga autoritetet kompetente si banesa për programe të veçanta të banimit që mund të jepen me kontratë qiraje - qira të tregut më të ulët për familjet që përfitojnë bonus banimi dhe (Objektet PP)
		Ndërtimi i objekteve në pronësi komunale apo private me bashkëfinancim, ku autoritetet komunale mund të marrin pjesë me hartimin e dokumenteve planore dhe pajisjen e lokacionit me infrastrukturë dhe menaxhimin, apo forma tjera lehtësuese duke krijuar partneritet me subjektet private apo donatorët, kjo vjen në shprehje edhe në rastet e shpronësimit, legalizimit, dhe vendbanimeve joformale dhe ndarja e banesave (sipërfaqes së ndërtimit) bëhet në raport me vlerën financiare të pjesëmarrjes.

		Realizimi i projekteve për përmirësimin e kushteve të banimit në objektet ekzistuese të banimit kolektiv dhe individual në bashkëpunim me pronaret sipas bazës ligjore - bashkëfinancim, përmes sektorit të banimit apo subjekt i kontraktuar i licencuar për këtë veprimtari.			
	Kërkesat faktike për përkrahje me sigurim të banimit	Familjet që nuk kanë banesë apo shtëpi në pronësi individuale <i>Familjet që kanë mbetur pa shtëpi si pasojë e dëmtimeve të shtëpive gjatë luftës së fundit</i> Familjet që posedojnë sipërfaqe banimi nën normat e banimit, të përcaktuara për atë kategori sociale dhe ekonomike.			
	Veprimet kryesore që do të ndërmerren	Aktivitetet në kuadër të projekteve (të specifikuara në Formularin e projekteve. Projektet e planifikuara për banim social do të kenë prioritet për përfitim sipas skemës buxhetore të komunës.			
	Justifikim i veprimeve dhe shpjegimin e rezultateve	Komuna e Deçanit në harmoni me Planin Zhvillimor Komunal dhe Hartën Zonale do të planifikoj ndërtimin e objekteve për banim social, i cili planifikim do vij në shprehje pasi komuna të përmbyll procesin e pronësisë në pronat mbi të cilat është shpallur interesi komunal.			
	Kohëzgjatja e realizimit të programeve	2023 - 2026			
	Mundësitë e kapaciteteve njerëzore dhe materiale	Formimi i Sektorit të banimit në kuadër të DPUMM Definimi i lokacioneve Planifikimi i buxhetit komunal			
	Mënyra e financimit të programeve tre vjeçare	2023	2024	2025	2026
		Buxheti komunal Niveli qendror-MMPH, MPB, MPMS, MKK Donatoret PPP	Buxheti komunal Niveli qendror-MMPH, MPB, MPMS, MKK Donatoret	Buxheti komunal Niveli qendror-MMPH, MPB, MPMS Donatoret	Buxheti komunal Niveli qendror-MMPH, MPB, MPMS Donatoret

	Përputhja e programeve me planet zhvillimore të komunës	PZHK dhe HZ në proces të miratimit – janë definuar zonat e banimit të gjithë vendbanimet.			
	Instrumentet mbikëqyrëse	Drejtoria për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit Zyrtari për banim – periudhë afatshkurta Zyra e Kryetarit Sektori i banimit – afatmesëm Agjensionit për Banim – afatgjatë			
	Instrumentet e garantimit të realizimit të programeve	Programet e caktuara, monitorimi, Raportet periodike Vendimet e Kuvendit			
	Transparenca me hartimin dhe zbatimin e programeve	Analiza e vazhdueshme e nevojave për banim Debati publik me grupet e caktuara Publikimet, Raportet, Informimi i vazhdueshëm			
	Analizat SWOT	Anët e forta	Dobësitë	Mundësitë	Rreziqet

SYNIMI

Krijimin e kushteve për banim të përshtatshëm dhe të qëndrueshëm në harmoni me standardet dhe normat evropiane të banimit, me qëllim që të mundësohet zgjidhja e nevojave për banim për grupe të caktuara të cilat nuk kanë forcë ekonomike që këtë problem ta zgjidhin sipas parimeve të tregut.

22. JUSTIFIKIMI I VEPRIMEVE DHE SHPJEGIMIN E REZULTATEVE TË PRITSHME

Në mënyrë që të sigurojë zbatimin e projekteve të planifikuara brenda mundësive ligjore dhe buxhetore do të shqyrtohet mundësia për formimin e Sektorit të banimit, i cili do të jetë përgjegjës për koordinimin e të gjitha aktiviteteve të planifikuara.

Sektori i banimit është një organ i përhershëm që do të formohet me qëllim të monitorimit dhe vlerësimit të zbatimit të projekteve dhe detyrave nga Programi i banimit, si:

- Rishikimin e Programit dhe Planit të Veprimit
- Mbështetjen e Kryetarit të Komunës për marrjen e Vendimeve që lidhen me zhvillimin e banimit dhe programet lokale që mbështesin fushën e banimit.

Procesi i monitorimit do të përfshijë këto aktivitete:

- Shkalla e suksesit të Programit në krahasim me Planin e Veprimit
- Planifikimi i fondeve dhe harmonizimi i tyre në raport me afatet kohore
- Ndryshimet e mundshme të cilat mund të ndikojnë në realizimin e projekteve (individët, organizatat)
- Ndryshimet e jashtme që mund të ndikojnë në Planin e Veprimit, si dhe propozimet për alternativat e zgjidhjeve të ndikuara nga faktorët tjerë- harmonizimi.

Rezultatet pas zbatimit

- Programi është hartuar në mënyrë që mund të matet dhe të monitorohet.
- Monitorimi është një tipar i domosdoshëm për shkak se ai siguron që veprimet janë zbatuar dhe se përpjekjet janë duke u bërë për të siguruar përshtatjen me ndryshimet në burimet e disponueshme dhe të nevojshme.

Pas përfundimit të çdo projekti në mënyrë transparente do t'i komunikohet publikut mbi statusin. Projektit - të paktën në përmbajtje:

- Cilat janë qëllimet,
- Cilat janë treguesit e performancës,
- Cila është rëndësia e projektit të realizuar.

Për këtë do të raportohet çdo vit Kryetarit të Komunës dhe do të zhvillohet vlerësimi i performancës.

23. THEMELIMI I SEKTORIT TË BANIMIT

Strategjia për Banim në Komunën e Deçanit mbulon periudhën 2023 - 2026. Komisioni ka përgatitur propozimet për projektet prioritare zbatimi i të cilave rezulton në arritjen e Synimeve zhvillimore të përcaktuara në fushat kyçe, detyrimet aktiviteteve, bartësit kryesor, afatin kohor të implementimit, përgatitjes dhe koordinimit të aktiviteteve të përgjithshme për implementimin e projekteve.

Në mënyrë që të sigurojë zbatimin e projekteve të planifikuara do të shqyrtohet mundësia për formimin e Sektorit të banimit i cili do të jetë përgjegjës për koordinimin e të gjitha aktiviteteve të planifikuara.

Spektori i banimit është një organ i përhershëm që do të formohet me qëllim të monitorimit dhe vlerësimit të zbatimit të projekteve dhe detyrave nga Programi i banimit, si rishikimin e Strategjisë dhe Planit të Veprimit dhe mbështetjen e Kryetarit të Komunës për marrjen e Vendimeve që lidhen me zhvillimin e banimit dhe programet lokale që mbështesin fushën e banimit. Nga të dhënat e mësipërme, si prioritet dhe mund të zhvillohen programet e cekura :

- Sigurimi i banesave me bonus banimi – objektet në finalizim.
- Ndërtimi i objekteve të reja në Deçan.

Duhët të themelohet sektori i banimit – apo në mungesë të buxhetit të formohet Komisioni për hartimi e dokumenteve plotësuese për procesin që do të zhvillohet.

24. MËNYRA E FINANCIMIT TË PROGRAMEVE TRE VJEÇARE

Tabela17. Skema buxhetore sipas granteve dhe THV-Komunale

NR.		2023	2024	2025	2026
-----	--	------	------	------	------

1	Granti i përgjithshëm	5,583,593	6,225,959.00	6,690,088.00	7,126,186.00
2	Granti për arsim	3,781,507	4,611,056.00	4,749,387.38	4,891,869.00
3	Huamarrja në arsim	0.00	0.00	0.00	0.00
4	Granti për shëndetësi	1,473,221	1,400,735.00	1,716,944.00	1,802,971.00
5	Shërbime rezidenciale	180,000.00	200,000.00	200,000.00	200,000.00
6	Gjithsej HVK (hyrat vetanake komunale)	1,108,485	1,021,505.00	1,076,000.00	1,112,099.00
	GJITHSEJ	12,129,805	13,459,255.00	14,432,419.38	16,933,125.00

- Definimi i pronës komunale.
- Planin financiar të parashikuar dhe të garantojë përdorimin efikas tyre.
- Pjesë e buxhetit komunal.
- Procedurat – auditimi, raportimi.
- Burimet tjera të cilat mund të përdoren ose mund të ndihmojnë për zbatimin e programeve.
- Do të definohen kategoritë e shpenzimeve:
- Aplikim ne fonde.
- Krijim i partneritetit me autoritetet qendrore si MMPH, MPMS, MSH, MPB, institucionet tjera bankat.
- Parashikimi i nevojave për vitet e ardhshme bazuar në analiza dhe metoda shkencore të besueshme parashikimin e nevojave për vitet e ardhshme bazuar në analiza dhe metoda shkencore të besueshme
- Plani vjetor i punës ne kuadër te Drejtoratit kompetent – fusha e banimit
- Analizat dhe krijimi i bazës së të dhënave.

25. BURIMET PËR FINANCIMIN E PROGRAMEVE TË FINANCIMIT TË PROGRAMËVE TRE VJEÇARE TË BANIMIT

Të hyrat vetanake

Donatoret

PPP

Planifikimi i buxhetit **12,129,805** minimum 0. 1% e buxhetit total për vitet në vijim

- **Mundësia e financimit me nivelin e të hyrave**

Fondi nga shitja e banesave

Takse e veqante ne kuadër te lejeve te ndërtimit për ndërtesat kolektive (me theks rastet te cilat definoohen me bonus banimi).

Vendosja ne prioritetet e komunës – planifikimi i buxhetit

Te hyrat vetanake

Donatoret

PPP

- **Mundësia e financimit me nivelin e të hyrave**

Fondi nga shitja e banesave

Takse e veqante ne kuadër te lejeve te ndërtimit për ndërtesat kolektive(me theks rastet te cilat definoohen me bonus banimi)

- *Trajtimi i çështjes së fushës së banimit*

Respektimi i normave – Kodi unik

- *Planin financiar të parashikuar dhe të garantojë përdorimin efikas tyre.*

*Pjese e buxhetit komunal- **Kodi unik për banim.***

- *Burimet tjera të cilat mund të përdoren ose mund të ndihmojnë për zbatimin e programeve*

Do te definoohen kategoritë e shpenzimeve:

- *Parashikimi i nevojave për vitet e ardhshme bazuar në analiza dhe metoda shkencore të besueshme parashikimin e nevojave për vitet e ardhshme bazuar në analiza dhe metoda shkencore të besueshme*

Plani vjetor i punës ne kuadër te Drejtoratit kompetent –sektori i banimit.

26. PËRPUTHJA E PROGRAMEVE ME PLANET ZHVILLIMORE TË KOMUNËS

Harmonizuar me Planin Zhvillimor Komunal dhe me Hartën Zonale të cilat janë në proces të miratimit.

27. INSTRUMENTET E MBIKËQYRJËS

Themelimi i sektorit të banimit i cili do të jetë përgjegjës për koordinimin e të gjitha aktiviteteve të planifikuara i mundëson fillimisht komunës që të ketë mbikëqyrje direkt në zbatimin e Projekteve të Banimit. Sektori i banimit për çdo 6-të muaj do të raportojë Asamblesë Komunale mbi të arriturat dhe pengesat në zbatimin e programit, ky veprim mund të konsiderohet si mjet efikas mbikëqyrjes. Mirëpo, edhe vetë Ligji e parasheh që MMPH të bën mbikëqyrjen e zbatimit të tij përmes inspektorëve urbanistikë.

Sektori i banimit i cili do të formohet në kuadër të DPUMM, dhe më pas Agjensionit për banim, i cili do të financohet nga Komuna dhe ka për detyrë që të zhvillojë aktivitetet e mirëmbajtjes, implementimin e programit të banimit dhe zhvillimin e programeve tjera duke përcjelle dhe analizuar në vazhdimësi situatën e banimit.

28. INSTRUMENTET E GARANTIMIT TË REALIZUESHMËRISË SË PROGRAMEVE

Monitorimi është një mjet i domosdoshëm për sigurimin e vazhdimësisë së zbatimit duke i adresuar dhe përshtatur ndryshimet dhe pengesat në proces, përfshinë këto aktivitete:

- Shkalla e suksesit të Programit në krahasim Planin e Veprimit,
- Planifikimi i fondeve dhe harmonizimi i tyre në raport me afatet kohore,
- Ndryshimet e mundshme të cilat mund të ndikojnë në realizimin e projekteve (individët, organizatat),
- Ndryshimet e jashtme që mund të ndikojnë në Planin e Veprimit, si dhe propozimet për alternativat e zgjidhjeve të ndikuara nga faktorët tjerë- harmonizimi.
- Bërja publike e raporteve të vlerësimit e bënë edhe më të qëndrueshëm zbatimin e PTB.
- Të planifikojnë buxhetin krahas buxhetit komunal dhe burimeve tjera relevante nga fusha e banimit. Të përcjellin-monitorojnë situatën në vazhdimësi të banorëve të cilët janë pjesë e këtyre programeve.

29. MASAT QË JANË MARRË PËR RESPEKTIMIN E KUADRIT LIGJOR

Strategjia për Banim Sociale është produkt i projektit të përbashkët në mes Komunës dhe MMPH, si dhe donatarorëve. Me Ligjin për Finacimin e Programeve të Veçanta të Banimut ku programet sociale i bënë të përgjegjshëm ndaj ligjeve dhe udhëzimeve administrative duke përcaktuar treguesin e suksesit, mjetin e verifikimit, institucionin përgjegjës dhe mbështetës për secilin veprim, përfshirë këtu edhe instrumentet e parapara mbikqyrëse e përmbyllë qarkun në respektimin e kuadrit ekzistues ligjor.

30. PËRFSHIRJA E PUBLIKUT NË PROCESIN E SIGURIMIT TË TRANSPERENCËS

Publiku ka dhe do të ketë të drejtën të dijë mënyrën sesi shpenzohen të ardhurat e komunës në tërësi dhe ato të programeve tre vjeçare në veçanti e këto të dhëna do t'i sigurohet duke përfshirë publikun në procesin e sigurimit të transparencës si:

- zhvillimin e takimeve konsultuese me publikun;
- bërja e anketimeve apo studimeve të ndryshme për marrjen e mendimit të publikut;
- bërjen publike të programeve dhe projekteve që përfshijnë ato
- sigurimit të pjesëmarrjes së publikut gjatë diskutimeve që organet përkatëse do të zhvillojnë për hartimin, miratimin dhe zbatimin e programeve;
- bërjen e njoftimeve të ndryshme në mjetet e informimit publik apo në vend njoftimet komunale për aktivitetet ku mund të sigurohet pjesëmarrja e publikut
- çdo masë tjetër e cila vlerësohet e nevojshme në përmbushje të këtij qëllimi.

31. ÇËSHITJE TË TJERA

Gjatë hartimit të programeve tre vjeçare janë marrë parasysh këto standarde

- Realizueshmëria
- Qëndrueshmëria
- Efikasiteti
- Kapacitetet njerëzore dhe materiale
- Respektimi i ligjit
- Barazia
- Ndikimi në mjedis dhe energjia e pastër
- Normat e banimit
- Ndërthurja e këtyre programeve me politikat qendrore të banimit
- Transparenca
- Standarde të tjera

32. SWOT ANALIZA

PËRPARËSITË	DOBËSITË
-------------	----------

• Ekzistimi i dokumenteve të planifikimit hapësinor • Ekzistimi i iniciativave për PPP në fushën e ndërtimeve -banimit • Infrastruktura në zonat urbane • Subjektet e ekonomike shfrytëzues • Nevoja për zona të reja të banimit • Ekzistimi i zonave të planifikuara për banim • Ligjet nga fusha e banimit • Burimet njerëzore, autoritetet komunale të përkushtuara për kategoritë e rrezikuara • Regjistrimi i popullsisë • Të dhënat për kërkuesit • Mbulueshmëria me infrastrukturë • Strategjitë komunale • Interesimi i qytetareve për pjesëmarrje në këto programe • Ekzistimi i objekteve të vjetra të banimit të cilat mund të adaptohen për banim dhe të shtohet fondi banesor.	• Deri më tani nuk ka pasur program të tillë • Parcela të vogla • Mungesa e hapësirave për shërbime • Mungesa e kodit unik për banim • Oferta dhe kërkesa jo të harmonizuara • Kosto e larte e pajisjes me inf.,. Adekuate • Kosto e larte e banimit dhe kualiteti i ndërtimit jo adekuat • Kapacitete jo të mjaftueshme komunale për zhvillimin e banimit social • Nuk ka programe të mjaftueshme që ndërmerren për kategoritë e caktuara • Mungesa e interesimit të grupeve tjera për pjesëmarrje në këtë shtet të rinjve • Pronësia e pa definuar ... AKP • Mirëmbajtja e objekteve të banimit kolektiv jo e organizuar (jo e kompletuar). • Mungesa e sektorit për banim pranë DUPHMM
MUNDËSITË	RREZIQET
• Ligjet dhe Programet shtetërore për banim • Strategjitë komunale dhe qendrore • Formimi i sektorit për banim • Skemat garantuese • Programet në nivel komunal • Stimulimet për grupet e caktuara, • Programet në nivel qendror në mbështetje në nivel lokal nga fusha e ndërtimit/banimit. • Ligjet përkatëse të inkurajojnë zhvillimin e banimi (Ligji PPP) • Linja të favorshme të bankës, kreditë për banim • Mbështetje për ndërtimet në pronësi private – procedurat për mirësimin e tyre. • Programe mbështetëse nga partner kombëtarë dhe ndërkombëtarë në fushën e banimit.	• Problemet e vazhdueshme ekonomike dhe financiare, • Mungesa e fondeve në nivel lokal, • Kontrolli jo i mjaftueshëm në fushën e ndërtimeve, • Trendi i rritjes së numrit të popullsisë në zonat urbane në raport me planet financiare dhe materiale në fushën e ndërtimit, • Papunësia dhe mungesa e punësimit, • Niveli i lartë i varfërisë, Fenomeni i largimit apo e ashtuquajtura “ikje e trurit”, • Mungesa e fondeve në nivel lokal, • Kontroll jo i mjaftueshëm nga fusha e ndërtimeve, • Vonesat si dhe procedurat nga AKP.

33. PLANI I VEPRIMIT DHE PROGRAMI TREVJEÇAR PËR BANIM SOCIAL

TABELA 18

PROGRAMET E BANIMIT	NR. i Prog	Synimi i ndërtimit të banesave për strehim								
		Objektivat	Veprimet	Prioriteti: i lartë i mesëm, i ulët	Treguesit e suksesit	Mjetet e verifikimit	Institucioni përgjegjës	Institucioni mbësh tetës	Afati kohor	Burimet financiare
			Marrja e vendimit për formimin e komisionit për identifikimit të pronave komunale.	I lartë	Komisioni funksional	Ligji për Vetëqeverisjen Lokale, nr. 03/L-040-Statuti i Komunës	K. Komunal; Drejtoria për Pronë dhe Kadastër	Kryetari	10 ditë	S'ka kosto
	PROGRAMI I	O. 1 Përcaktimi i parcelave për ndërtim, pronë Komunale ;	Identifikimi i parcelave në pronësi Komunale	I lartë	Lista e parcelave në pronësi komunale	Statuti i Komunës; Ligji për Vetëqeverisjen Lokale	Komuna e Deçanit ;DGJKP dhe DUMM	Drejtori	15 ditë	S'ka kosto
			Vendim për ndarjen e parcelës për ndërtim	I lartë	Vendimi i Asamblesë Komunale	Ligji për Vetëqeverisjen lokale, nr. 03/L-040-Statuti i Komunës PZHK/PZHU	Kuvendi Komunal-Kryetari i Komunës	Kuvendi Komunal	2 muaj	S'ka kosto

			Marrja e Vendimit për ndërtimin e Objektit B+P+3K	I lartë	Kuvendi Komunal	Ligji për Vetëqeverisje Lokale; Ligji për Financimin e Programeve të Veçanta të Banimit PZHK/PZHU	Kryetari i Komunës, DUMM	Menaxher i projektit dhe organin mbikëqyrës	2 muaj	S'ka kosto
		O. 2 Ndërtimi i objektit banesor për dhënien me qira joprofitabile	Hartimi i kushteve ndërtimore. Kushtet tekniko-urbanistike dhe detyra projektuese	I lartë	Ligji i ndërtimit HZ si dhe Plani Detal	Kushtet Ndërtimore të hartuara, si dhe programi me numrin, madhësinë dhe llojin e njësive banesor në ndërtesë U. A. nr. 24/2010 Për normat të banimit për banesat nga Programet e Veçanta të Banimit	Drejtoria e Urbanizmit	MMP H/DB N	15-30 ditë	S'ka kosto
			Shpallja e tenderit për hartimin e Projektit të Ndërtimit	I lartë	Lista e ofertuesve	Ligji i prokurimit	Zyra e Prokurimit	Kryetari	2 muaj	S'ka kosto

			Përzgjedhja e Projektit për Implementim	I lartë	Projekti për zbatim	Ligji i prokurimit , Ligji i Ndërtimit, Nr. 04/L - 110	Zyra e Prokurimit Komisioni Vlerësues	KRRP P-OSHP	10 ditë	S'ka kosto
			Nënshkrimi i Kontratës mes AK dhe OE	I lartë	Kontrata	Ligji i prokurimit , Ligji i ndërtimit	Kryetari dhe Zyra e Prokurimit	KRRP P-OSHP	1 ditë	S'ka kosto
			Shpallja e tenderit për ndërtim; Përzgjedhja e Operatori ekonomik për zbatim të Projektit dhe nënshkrimi i Kontratës mes AK dhe OE	I lartë I lartë	Lista e operatorë ve ek. Kontrata	Ligji i prokurimit , Ligji i ndërtimit	Kryetari dhe ZP	KRRP P-OSHP	1 muaj	S'ka kosto
		O. 3 Rivlerësi mi i gjendjes ekonomike të familjeve në përputhje më UA, nr. 18/2010 të Ligjit nr. 03/L-164	Formimi i Komisionit për Vlerësim nga 3- 5 anëtarë	I lartë	Komision funksional	Ligji për Financimin e Programeve të Veçanta të Banimit PZHK/PZHU Vendimi i K. Deçanit	Kryetari i Komunës	MMP H/DB N	10 ditë	S'ka kosto
			Rivlerësimi i gjendjes ekonomike të familjeve me qëllim të vazhdimit ose ndërprerjes së Kontratës	I lartë	Lista e familjeve të rivlerësuar	Udhëzimi Administrativ, nr. 21/2010 Për përcaktimin e radhës së	Komisioni	Kryetari i Komunës dhe Kuvendi Komu	2 muaj	S'ka kosto

						përparësis ë UA nr. 18/2010 të Ligjit nr .03/L-164		nal		
			Përpilimi i listës përfituese.	I lartë	Lista e përfituesv e	Ligjit nr. 03/L-164	Komisioni	Kuven di Komu nal.	20 dit	S'ka kosto
			Largimi i familjeve që nuk plotësojnë kriteret	I lartë	Vendimi për largim	Ligjit nr. 03/L-164	Inspektori	Policia e Kosov ës	2 muaj	
			Përzgjedhja e Familjeve të reja përfituese	I lartë	Lista e përfituesv e	Ligjit nr. 03/L-164	Komisioni	Kryeta ri I Komu nës	1 muaj	S'ka kosto
			Nënshkrimi i Kontratave	I lartë	Kontrata të nënshkru ara	UA nr. 18/2010 të ligjit nr. 03/L-164	Kryetari dhe përfituesi/et	Kryeta ri I Komu nës	Shkur tër	N/A
	DPOCD	O .1 Marrja më qira me bonus e banesave - shtëpive private	Caktimi i vlerës së bonusit të banimit për vitin aktual	I lartë	Vendim mbi vlerën e bonusit të banimit	Ligji për financimin e programev e të veçanta të banimit Udhëzimi Adm. nr .19/2 010 mbi përmbajtje n e bonusit e banimit.	K. Komunal	MSH MS/ MMP H	1 vjeçar	50% e vlerës së qirasë minim ale
			Formimi i Komisionit për	I lartë	Vendimi	Ligjit nr. 03/L-164	Kryetari DUMM	Kryeta ri	10 ditë	N/A

			Identifikimin e Banesave							
			Kontakti më Pronaret e Banesave – Shtëpive	I lartë	Lista e pronarëve	Ligjit nr. 03/L-164	Komisioni	Kryetari	20 ditë	N/A
			Hartimi i Listës së banesave-shtëpive të mundshme për dhënie me qira	I lartë	Lista e banesave	ligjit nr. 03/L-164	Komisioni	Kryetari	20 ditë	N/A
			Hartimi i Marrëveshjes me pronarët për shfrytëzimin e banesave më qira me bonus	I lartë	Kontrata mes palëve	ligjit Nr. 04/L-134 Udhëzimi Adm. nr. 19/2 010 mbi Përmbajtjen e bonusit e banimit.	Zyra Ligjore	Zyra Ligjore	5-10 ditë	N/A
		O .2 Administrimi dhe mirëmbajtja e ndërtesave në bashkëpronësi	Zgjedhja e Administratorit	I lartë	Kontrata për administrim	Ligji Nr. 04/L-134 Për shfrytëzimin në administrimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesës në bashkëpronësi	Pronarët e banesave	DI	10-15 ditë	S'ka kosto
			Hartimi i Projektit menaxhues	I lartë	Programi menaxhues	Ligji Nr. 04/L-134 Për shfrytëzimin në administrimin	Bashkësia e pronarëve	DI	30 ditë	S'ka kosto

						min dhe mirëmbajtjen e ndërtesës në bashkëpronësi				
			Nënshkrimi i Kontratës për administrim	I lartë	Marrëveshja mes palëve	Ligji Nr. 04/L-134 Për shfrytëzim in administrimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesës në bashkëpronësi	Me Bashkësia e pronarëve	Komuna-DIDUM	5-10 ditë	S'ka kosto

34. PËRFUNDIMI

Nevoja për hartimin dhe zbatimin e efektshëm të Planeve për banim sipas programeve të veçanta kërkon koordinimin e aktiviteteve të gjithë akterëve në kuadër të komunës, në përputhje me kompetencat e përcaktuara.

Në këtë drejtim është i nevojshëm **formimi i Sektorit për banim si organi përgjegjës**, që në mënyrë aktive të zhvillojë procesin e zbatimit të aktiviteteve sipas këtij Plani. Ndërtimi i njësive të reja të banimit sipas standardeve përmes fondeve nga buxheti komunal, Qeverisë dhe Partneriteti Publik - Privat, që do të siguroj banimin për grupe të caktuara.

Përmirësimi i kualitetit të banimit duke pasur parasysh objektet ekzistuese të banimit kolektiv që në një masë sektori i banimit do të ndikojë në ngritjen e vetëdijes dhe motivimin e pronarëve të njësive të banimit si domosdoshmëri e organizimit dhe menaxhimit.

Bazuar në këtë, zhvillimi i banimit orientohet nga:

- Përkrahja në zgjidhjen e çështjes së banimit me banimit me qira joprofitabile ose ne bonus të banimit për banesat e tregut me qira të ulët;
- Stimulim i ofertës dhe kërkesës;

- Mbështetje për grupet e rrezikuara për zgjidhjen e problemit të banimit;
- Rritja e ofertës së banesave joprofitabile, zvogëlimin- kufizimin e profitit nga ndërtimet, por jo të rrezikohet interesi i investitorëve që të zhvillojnë aktivitetet ndërtimore të banimit.
- Mirëmbajtja dhe menaxhimi i fondit banesor.

35. BURIMI I TË DHËNAVE

- Udhëzuesi për Hartimin e Programeve komunale Trevjeçare të Banimit, i MMPH
- Raportet e Agjensionit të Statistikave të Kosovës
- Raporti i Zhvillimit Njerëzor Kosova-2016
- Raporti i Zhvillimit Njerëzor në Kosovë -2016
- Plani Zhvillimor Komunal dhe Harta Zonale
- Statuti i Komunës

01.Nr.VI-5

Deçan, dt. 03.04.2023

Kryesuesi i Kuvendit:

Hajdar Sutaj



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E DEÇANIT
MUNICIPALITY OF DEÇAN
OPSTINA DEÇAN



Komisioni Komunal për Vlerësimin e Dëmeve

02 Nr. _____ /2023

Dt.29./ 12 /2023

Për/To/Za :	Asamblenë Komunale
CC :	
Përmes/Through/Preko :	Kryetari i Komunës së Deçanit z.Bashkim Ramosaj
Nga/From/Od :	Kryesues i Komisionit Komunal për Vlerësimin e Dëmeve z.Bajram Çeku
Tema/Subject/Subjekat	Raport i vlerësimit të dëmeve për vitin 2023

Të nderuar,

Komuna e Deçanit me vendimin e dt. 26.09.2023 me nr. Prot. 33338 ka formuar Komisionin mbi Vlerësimin e Dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësi të tjera në territorin e Komunës së Deçanit.

Komisioni i formuar ka dalë në teren dhe ka bërë vlerësimet e dëmeve sipas kriterëve të përcaktuara nga ana e komisionit, pas vlerësimit të gjendjes i njëjti komision ka përpiluar raportin e vlerësimit i cili përmban të dhëna dhe dëshmi për dëmet në bujqësi, dëme në ekonomi familjare etj. si pasojë e fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive të tjera (erërat e fuqishme, kafshët e egra etj).

Numri i kërkesave të paraqitura dhe të aprovuara nga komisioni janë gjithsej 29.

Kërkesat për vlerësimin e dëmeve në komision përfshinë periudhën e vitit 2023.



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E DEÇANIT
MUNICIPALITY OF DEÇAN
OPSTINA DEÇAN



Duke u bazuar në nenin 56 të Statutit të Komunës së Deçanit 01.Nr.IX-5, dt.31.10.2019, Kryetari i Komunës së Deçanit me dt.26.09.2023, bie këtë:

V E N D I M

PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR VLERËSIMIN E DËMEVE TË SHKAKTUARA NGA TË GJITHA FATKEQËSITË NATYRORE NË KOMUNËN E DEÇANIT

I.

Formohet Komisioni për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga të gjitha fatkeqësitë natyrore, në teritorin e Komunës së Deçanit, në këtë përbërje:

1. Bajram Çeku (nga drejtorja BPZHR), kryesues i komisionit,
2. Bajram Dervishaj (nga drejtorja BPZHR), anëtar i komisionit,
3. Gentiana Mazrrekaj (nga drejtorja SHP), anëtare e komisionit,
4. Shaban Haxhaj (nga drejtorja SHP), anëtar i komisionit,
5. Mujë Kadrijaj (nga drejtorja Inspekcioni), anëtar i komisionit,
6. Xheladin Malaj (nga drejtorja Urbanizmit), anëtar i komisionit.

II.

Detyrë e komisionit është që të bënë vlerësimin e të gjitha dëmeve që shkaktohen nga të gjitha fatkeqësitë natyrore në tërë teritorin e Komunës së Deçanit, në çdo kohë gjatë tërë vitit. Komisioni paraprakisht duhet të viziton të gjitha pronat e pronarëve të cilët i janë drejtuar Komunës me kërkesë për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga të gjitha fatkeqësitë natyrore. Komisioni pas grumbullimit të të dhënave duhet të bëjë vlerësimin e dëmeve të konstatuara për çdo rast veç e veç.

III.

Komisioni ka për obligim që pas vlerësimit të dëmeve për çdo rast veç e veç të përgaditë raportin përfundimtarë me shkrim dhe tia dorëzon Kryetarit të Komunës, poashtu obligohet që me raport ta njofton edhe Drejtorin e Drejtorisë për BPZHR.


IV

Komisioni formohet me mandatë të Kryetarit të Komunës. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

Me Vendim njoftohen:

Të emruarit në pikën I.dhe
Arhivi.

02.Nr. _____
Deçan, dt.26.09.2023



Kryetari i Komunës:
Bashkim Ramosaj



Dëmet e shkaktuara në kultura bujqësore, ekonomi familjare etj nga era
si dhe dëmet nga kafshët e egra (ariu)

Dëmi i shkaktuar në :	Numri i kërkesave	Vlera totale
Misër	6	10499.79 €
Serra	6	5830.95 €
Bletë / koshere	8	4180.00 €
Arra	3	3600.00€
Ekonomi familjare	6	6611.00 €
Gjithsejtë		30721.74 €



Kuvendi i Komunës së Deçanit,

Në mbështetje të nenit 11, 12.2 (c), dhe nenit 17 (f) të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare, nr. 28, 4 qershor 2008), nenit 15.7, nenit 34 (paragrafi 2 dhe paragrafi 7) dhe nenit 80 të Ligjit nr. 04/L-060 për mbeturina (Gazeta Zyrtare, nr.17, 29 qershor 2012) i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 08/L-071 (Gazeta Zyrtare, nr. 29, 1 shtator 2022), si dhe nenit 25 pika 1 të Statutit të Komunës së Deçanit, të datës 07.11.2019, në mbledhjen e mbajtur më __.__.2023, miraton këtë:

DRAFT-RREGULLORE PËR MENAXHIMIN E MBETURINAVE NË KOMUNËN E DEÇANIT

KAPITULLI I – DISPOZITA TË PËRGJTHSHME

Neni 1 Qëllimi

Me këtë rregullore përcaktohen rregullat dhe procedurat për organizimin dhe funksionimin e sistemit dhe standardet e shërbimit për menaxhimin e mbeturinave, hartimin e planit komunal për menaxhimin e mbeturinave, krijimin e kushteve për zbatimin e tij si dhe detyrat dhe përgjegjësitë e organit kompetent komunal për kryerjen e shërbimeve për menaxhimin e mbeturinave, në territorin e Komunës së Deçanit, në mënyrë që të mbrohet shëndeti publik dhe të zvogëlohet ndikimi i mbeturinave në mjedis.

Neni 2 Fushëveprimi

1. Kjo Rregullore zbatohet:
 - 1.1. në territorin e Komunës së Deçanit, për aktivitetet e menaxhimit të mbeturinave, dhe
 - 1.2. ndaj të gjithë personave fizik dhe juridik, prodhuesve dhe zotëruesve të mbeturinave dhe operatorëve që merren me menaxhimin e mbeturinave në/dhe për territorin e Komunës së Deçanit.
2. Dispozitat e kësaj rregulloreje nuk zbatohen për kategoritë e mbeturinave të përjashtuara sipas Ligjit për mbeturina dhe ligjeve dhe akteve të veçanta.

Neni 3 Përkufizimet

1. Shprehjet e përdorura në këtë Rregullore kanë këtë kuptim:
 - 1.1. **Administrata komunale** - të gjithë personat e punësuar nga autoriteti komunal siç përkufizohet në Ligjin nr. 03/L-040 për vetëqeverisjen lokale (Gazeta Zyrtare, nr. 28, 04 qershor 2008);
 - 1.2. **Deponi** - vendi i caktuar dhe rregulluar për mbeturina, ku do të vendosen mbeturinat nën apo mbi sipërfaqe të tokës;
 - 1.3. **Gazeta Zyrtare** – Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës;
 - 1.4. **Impiant** - objekti me pajisje të dedikuara për kryerjen e procesit të caktuar;
 - 1.5. **Komunë** - Komuna e Deçanit, njësi e vetëqeverisjes lokale, në territorin dhe me kufijtë administrativë të përcaktuar sipas Ligjit nr. 03/L-041 për kufijtë administrativ të komunave (Gazeta Zyrtare, nr. 26, 2 qershor 2008);
 - 1.6. **Konsumator** - personi i cili ka lidhur kontratë për shërbime me ofruesin e shërbimeve ose merr shërbime të caktuara sipas Ligjit për mbeturina dhe kësaj rregulloreje;
 - 1.7. **Kompostim** - është procesi i dekompozimit të kontrolluar të mbeturinave organike me qëllim të prodhimit të kompostit;
 - 1.8. **Kryetar** - Kryetari i Komunës së Deçanit;
 - 1.9. **Kuvend** - Kuvendi i Komunës së Deçanit;
 - 1.10. **Ligj/Ligji për mbeturina** - Ligji nr. 04/L-060 për mbeturina (Gazeta Zyrtare, nr.17, 29 qershor 2012) i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 08/L-071 (Gazeta Zyrtare, nr. 29, 1 shtator 2022);
 - 1.11. **Ligji për Vetëqeverisjen Lokale** - Ligji nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare, nr. 28, 4 qershor 2008);
 - 1.12. **Ligji për bashkëpunim ndërkomunal** - Ligji nr. 04/L-010 për bashkëpunim ndërkomunal (Gazeta Zyrtare, nr. 7, 10 gusht 2011);
 - 1.13. **Leje përkatëse mjedisore** - nënkupton Leje mjedisore ose Leje mjedisore të integruar ose Leje mjedisore komunale, të përkufizuara sipas ligjit përkatës për mbrojtjen e mjedisit dhe Ligjit përkatës për Parandalimin dhe Kontrollin e Integruar të Ndotjes;
 - 1.14. **Magazinim** - ruajtja e sigurt dhe e përkohshme e mbeturinave në objektet e parapara për këtë qëllim.
 - 1.15. **Mbeturina** - substancë apo objekt që prodhuesi apo zotëruesi e hedh, ka për qëllim ta hedh apo është i detyruar ta hedh;
 - 1.16. **Menaxhimi i mbeturinave** - nënkupton aktivitetet përfshirë mbledhjen, grumbullimin, transportin, përpunimin-rikuperimin, klasifikimin, deponimin e mbeturinave, mbikëqyrjen e operacioneve të tilla dhe kujdesin, mirëmbajtjen e mëvonshme të vendeve të depozitimit, si dhe veprimet e ndërmarra nga një tregtar ose ndërmjetësues;
 - 1.17. **Mbeturina të rrezikshme** - nënkupton mbeturina që paraqesin një apo më shumë veti të rrezikshme të listuara në Shtojcën 1 të Ligjit për mbeturina;

- 1.18. **Mbeturina e parrezikshme** - mbeturinat që nuk paraqesin rrezik për mjedisin dhe shëndetin e njeriut dhe që nuk posedojnë karakteristika të mbeturinave të rrezikshme;
- 1.19. **Mbeturina të veçanta** - mbeturinat të cilat për nga natyra e krijimit dhe trajtimit konsiderohen të veçanta sipas nenit 38.4, të Ligjit për mbeturina;
- 1.20. **Mbeturina inerte** - mbeturinat të cilat nuk pësojnë ndonjë ndryshim të rëndësishëm fizik, kimik dhe biologjik në vendet ku janë deponuar si:
 - 1.20.1. mbeturina inerte që nuk treten, nuk ndizen ose nuk reagojnë fizikisht apo kimikisht, nuk zbërthehen biologjikisht në kontakt me materiet tjera dhe nuk ndikojnë në mënyrë të ndjeshme në mjedisin dhe shëndetin e njeriut;
 - 1.20.2. i tërë kullimi dhe përmbajtja ndotëse e mbeturinës, mbetjet ekotoksike duhet të jenë të vlerës së papërfillshme dhe të mos rrezikojnë cilësinë e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore;
- 1.21. **Mbeturinat komunale** - nënkupton:
 - 1.21.1. mbeturinat e përziera dhe mbeturinat shtëpiake të grumbulluara veç e veç, duke përfshirë letrën dhe kartuçin, qelqin, metalet, plastikën, mbetjet bio, drunjtë, tekstilet, paketimin, pajisjet e mbeturinave elektrike dhe elektronike, bateritë dhe akumulatorët e mbeturinave, mbeturinat vëllimore, përfshirë dyshekët dhe mobilet;
 - 1.21.2. mbeturinat e përziera dhe mbeturinat e grumbulluara veçmas nga burimet e tjera, kur mbeturinat e tilla janë të ngjashme në natyrë dhe përbërje me mbeturinat shtëpiake;
 - 1.21.3. mbeturinat komunale nuk përfshijnë mbeturinat nga prodhimi, bujqësia, pylltaria, peshkimi, tankerët septike dhe rrjetet e kanalizimeve, si dhe nga trajtimi i ujërave të zeza, duke përfshirë llumrat e ujërave të zeza, mbeturinat e automjeteve ose mbeturinat e ndërtimit.
- 1.22. **Mbeturina komerciale** - nënkupton mbeturinat të cilat vijnë nga objektet që përdoren për qëllimet e tregut ose biznesit, sportit, edukimit, rekreacionit, por nuk përfshihen mbeturinat industriale dhe që nënkuptohet çdo mbeturinë e prodhuar nga një biznes duke përfshirë por jo kufizuar, në letër, karton, kanaçe, paketim me pakicë dhe mbështjellës ushqimi;
- 1.23. **Mbeturina ushqimore** - nënkupton mbeturinat e çdo substance apo produkti, qoftë i përpunuar, i përpunuar pjesërisht ose i papërpunuar, e që pritet të konsumohet nga njerëzit, pijet, çamçakëzët dhe çdo substancë, përfshirë edhe ujin, të përfshirë qëllimisht në ushqim gjatë prodhimit, përgatitjes ose trajtimit të tij.
- 1.24. **Mbeturinat nga ndërtimi dhe rrënimi** - nënkupton mbeturinat e krijuara nga aktivitetet e ndërtimit dhe prishjes;
- 1.25. **Mbeturina të vëllimshme** - nënkupton mbeturinat me përmasa të mëdha fizike nga pajisjet dhe makineritë, mobilet, dhe mbeturina tjera të vëllimshme, përmasat e të cilave e pengojnë përdorimin e zakonshëm të grumbullimit, transportimit dhe largimit dhe kërkohet që kjo të bëhet në mënyrë të veçantë;

- 1.26. **Mbledhja** - mbledhje dhe transportim i mbeturinave duke përfshirë klasifikimin paraprak në lloje dhe magazinimin e mbeturinave për qëllime të bartjes deri në objekti për trajtim ose deponim të mbeturinave;
 - 1.27. **Mbledhja e ndarë** - nënkupton mbledhjen, kur grumbullimi i mbeturinave bëhet në mënyrë të ndarë në lloje, të klasifikuar sipas natyrës dhe pajisjeve për të lehtësuar trajtimin specifik;
 - 1.28. **Ministria** - Ministria përkatëse për mjedisin;
 - 1.29. **Operatori** - nënkupton personin e pajisur me leje përkatëse mjedisore i cili në përputhje me dispozitat e Ligjit për mbeturina, Ligjit për prokurimin publik dhe legjislacionin përkatës në fuqi është përzgjedhur nga organi kontraktues i Komunës për ofrimin e shërbimeve publike për menaxhimin e mbeturinave, brenda territorit të Komunës së Deçanit;
 - 1.30. **Organe komunale** - nënkupton Kuvendin dhe Kryetarin e Komunës së Deçanit;
 - 1.31. **Person** - person fizik ose juridik i cili është i involvuar në mënyrë të drejtpërdrejt ose tërthorazi, në proceset për menaxhimin e mbeturinave;
 - 1.32. **Prodhuesi i mbeturinës** - çdo person, veprimtaria e të cilit krijon/prodhon mbeturinë ose çdonjëri që merret me para-procesim, përzierje apo operime tjera që rezultojnë në ndryshimin e natyrës apo përbërjen e mbeturinës;
 - 1.33. **PKMM** - Plani komunal për menaxhimin e mbeturinave;
 - 1.34. **Qeveria** - Qeveria e Republikës së Kosovës;
 - 1.35. **Riciklimi** - çdo operim të përpunimit nga i cili materialet mbeturinë janë rikthyer në produkte, materiale, substanca qoftë si origjinale apo për qëllime tjera. Kjo përfshinë rikthimin e materialeve organike por nuk përfshinë përfitimin e energjisë dhe ripërpunimin në materiale që përdoren si karburante apo për operimet e mbulimit të mbeturinave;
 - 1.36. **Statut** - Statuti i Komunës së Deçanit, i datës 07.11.2019
 - 1.37. **SMM** - Sektori/Njësia/Zyrtari përkatës për Menaxhimin e Mbeturinave, që vepron në kuadër të Drejtorisë për Mbrojtje, Shpëtim dhe Shërbime Publike, i cili zbaton politikën në fushën e mbrojtjes përcaktuar nga ministritë përkatëse dhe legjislacioni përkatës në fuqi për krijimin e një sistemi të qëndrueshëm për menaxhimin e mbeturinave komunale;
 - 1.38. **Trajtimi i mbeturinave** - nënkupton të gjitha operacionet e përpunimit ose magazinimit, deponimit, përfshirë përgatitjet para përpunimit ose magazinimit, deponimit të mbeturinave;
 - 1.39. **Zotëruesi i mbeturinës** - prodhuesi i mbeturinës apo personi që e posedon mbeturinën;
2. Termat tjerë të përdorura në këtë rregullore kanë kuptimin e njëjtë me përkufizimet e dhëna në Ligjin për mbeturina, Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale, dhe Statutin.

KAPITULLI II SISTEMI PËR MENAXHIMIN E MBETURINAVE

Neni 4 Parimet për menaxhimin e mbeturinave

1. Mbeturinat në Komunën e Deçanit , mbliohen, grumbullohen, trajtohen dhe menaxhohen në përputhje me dispozitat e Ligjit për mbeturina, këtë rregullore, PKMM si dhe dispozitat e legjislacionit në fuqi.
2. Menaxhimi i mbeturinave në territorin e Komunës së Deçanit bëhet duke u bazuar në respektimin e parimeve dhe sipas kuptimeve të përcaktuara në Nenin 5 të Ligjit për mbeturina, si në vijim:
 - 2.1. Parimi i afërsisë dhe vetë trajtimit;
 - 2.2. Parimi i vigjilencës dhe parandalimit;
 - 2.3. Parimi ku ndotësi paguan;
 - 2.4. Parimi për menaxhimin e mbeturinave i sistemuar sipas prioriteteve;
 - 2.5. Parimi i përgjegjësisë së prodhuesit dhe zotëruesit;
 - 2.6. Parimi i sigurimit financiar;
 - 2.7. Parimi për qasje të publikut në informata;
 - 2.8. Parimi i mbrojtjes së të drejtave në gjykatë.

Neni 5 Organizimi i menaxhimit të mbeturinave

1. Menaxhimi i mbeturinave në Komunën e Deçanit, duhet të organizohet në atë mënyrë që të:
 - 1.1. mbulohet i tërë territorit i Komunës me shërbimin e grumbullimit të mbeturinave dhe arritjen e shkallës 100% të grumbullimit dhe transportimit;
 - 1.2. bëhet rritja e cilësisë, efikasitetit dhe qëndrueshmërisë dhe ngritja e kapaciteteve institucionale të menaxhimit të mbeturinave;
 - 1.3. bëhet i kapaciteteve institucionale për menaxhimin e mbeturinave;
 - 1.4. rishikimi i procesit tarifar për të siguruar mekanizëm të qëndrueshëm të financimit;
 - 1.5. përmirësim i performancës operative dhe financiare të ofruesve të shërbimit;
 - 1.6. parandalimi dhe eliminimi i deponive ilegale të mbeturinave.
 - 1.7. parandalohet ndotja nga mbeturinat dhe t'i kufizohet ndikimi kur ajo ndodh në mënyrë që të mënjanohet çdo dëm a rrezik për mjedisin dhe për shëndetin, mirëqenien dhe sigurinë e jetës së njeriut;
 - 1.8. ruhet fauna dhe flora, mjedisi e peizazhi nga degradimi, dhe sidomos të ruhen burimet natyrore nga ndikimet e mbeturinave;
 - 1.9. sigurohen shërbime të rregullta dhe të besueshme drejt mbledhjes së mbeturinave dhe trajtimit të tyre të ndarë, në të gjitha fazat e administrimit të tyre dhe të mos përzihen me mbeturinat e rrezikshme;
 - 1.10. përmirësohet qasja në shërbimet e menaxhimit të mbeturinave nga popullata në zonat urbane dhe rurale në përputhje me politikat qeveritare dhe PKMM;

- 1.11. zbatojnë shërbimet bazë të menaxhimit të mbeturinave drejt qëndrueshmërisë dhe mbeturinat t'i nënshtrohen sa më shumë reduktimit, riciklimit dhe ripërdorimit;
- 1.12. zhvillohet potenciali ekonomik i ekonomisë qarkore, me përfshirjen e grupeve të cenueshme;
- 1.13. parandalojnë dhe reduktojnë prodhimin e mbeturinave me qëllim të parandalimit të ndotjes së mjedisit dhe mbrojtjes së shëndetit të njeriut, nga prodhuesit dhe zotëruesit e mbeturinave;
- 1.14. rritet ekspertiza specifike sektoriale në komunë dhe trajtimi i mbeturinave tu përmbahet standardeve profesionale dhe të bëhet në pajtim me dispozitat e ligjit për mbeturina, këtë rregullore dhe legjislacionin përkatës në fuqi.
- 1.15. përdoren vetëm teknikat dhe metodat më të mira të mundshme të bazuara në kriteret mjedisore për ndarjen, grumbullimin, transportimin, ruajtjen, përpunimin dhe asgjësimin e mbeturinave;
- 1.16. realizohet një cikël sa më i shkurtër për administrimin e mbeturinave me qëllim që të zvogëlohet koha e ekspozimit të tyre në mjedis;
- 1.17. dëmshpërblehet dhe të rehabilitohet nga personat fizike dhe juridik, ndotja dhe dëmtimi që shkaktohet prej tyre nga keqadministrimi i mbeturinave.

Neni 6 Reduktimi, Ripërdorimi dhe riciklimi i mbeturinave

1. Menaxhimi i mbeturinave në Komunën e Deçanit, duhet të organizohet në atë mënyrë që mbeturinat të:
 - 1.1. **Reduktohen** - prodhuesit dhe zotëruesit e mbeturinave të parandalojnë dhe reduktojnë prodhimin e mbeturinave, me qëllim të parandalimit të ndotjes së mjedisit dhe mbrojtjes së shëndetit të njeriut;
 - 1.2. **Ripërdoren** - mbeturinat, kur ka mundësi, të ripërdoren apo përpunohen si lëndë e parë sekondare dhe si lëndë për përfitimin e energjisë;
 - 1.3. **Riciklohen** - mbeturinat, kur është e mundur të riciklohen me qëllim që të përdoren si lëndë e parë sekondare.

Neni 7 Trajtimi i barabartë

Operatori duhet të trajton në mënyrë të barabartë të gjithë konsumatorët, prodhuesit dhe zotëruesit e mbeturinave dhe nuk mund të diskriminojë asnjë person në cilëndo prej bazave të përcaktuara në Ligjin për mbrojtje nga diskriminimi.

KAPITULLI III PLANI KOMUNAL PËR MENAXHIMIN E MBETURINAVE

Neni 8 Dokumentet për planifikimin dhe menaxhimin e mbeturinave

1. Dokumentet për planifikimin dhe menaxhimin e mbeturinave, siç përcaktohet në Ligjin për mbeturina, janë:
 - 1.1. Strategjia e Republikës së Kosovës për menaxhimin e mbeturinave (Strategjia), e cila propozohet nga ministria dhe miratohet nga Qeveria, për periudhën kohore dhjetë (10) vjeçare, dhe rishqyrtohet së paku në pesë (5) vjet;
 - 1.2. Plani i Republikës së Kosovës për menaxhimin e mbeturinave, i cili nxirret nga ministria për periudhën kohore prej pesë (5) vitesh dhe i cili rishqyrtohet sipas nevojë;
 - 1.3. Plani komunal për menaxhimin e mbeturinave (PKMM), i cili nxirret nga komuna në pajtim me nenin 9 të kësaj rregulloreje;
 - 1.4. Plani për menaxhimin e mbeturinave nga zotëruesi i mbeturinave i cili nxirret nga pronari i pajisjes për periudhën pesë (5) vjeçare;
 - 1.5. Plani për menaxhimin e mbeturinave nga operatori për menaxhimin e mbeturinave, i cili nxirret nga operatorët për periudhën pesë (5) vjeçare.

Neni 9 Plani komunal për menaxhimin e mbeturinave

1. PKMM nxirret nga Komuna, dhe duhet të:
 - 1.1. jetë i harmonizuar me Planin e Republikës së Kosovës për menaxhimin e mbeturinave;
 - 1.2. nxirret për periudhën kohore prej pesë (5) vitesh dhe i cili rishqyrtohet sipas nevojë;
 - 1.3. hartohet në bashkëpunim me operatorët dhe në një proces publik dhe gjithëpërfshirës me pjesëmarrje të qytetarëve, institucioneve dhe organizatave të ndryshme joqeveritare;
 - 1.4. miratohet nga Kuvendi.
2. Përmbajtja e PKMM, duhet të jetë në pajtim me paragrafin 6 të Nenit 10 të Ligjit për mbeturina.
3. Sipas nevojës dhe në marrëveshje, Komuna e Deçanit së bashku me një a më shumë komuna mund të nxjerrin planin e përbashkët lokal për menaxhimin e mbeturinave.
4. Përgjegjës për zbatimin e PKMM janë organet komunale të përcaktuara në këtë rregullore dhe në PKMM.

Neni 10

PKMM dhe masat për parandalimin, reduktimin, dhe riciklimin e krijimit të mbeturinave

1. Në PKMM duhet të integrohen procedurat dhe programet, në të cilat përcaktohen masat për parandalimin dhe reduktimin e krijimit të mbeturinave, për të ndikuar që gradualisht të ndryshohen shprehitë e konsumatorëve për prodhim të mbeturinave.
2. Masat, sipas paragrafit 1 të këtij neni, përfshijnë por nuk kufizohen në veprimet si në vijim:
 - 2.1. rritja e ndërgjegjësimit të konsumatorëve për çështjet e parandalimit dhe reduktimit të prodhimit të mbeturinave;
 - 2.2. përgatitja e ambientit për futjen graduale të tarifave volumetrike për të dekurajuar prodhimin e mbeturinave;
 - 2.3. promovimi dhe fasilitimi i skemës së kompostimit individual;
 - 2.4. promovimi përmes politikave të favorshme të hapjes së stacioneve rimbushëse dhe dyqaneve “zero mbeturina”;
 - 2.5. përgatitja e ambientit, dhe në koordinim me Qeverinë, për largimi nga tregu i artikujve një përdorimesh të tillë si qeset plastike dhe paketimeve një përdorimesh;
 - 2.6. promovimi dhe fasilitimi i restoranteve dhe objekteve gastronomike “zero mbeturina” për të reduktuar mbeturinat;
 - 2.7. futja e stimuljeve të përshtatshëm fiskal, tarifave preferenciale, kontraktimi dhe prokurimi publik preferencial nga këto subjektet me “zero mbeturina”.
3. Në PKMM duhet të integrohen procedurat dhe programet, në të cilat përcaktohen masat për ripërdorimin dhe riciklimin e mbeturinave komunale por edhe kategorive tjera të mbeturinave, me theks të veçantë në mbeturinat nga ndërtimi dhe rrënimi, mbeturinat e vëllimshme, mbeturinat e veçanta.
4. Masat, sipas paragrafit 1 të këtij neni, përfshijnë por nuk kufizohen në veprimet si në vijim:
 - 4.1.aktivitetet vetëdijësuese për ripërdorim dhe riciklim të mbeturinave;
 - 4.2.përgatitjet për sigurimin e infrastrukturës për ndarjen e mbeturinave në burim dhe për hapjen e qendrës së grumbullimit dhe ripërdorimit të produkteve të hedhura;
 - 4.3.analizat e kompozicionit të mbeturinave dhe potencialit të mbeturinave që mund të riciklohen, dhe shikimi i mundësisë për hapjen e qendrës lokale/rajonale të kompostimit dhe për hapjen e qendrës për rikuperimin e mbeturinave nga ndërtim dhe rrënimi;
 - 4.4.përgatitja e ambientit për zbatimin e skemave të përgjegjësisë së zgjeruar të prodhuesit dhe zotëruesit të mbeturinave.

Neni 11 PKMM dhe fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera

Në PKMM duhet të integrohen procedurat dhe përcaktohen masat për menaxhimin e mbeturinave gjatë Gjendjes së Jashtëzakonshme siç përcaktohet në Kushtetutë, si dhe për masat për zbatimin e mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës gjatë fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera, siç përcaktohet në Ligjin Nr. 04/-L-027 për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera (Gazeta Zyrtare, nr. 22, 19 tetor 2011).

KAPITULLI IV - DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË PËR MENAXHIMIN E MBETURINAVE

Neni 12 Sektori për Menaxhimin e Mbeturinave

1. Sektori/Njësia/Zyrtari përkatëse për Menaxhimin e Mbeturinave (SMM), vepron në kuadër të Drejtorisë për Mbrojtje, Shpëtim dhe Shërbime Publike, Sektori për Shërbime Publike.¹
2. SMM bashkëpunon me ministrin dhe me palët e interesuara për hartimin e dokumenteve për planifikimin dhe menaxhimin e mbeturinave si dhe zbaton politikat në fushën e mbrojtjes, të përcaktuara nga ministritë përkatëse dhe legjislacioni përkatës në fuqi, për krijimin e një sistemi të qëndrueshëm për menaxhimin e mbeturinave komunale.
3. SMM bashkëpunon me policinë, prokurorinë, gjykatat, dhe institucionet tjera në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 13 Detyrat dhe përgjegjësitë e Sektorit për menaxhimin e mbeturinave

1. SMM, ka detyrat dhe përgjegjësitë si në vijim:
 - 1.1. planifikon, rregullon, udhëheqë dhe të zbaton aktivitete për menaxhimin e mbeturinave brenda territorit të komunës së Deçanit;
 - 1.2. harton, siguron dhe raporton zbatimin e PKMM, në pajtim me këtë rregullore dhe legjislacionin përkatës në fuqi;
 - 1.3. udhëzon dhe mbikëqyrë ofruesit e shërbimeve për menaxhimin e mbeturinave komunale;
 - 1.4. planifikon buxhetin për funksionimin e duhur të menaxhimit të mbeturinave;
 - 1.5. propozon tarifën për menaxhimin e mbeturinave dhe mënyrën e arkëtimit të mjeteve financiare;
 - 1.6. siguron faturimin e taksës për mbeturina, dhe për organizimin dhe shpërndarjen e faturave;
 - 1.7. siguron kushtet e veprimit dhe operimit për operatorët publikë dhe privatë;
 - 1.8. organizon menaxhimin e mbeturinave nga sipërfaqet publike;
 - 1.9. mbikëqyrë mbledhjen, transportimin deri në deponi të mbeturinave komunale, komerciale, inerte, të vëllimshme, nga ndërtimet dhe rrënimet, ushqimore, si dhe llojeve tjera të mbeturinave të cilat janë në kompetencë të nivelit lokal;
 - 1.10. njofton publikun për menaxhimin e mbeturinave dhe promovon ngritjen e vetëdijesimit publik - pjesëmarrjen aktive të qytetarëve në menaxhimin e mbeturinave, në bashkëpunim me njësitë përkatëse në komunë;

¹ Varësishtë nga komuna ceket emërtimi i sektorit dhe i drejtorisë. Jo domosdo secila komunë duhet të krijojë sektor. E rëndësishmë është që një njësi përkatëse apo një zyrtar duhet të ketë përgjegjësitë e përcaktuara në këtë rregullore dhe në këtë nen. Gjithashtu, komunat nuk janë të detyruara të krijojnë sektor apo njësi për menaxhimin e mbeturinave brenda drejtorisë. Këtë përgjegjësi disa komuna mund t'ia lënë në dorë drejtorisë përkatëse dhe në këtë nen dhe rregullore e zëvendësojnë fjalën Sektor me Drejtori në tërë Rregulloren.

- 1.11. promovon minimizimin e mbeturinave (ripërdorim, reduktim, riciklim (3R), kompostimin shtëpiak etj.);
- 1.12. identifikon pikat/deponitë ilegale të hedhjes së mbeturinave dhe siguron evitimin e tyre;
- 1.13. në bashkëpunim me njësitë tjera komunale siguron kushte veprimi dhe operimi për operatorin;
- 1.14. harton raportet për menaxhimin e mbeturinave, përfshi raporte vjetore për menaxhimin e mbeturinave raportet për shkallën e arkëtimit të tarifës për mbeturina, sipas kërkesave që dërgohet në Ministri si dhe raporteve tjera të përcaktuar në Ligjin për mbeturina dhe këtë rregullore;
- 1.15. bënë monitorimin mjedisor të deponisë së mbeturinave (*NË RASTET KUR KA NJË TË TILLË NË TERRITORIN E KOMUNËS*);
- 1.16. në emër të komunës përgatit dhe dërgon informacionet dhe rekomandimet e kërkuara nga Ministria, lidhur me menaxhimin e mbeturinave.
2. SMM, sipas nevojës dhe në bashkëpunim me dhe përmes operatorit të kontraktuar për menaxhimin e mbeturinave komunale, përcakton:
 - 2.1. vendndodhjen e pikave të grumbullimit të mbeturinave;
 - 2.2. llojin, numrin, mënyrën e shpërndarjes dhe vendosjes së kontejnerëve për;
 - 2.3. lokacionin për vendosjen e kontejnerëve dhe mënyrën e mirëmbajtjes së tyre;
 - 2.4. kushtet për mënyrën e mbledhjes, ndarjes, përpunimit dhe riciklimit, të mbeturinave;
 - 2.5. orarin dhe dinamikën për mbledhjen e mbeturinave, dhe sipas nevojë autorizon operatorin që të bëjë mbledhjen e mbeturinave edhe jashtë orarit dhe dinamikës së paraparë;
 - 2.6. mënyrat për transportim të mbeturinave komunale;
 - 2.7. siguron, brenda afatit të caktuar, kontejnerë të veçantë për hedhjen e mbeturinave gjatë ndërtim-rrënimit, mbeturinave të vëllimshme dhe të caktojë tarifën e këtij shërbimi në bazë të zbrazjes së kontejnerëve.
3. SMM, përkujdeset që të themelohet komisioni i ankesave në kuadër të administratës komunale, i cili do të shqyrton ankesat e konsumatorëve sa u përket shërbimeve të menaxhimit të mbeturinave, tarifave dhe mënyrës së arkëtimit të tyre.

Neni 14 Të drejtat e prodhuesit apo zotëruesit të mbeturinave

1. Çdo prodhues apo zotërues i mbeturinave dhe çdo konsumator ka të drejtë:
 - 1.1. qasjeje në shërbimet publike për hedhjen dhe grumbullimin e mbeturinave;
 - 1.2. të informohet dhe të kërkojë informata për menaxhimin e mbeturinave;
 - 1.3. të marrë pjesë dhe të kontribuojë në politikat për menaxhimin e mbeturinave; 1.4. të bëjë ankesë, ndaj shërbimit të ofruar dhe të marrë përgjigje në ankesën e bërë.

Neni 15 Detyrat dhe përgjegjësitë e prodhuesit apo zotëruesit të mbeturinave

1. Çdo prodhues apo zotërues i mbeturinave ka detyrat dhe përgjegjësitë si në vijim:
 - 1.1. të regjistrohet në listat e shërbimit të konsumatorëve për mbledhjen dhe bartjen e mbeturinave dhe të përditësojnë të dhënat në rastet e ndryshimit të adresës;
 - 1.2. të bashkëpunojnë me autoritetet publike për të siguruar një mjedis të pastër;
 - 1.3. të bëjnë përpjekje për minimizimin e mbeturinave (përmes ripërdorim, reduktim, riciklim (3R), kompostimit shtëpiak dhe formave tjera të mundshme);
 - 1.4. t'i respektojë rregullat e përcaktuara me legjislacionin përkatës në fuqi dhe PKMM;
 - 1.5. të paguaj për shërbimin e ofruar në bazë të tarifës së miratuar nga Komuna;
 - 1.6. t'i hedhin mbeturinat e tyre në vende dhe sipas sistemit të caktuar nga ana e Komunës për mbledhjen e mbeturinave, ndërsa mbeturinat e rrezikshme t'i ndajnë dhe t'i dorëzojnë në vendet e caktuara për to, në pajtim me legjislacionin në fuqi;
 - 1.7. të bëjnë ndarjen e mbeturinave sipas sistemit të caktuar nga komuna, me qëllim të trajtimit dhe riciklimit të tyre si dhe t'i hedhin ose dorëzojnë mbeturinat e një lloji:
 - 1.7.1. në shporta dhe kontejnerë të përcaktuar për atë lloj;
 - 1.7.2. në pika ose qendra grumbulluese të përcaktuara për atë lloj; ose
 - 1.7.3. te operatori;
 - 1.8. ta njoftojnë SMM kur prodhojnë mbeturina gjatë meremetimit apo rrënimit të objekteve dhe të largojnë këto mbeturina, nga hapësirat ose vendet publike, në pajtim me legjislacionin në fuqi.
2. Prodhuesit apo zotëruesit e mbeturinave të veçanta, mbeturinave të rrezikshme dhe mbeturinave medicinale, janë të detyruar të respektojnë legjislacionin në fuqi për trajtimin e këtyre mbeturinave dhe të përdorin sistemin e ndarjes së kontejnerëve dhe ti dorëzojnë ato mbeturina në vendet e caktuara për to.
3. Prodhuesit apo zotëruesit e mbeturinave, për objektet dhe pajisjet për menaxhimin e mbeturinave, për të cilat sipas Ligjit për mbeturina, është e nevojshme të merret cilado nga lejet mjedisore, janë të detyruar të nxjerrin Planin për menaxhimin e mbeturinave, në pajtim me Neni 11 të Ligjit për mbeturina.

KAPITULLI V AKTIVITETET PËR MENAXHIMIN E MBETURINAVE

Neni 16 Grumbullimi i mbeturinave

1. Grumbullimi i mbeturinave bëhet vetëm në kontejnerë dhe në vendet e mbledhjes së mbeturinave të cilat caktohen nga Komuna.
2. Ndryshimi i vendndodhjes së vendeve të mbledhjes së mbeturinave dhe vendit të kontejnerëve, pa miratim të komunës, përbën shkelje dhe ndëshkohet sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 17 Kontejnerët për mbeturina

1. Me qëllim të mbajtjes sa më të mirë të pastërtisë në sipërfaqe publike, vendoset numër i mjaftueshëm i kontejnerëve për mbeturina.
2. Llojin, mënyrën, vendin dhe numrin e kontejnerëve dhe të mjeteve tjera në sipërfaqe publike, e cakton SMM, në bashkëpunim me operatorin.
3. Numri i kontejnerëve duhet të përshtatet me numrin e banorëve në objektet e përbashkëta të banimit dhe llojin e mbeturinave që krijojnë.
4. Kontejnerët për mbeturina duhet të vendosen në vende të dukshme dhe të përshtatshme.
5. Kontejnerët, nëse paraqitet nevoja, duhet të kenë mbishkrime të dukshme që udhëzojnë për klasifikimin e mbeturinave.
6. Personat juridik dhe fizik të amvisërive që marrin shërbimet derë me derë, sigurojnë kontejnerët sipas llojit dhe mënyrës që caktohet nga SMM.
7. Prodhuesit apo zotëruesit e mbeturinave të veçanta, duhet të përdorin sistemin e ndarë të kontejnerëve me qëllim të ndarjes së mbeturinave medicinale dhe mbeturinave të tjera, që i nënshtrohen një trajtimi të veçantë, në pajtim me legjislacionin në fuqi.
8. Ndërmarrja së cilës i besohen punët e mirëmbajtjes së rregullt të parqeve, sheshe dhe në vende tjera, është e obliguar të vendosë dhe të mirëmbajë numër të mjaftueshëm të kontejnerëve (koshave) për mbeturina.
9. Çerdhet, kopshtet dhe shkollat, publike e private, duhet të përdorin sistemin e disa kontejnerëve për të edukuar fëmijët dhe nxënësit me normat e rregullat bashkëkohore të trajtimit të ndarë të mbeturinave.
10. Për mirëmbajtjen dhe pastrimin e kontejnerëve për mbeturina, në sipërfaqe publike, kujdeset operatori.
11. Personat juridik dhe qytetarët janë përgjegjës për mirëmbajtjen dhe pastrimin e kontejnerëve për mbeturina dhe vendeve përreth tyre.

Neni 18 Orari për mbledhjen dhe hedhjen e mbeturinave

1. Komuna bën publike oraret e hedhjes dhe mbledhjes së mbeturinave.
2. Në procesin e vendimmarrjes për caktimin e orarit të hedhjes dhe mbledhjes së mbeturinave, ftohen të marrin pjesë personat juridik dhe fizik, OJQ-të dhe publiku i interesuar.
3. Secili person ka të drejtë të kërkojë të informohet për ecurinë e procesit të hedhjes dhe largimit të mbeturinave.
4. Sistemimi dhe hedhja e mbeturinave, nga prodhuesit apo zotëruesit e mbeturinave bëhet vetëm në kontejnerë ose në vendet e mbledhjes së mbeturinave dhe sipas orarit që ka caktuar komuna.
5. Kalimtarët, mbeturinat e çastit si ambalazhe të ndryshme, i hedhin vetëm në kontejnerët e vendosur në hapësira publike ose që ndodhen para dyqaneve. Ndalohet hedhja e tyre në rrugë, në trotuare apo në ambiente të tjera publike.

6. Mbeturinat që dalin nga krasitja e pemëve, e hardhive, nga punimet në oborre, në lulishte e parqe, para se të dërgohen në vendet e mbledhjes së këtyre mbeturinave, priten në pjesë të vogla e palosen për të mos bllokuar kazanët dhe vështirësuar transportin.
7. Hedhja e mbeturinave jashtë këtij rregulli, përbën shkelje dhe ndëshkohet sipas legjislacionit në fuqi.
8. Hedhja e mbeturinave të rrezikshme, mbeturinave të veçanta, mbeturinave industriale, mbeturinave inerte, mbeturinave medicinale, mbeturinave nga ndërtimi dhe rrënimi, si dhe mbeturinave të tjera që nuk konsiderohen si mbeturina komunale sipas Ligjit dhe nga kjo rregullore, duhet të bëhet në pikat e veçanta të caktuara nga Komuna për këtë qëllim, dhe në pajtim me legjislacionin përkatës në fuqi.

Neni 19 Transportimi i mbeturinave

1. Transportimi i mbeturinave për në vendet e depozitimit bëhet nga komuna ose operatori.
2. Transportuesit e mbeturinave bëjnë transportimin e mbeturinave në bazë të kushteve të përcaktuara me legjislacionin përkatës në fuqi.
3. Bartja e mbeturinave bëhet gjatë ditës dhe gjatë natës, në orët e mbrëmjes apo herët në mëngjes, sipas orarit dhe dinamikës për mbledhjen e mbeturinave të caktuar nga SMM, i cili bëhet publikë në ueb faqen e komunës.
4. Transportimi i mbeturinave në orët e pikut të aktiviteteve qytetare, është i ndaluar dhe ndëshkohet sipas legjislacionit në fuqi.
5. Gjatë bartjes së mbeturinave mjetet me të cilat ato barten, patjetër duhet të jenë të mbyllura ose të mbuluara, në mënyrë që të pengohet derdhja apo rishpërndarja e mbeturinave gjatë transportit deri në deponinë e caktuar.
6. Nëse ndotja ndodhë gjatë transportimit të mbeturinave, transportuesi është i detyruar që vendin e ndotur ta kthejë në gjendje të mëparshme.
7. Nëse mbeturina e transportuara, nuk pranohet në deponinë e destinuar, transportuesi duhet ta kthejë mbeturinën në vendin ku është marrë dhe të njoftojë SMM.

Neni 20 Deponitë e mbeturinave

Deponimi i mbeturinave në Komunën e Deçanit, në varshmëri të karakteristikave të mbeturinave, bëhet vetëm në deponitë e licencuara dhe të lejuara përkatëse si dhe sipas llojit përkatës të mbeturinave, që mund të jenë deponi për mbeturinat e rrezikshme; deponi për mbeturinat jo të rrezikshme; deponi të mbeturinave inerte, në pajtim me legjislacionin përkatës në fuqi për menaxhimin e deponive.

KAPITULLI VI OPERATORËT PËR MENAXHIMIN E MBETURINAVE

Neni 21 Operatorët për menaxhimin e mbeturinave

1. Menaxhimi i mbeturinave bëhet përmes kontratave të veçanta me një apo më shumë operator publik ose privat për menaxhimin e mbeturinave, të cilët duhet të jenë të pajisur me leje përkatëse mjedisore për menaxhimin e mbeturinave.
2. Operatorët për menaxhimin e mbeturinave mund të jenë institucionet, kompanitë publike ose private të regjistruara sipas ligjit, të cilët shërbimet për komunën për menaxhimin e mbeturinave e kryejnë në bazë të kontratës.
3. Organi kontraktues i Komunës, duke u bazuar në dispozitat e ligjit përkatës të prokurimit, mund të përcaktojnë të gjitha kushtet nevojshme për përzgjedhjen e operatorit për menaxhimin e mbeturinave komunale, dhe mbeturinave: inerte, komerciale, të vëllimshme dhe mbeturinat nga ndërtimet dhe rrënimet, brenda territorit të Komunës së Deçanit.
4. Komuna mund të përzgjedhë për operator një ndërmarrje në pronësi të Komunës sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 22 Menaxhimi i mbeturinave me partneritet publiko-privat

Menaxhimi i mbeturinave, ndërtimi, shfrytëzimi dhe mirëmbajtja e impianteve dhe objekteve për menaxhimin e mbeturinave mund të epet në formën e partneritetit publiko-privat sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Neni 23 Kontrata me operatorin

1. Kontrata me operatorin duhet të specifikoj, së paku:
 - 1.1. territorin ku kryhen shërbimet;
 - 1.2. mënyrën e ofrimit të shërbimeve;
 - 1.3. specifikimin e pajisjeve për trajtim;
 - 1.4. çështjet tjera që kërkohen sipas Ligjit, këtë rregullore dhe legjislacionit përkatës në fuqi.
2. Operatori i kontraktuar nga organi kontraktues, për ofrimin e shërbimeve për menaxhimin e mbeturinave, është i obliguar që të veprojë sipas Ligjit, kontratës, kësaj rregulloreje dhe legjislacionit përkatës në fuqi dhe përmbush të gjitha detyrat dhe përgjegjësitë e operatorit të përcaktuar në Ligj dhe legjislacionin përkatës në fuqi.

KREU VII

KATEGORIZIMI I KONSUMATORËVE DHE TARIFAT PËR SHËRBIMET E MENAXHIMIT TË MBETURINAVE

Neni 24 Kategorizimi i konsumatorëve dhe caktimi i tarifave për menaxhimin e mbeturinave

1. Konsumatorët, gjegjësisht prodhuesit apo zotëruesit të mbeturinave, kategorizohen si në vijim:
 - 1.1. Konsumatorët e amvisërive;
 - 1.2. Konsumatorët komercialë dhe industrialë;
 - 1.3. Konsumatorët institucionalë.
2. Kuvendi cakton nënkategoritë e konsumatorëve dhe tarifat për menaxhimin e mbeturinave.
3. Gjatë caktimit të tarifave duhet marrë parasysh shërbimit për secilën kategori, dhe duke marrë parasysh ndikimin e tarifave në mjedisin jetësor dhe rekomandimin e SMM dhe operatorëve.
4. SMM në bashkëpunim me operatorin krijojnë, mirëmbajnë dhe përditësojnë listën e konsumatorëve, duke përfshirë edhe kategorizimin dhe nënkategorizimin e tyre.

Neni 25 Faturimi i mbeturinave

1. Faturimi mbeturinave bëhet në bazë mujore kurse fatura i dorëzohet konsumatorit, më së largu deri më datën 10 të muajit pasues. Konsumatori obligohet që të paguajë faturën e mbeturinave për çdo muaj të vitit.)
2. Konsumatori obligohet të paguaj faturën e mbeturinave, në katër këste brenda vitit, si më poshtë:
 - 2.1. Kësti i parë janar – mars;
 - 2.2. Kësti i dytë prill – qershor;
 - 2.3. Kësti i tretë korrik- shtator;
 - 2.4. Kësti i katërt tetor – dhjetor.
3. Konsumatorët paguajnë tarifën për menaxhimin e mbeturinave dhe sipas shumës së përcaktuar nga Kuvendi.
4. SMM e rishikon lartësinë e tarifave të paktën çdo tri vjet, duke llogaritur koston e shërbimeve, dhe i rekomandon Kuvendit ndryshimet që i sheh të nevojshme.
5. Konsumatorët mund të parapaguajnë tarifën për gjashtë muaj ose një vit. Nëse konsumatorët paguajnë në këtë mënyrë tarifën kanë zbritjet si në vijim:
 - 5.1. 5% për qind për konsumatorët që parapaguajnë tarifën për gjashtë muaj; dhe
 - 5.2. 10% për qind për konsumatorët që parapaguajnë tarifën për një vit.

KREU VIII INFORMIMI, PROMOVIMI DHE RAPORTI PËR MENAXHIMIN E MBETURINAVE

Neni 26 Seanca/t vjetore për çështjet e menaxhimit të mbeturinave

1. Kuvendi organizon të paktën një (1) seancë vjetore, apo se paku në një seancë e diskuton në rend të ditës çështjet e menaxhimit të mbeturinave.
2. Në seancën/at vjetore ku diskutohet për menaxhimin e mbeturinave, secili drejtor i drejtorisë komunale raporton për çështjet, veprimet dhe masat që janë në përgjegjësinë e tij dhe që kanë të bëjnë dhe që ndërlidhen me menaxhimin e mbeturinave, si dhe paraqesin aktivitetet që janë ndërmarrë për realizimin e PKMM.
3. Në seancën/at vjetore për menaxhimin e mbeturinave, ku diskutohet për menaxhimin e mbeturinave, marrin pjesë edhe përfaqësues të shoqërisë civile.
4. Seanca/at vjetore për menaxhimin e mbeturinave organizohen në koordinim me SMM.

Neni 27 Ditët e Komunës së pastër

1. Nën patronatin e Kryetarit organizohen dhe mbahen "Ditët e Komunës së pastër".
2. Gjatë këtyre ditëve organizohen aktivitete të ndryshme me pjesëmarrjen e subjekteve të ndryshme që merren me mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit të njeriut në territorin e Komunës.
3. Kryetari, me vendim, cakton datat për "Ditët e Komunës së pastër", dhe përcakton përgjegjësitë e mekanizmave përkatëse për detyrat e tyre në këto ditë dhe aktivitetet konkrete që duhet ndërmarrë.
4. Në ditët e Komunës së pastër, Kryetari mund të vendos që të bëhet pa pagesë grumbullimi, transportimi dhe deponimi i mbeturinave të vëllimshme.

Neni 28 Informimi dhe promovimi

1. Komuna e Deçanit është transparente ndaj palëve të interesuara për dhënien e informatave për menaxhimin e mbeturinave.
2. Zyra përkatëse për informim në Komunën e Deçanit, në bashkëveprim me SMM, përmes fushatave, ligjëratave publike si dhe materialeve të ndryshme promovuese për ngritjen e vetëdijes për menaxhimin e mbeturinave dhe mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit të njeriut në territorin e Komunës së Deçanit, krijojnë një sistem të informimit për mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit të njeriut dhe informata të tjera të cilat janë në interes të qytetarëve.
3. Organizatat e shoqërisë civile inkurajohen dhe përkrahen që të monitorojnë, promovojnë dhe informojnë për menaxhimin e mbeturinave.

Neni 29

Ngritja e vetëdijes për rëndësinë dhe dobinë e menaxhimit dhe riciklimit të mbeturinave.

1. Zyra përkatëse për informim në Komunën e Deçanit , në bashkëveprim me SMM, shoqërinë civile dhe konsumatorët promovojnë konceptin e 3R (reduktim, ripërdorim, riciklim) për të synuar që gradualisht në Komunën e Deçanit të fillojë të ndarja e mbeturinave (nga ekonomi familjare, tek shkollat dhe institucionet, dhe biznese), të ngritë vetëdijen e qytetarëve dhe bizneseve rreth përfitimeve për ndarje të mbeturinave dhe të krijojë infrastrukturë për zhvillim ekonomik lokal, pra të krijojë mundësi qytetarëve që të krijojnë biznese financiarisht të qëndrueshme në sektorin e menaxhimit të mbeturinave.
2. Masat për parandalimin dhe reduktimin e gjenerimit të mbeturinave duhet të përfshijnë instrumente ekonomike dhe politike të drejtuara për t'i ndryshuar shprehinë e konsumatorëve për gjenerim të mbeturinave.

Neni 30 Raporti vjetor për menaxhimin e mbeturinave

1. SMM monitoron zbatimin e kësaj rregulloreje dhe harton raporte vjetore për menaxhimin e mbeturinave.
2. Obligohen të gjitha njësitë përkatëse të komunës për bashkëpunimin dhe ofrimin e të dhënave të kërkuara nga SMM.
3. Raporti vjetor për menaxhimin e mbeturinave duhet dorëzuar në Ministri, deri më 31 mars të vitit vijues, siç është përcaktuar në Nenin 58 të Ligjit për mbeturina.
4. Operatorët që merren me menaxhimin e mbeturinave paraqesin Raportin vjetor deri më 31 mars të vitit vijues. Raporti paraqitet në Komunë dhe në Ministri.
5. Raporti nga paragrafët 3. dhe 4. të këtij neni, duhet të përmbajnë të dhënat për:
 - 5.1. llojin, përbërjen, karakteristikat, sasinë, origjinën, ruajtjen, transportin, trajtimin, përpunimin, riciklimin, magazinimin dhe deponimin e mbeturinave si dhe mbeturinave të cilat prahen në objektet dhe pajisjet për menaxhimin e mbeturinave;
 - 5.2. llojin, përbërjen, karakteristikat, sasinë, origjinën, ruajtjen, transportin dhe destinimin e lëndës së parë sekondare të përfituar në objektet për menaxhimin e mbeturinave;
 - 5.3. çështje tjera të rëndësishme.
6. Raporti nga paragrafët 3. dhe 4. të këtij neni plotësohet sipas Shtojcës VI. të Ligjit, dhe në pajtim me aktin nënligjor i cili rregullon kushtet dhe kriteret për raportimin për menaxhimin e mbeturinave.

KAPITULLI IX - BASHKËPUNIMI PËR MENAXHIMIN E MBETURINAVE

Neni 31 Bashkëpunimi për menaxhimin e mbeturinave

Të gjitha njësitë përbërëse të komunës dhe administrata komunale, në kuadër të detyrave dhe përgjegjësi të tyre, janë të obliguara të bashkëpunojnë dhe koordinojnë punën ndërmjet tyre për identifikimin e çështjeve të zbatimit të masave dhe gjetjes së mënyrave me efektive për menaxhimin e mbeturinave si dhe për zbatimin e Ligjit, kësaj rregulloreje, legjislacionit në fuqi dhe PKMM-së.

Neni 32 Bashkëpunimi ndër-komunal

Për ushtrimin më efikas dhe më efektiv të menaxhimit të mbeturinave, Komuna e Deçanit, kur sheh interesin publik të tyre, mund të bëjnë marrëveshje për menaxhimin e mbeturinave me një apo më shumë komuna të Republikës së Kosovës në pajtim me format, kushtet dhe procedurat e përcaktuara me Ligjin për bashkëpunim ndërkomunal, dispozitat e të cilit ligj vlejnë edhe për të gjitha format e bashkëpunimit ndër-komunal për menaxhimin e mbeturinave.

Neni 33 Bashkëpunimi me konsumatorët dhe organizatat e shoqërisë civile

1. Organet dhe administrata komunale:
 - 1.1. bashkëpunojnë me konsumatorët dhe organizatat e shoqërisë civile për realizimin e politikave të menaxhimit të mbeturinave, në pajtim me këtë rregullore dhe legjislacionin përkatës në fuqi;
 - 1.2. sigurojnë, inkurajojnë dhe mbështesin pjesëmarrjen e konsumatorëve dhe organizatave të shoqërisë civile në çështjet e menaxhimit të mbeturinave dhe në aktivitetet planifikuese dhe zbatuese si dhe u ofrojnë këshilla dhe udhëzime organizatave që kërkojnë të ndërmarrin aktivitete të tilla;
 - 1.3. mbajnë komunikime të rregullta me konsumatorët dhe organizatat e shoqërisë civile në mënyrë që të sigurohet një situatë e qartë e menaxhimit të mbeturinave në komunë nga një perspektivë tjetër.

KREU X MBIKËQYRJA INSPEKTIVE DHE KUNDËRVAJTJET

Neni 34 Mbikëqyrja inspektive

1. Komuna ushtron mbikëqyrjen dhe kontrollin e masave dhe veprimeve gjatë menaxhimit të mbeturinave në territorin e vet, përmes inspektorit komunal për mjedis, në kuadër të përgjegjësive sipas dispozitave të nenit 62 deri në nenin 69 të Ligjit dhe dispozitave tjera të legjislacionit përkatës në fuqi.
2. Inspektori komunal për mjedis mbikëqyrë dhe inspekton menaxhimin e mbeturinave në objektet, pajisjet dhe hapësirat që gjenden në territorin e komunës, duke ndërmarr masat për mbrojtjen e mjedisit të përcaktuara sipas dispozitave të Ligjit dhe legjislacionit përkatës në fuqi.
3. Inspektori komunal për mjedis, në kuadër të përgjegjësive është i autorizuar të marrë masa preventive për mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit të njeriut si dhe të shqiptojë gjobë për kundërvajtjet e përcaktuara me Ligj dhe legjislacionin përkatës në fuqi.
4. Punët e inspektorit për mbikëqyrjen inspektive të veprimtarive për menaxhimin e mbeturinave mund t'i kryej edhe zyrtari me kualifikim adekuat të cilin e autorizon komuna në kuadër të përgjegjësive të veta.
5. Në rastet kur Komuna nuk ka inspektor komunal për mjedis, punët, detyrat dhe përgjegjësitë e tij, i kryen zyrtari komunal sipas paragrafit 3 të këtij neni, i cili kryen të gjitha detyrat dhe përgjegjësitë e inspektorit komunal për mjedis.

Neni 35 Inspektimi jashtë territorit të komunës

Inspektori komunal për mjedis, sipas marrëveshjes nga neni 15 paragrafi 2, neni 65 dhe neni 67 të Ligjit, mund të mbikëqyrë dhe inspekton menaxhimin e mbeturinave edhe në objektet, pajisjet dhe hapësirat që gjenden jashtë territorit të komunës dhe njëkohësisht Komuna mund të lidhë marrëveshje që inspektori mjedisor komunal i komunës tjetër të kryejë inspektimin në territorin e Komunës së Deçanit.

Neni 36 Kundërvajtjet

1. Në territorin e Komunës së Deçanit, për mosrespektim të dispozitave të Neneve 71, 73 dhe 74 të Ligjit për mbeturina, dhe sipas gjobave të përcaktuara në këto nene, do të dënohen për kundërvajtje dhe gjobiten me gjoba të përcaktuara në këto nene personat fizik, personat juridik dhe personat përgjegjës të personave juridik.
2. Veprimet e ndaluar dhe gjobat sipas paragrafit 1 të këtij neni janë të përcaktuara në Shtojcën 2 të kësaj Rregulloreje.

Neni 37 Procedurat e ankesës

Kundër vendimit të inspektorit mund të parashtrohet ankesa në pajtim me Ligjin Nr. 05/L -031 për procedurën e përgjithshme administrative (Gazeta Zyrtare, nr. 20, 21 qershor 2016).

Neni 38 Veprat penale

Kur shkeljet e dispozitave të Ligjit për mbeturina përbëjnë vepër penale sipas Kodit Penal, inspektori komunal përmes kryetarit të komunës bënë kallëzimin penal.

Neni 39 Mbeturinat e hedhura nga personi i pa njohur

1. Për tërë mbeturinat e hedhura në hapësira publike ose jashtë deponive të mbeturinave, përgjigjet hedhësi i tyre.
2. Nëse personi përgjegjës për menaxhimin e mbeturinave, në pajtim me përgjegjësitë ligjore, nuk përkujdeset për mbeturinat e hedhura nga personi i pa njohur dhe nuk mund të identifikohet hedhësi, përgjegjësinë për ato mbeturina e bartë Komuna, e cila siguron largimin e tyre.

KAPITULLI XI DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 40

Përgjegjësia individuale

Çdo person fizik dhe juridik mban përgjegjësi në bazë të dispozitave të kësaj rregulloreje dhe të legjislacionit përkatës për çështjet e menaxhimit të mbeturinave, kur me veprimet ose mosveprimet e tij, ka bërë kundërvajtje dhe shkelje të dispozitave të legjislacionit në fuqi.

Neni 41 Procedura përmbarimore dhe gjyqësore

Ndaj konsumatorëve të cilët nuk bëjnë pagesën e tarifës për mbeturina do të iniciohet procedurë procedura përmbarimore dhe gjyqësore nga njësitet përkatëse të komunës, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

Neni 42 Buxhetimi

1. Financimi i menaxhimit të mbeturinave sigurohet nga pagesat e konsumatorëve, buxheti komunal, Buxheti i Republikës së Kosovës, donacionet dhe burimet tjera financiare në pajtim me legjislacionin në fuqi.
2. Për t'i përmbushur të drejtat dhe detyrimet e përcaktuara në këtë rregullore dhe me legjislacionin përkatës që ka të bëjë me menaxhimin e mbeturinave, organet dhe administrata përkatëse komunale, gjatë fazës së hartimit të buxhetit komunal planifikojnë buxhet për aktivitete të ndryshme që kanë të bëjnë me menaxhimin e mbeturinave si dhe sigurojnë burime njerëzore, financiare dhe logjistike të nevojshme.
3. Komuna e planifikon buxhetin komunal, i cili është transparent dhe bazohet në konsultime me palët.
4. Administrata dhe organet komunale zhvillojnë një proces për analizimin e nevojave të buxhetimit për menaxhimin e mbeturinave, bazuar në procesin e vlerësimit dhe raportimit.
5. Kryetari bashkëpunon me Ministrinë dhe me donator të ndryshëm për prioritetet për marrjen e fondeve për menaxhimin e mbeturinave.

Neni 43 Regjistri i deponive ilegale

Spektori përkatës për Menaxhimin e Mbeturinave, në afat prej gjashtë (6) muajve, pas hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje, duhet të përgatisë regjistrin e deponive ilegale në territorin e Komunës së Deçanit, sipas dispozitave të Ligjit për mbeturina.

Neni 44 Ngritja e kapaciteteve për menaxhimin e mbeturinave

Për të siguruar ofrimin e një shërbimi cilësor dhe efektiv për mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit të njeriut, të gjithë punonjësit e komunës, veçanërisht punonjësit që kanë përgjegjësi direkte në fushën e menaxhimit të mbeturinave dhe mbrojtjes së mjedisit dhe shëndetit të njeriut, janë të obliguar të ndjekin trajnime dhe aktivitete që synojnë të zhvillojnë kapacitetet e tyre në këtë fushë si dhe të venë në shfrytëzim, në punën e tyre të përditshme, njohurinë dhe dijen e përfutur.

Neni 45 Zbatimi

1. Zbatimit të kësaj rregulloreje në territorin e Komunës së Deçanit i nënshtrohen:
 - 1.1. SMM si dhe organet dhe administrata komunale;
 - 1.2. Operatorët e angazhuar për menaxhimin e mbeturinave;
 - 1.3. të gjithë personat fizik dhe juridik, kalimtarët e rastit dhe turistët dhe që ushtrojnë veprimtari dhe që ndodhen në territorin e Komunës;
 - 1.4. Subjektet që ushtrojnë veprimtari ekonomike;
2. Zbatimi i kësaj rregulloreje sigurohet nga Kryetari, me mbështetjen e drejtorit të Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe/apo udhëheqësit të SMM.

3. Administrata dhe Organet komunale janë të obliguara që pas hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje, t'i marrin të gjitha masat e nevojshme për zbatimin e kësaj rregulloreje dhe kryerjen e të gjitha detyrave dhe përgjegjësiwe përkatëse.
4. Për të gjitha rastet që nuk janë të rregulluara me këtë rregullore, zbatohen dispozitat e legjislacionit në fuqi që kanë të bëjnë me menaxhimin e mbeturinave.
5. Kryetari mund të nxjerrë Vendime për zbatimin e kësaj Rregulloreje.

Neni 46 Interpretimi i Rregullores

1. Kjo rregullore duhet interpretuar dhe zbatuar brenda kuadrit të Kushtetutës, Ligjit për vetëqeverisjen lokale, Ligjit për mbeturina, dhe Statutit të Komunës.
2. Në të gjitha rastet kur ka kundërthënie të kësaj Rregulloreje me Ligjet dhe dispozitat e Statutit të Komunës do të zbatohen dispozitat e ligjeve dhe statutit.

Neni 47 Shfuqizimi

Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje, shfuqizohet Rregullorja Komunale me Nr të Protokollit: 02/ 4036 të datës: 07.02.2019

Neni 48 Publikimi

1. Kjo rregullore publikohet në gjuhët zyrtare dhe gjuhët në përdorim zyrtare.
2. Kjo rregullore dhe ndryshimet e mëpasshme të saj publikohen ueb faqen e komunës dhe në “Gazetën Zyrtare”.

Neni 49 Hyrja në fuqi

1. Kjo Rregullore pas miratimit nga Kuvendi i Komunës, nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga ministria përgjegjëse për vetëqeverisje lokale, publikohet në ueb faqen e komunës.
2. Kjo Rregullore hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në ueb faqen e komunës.
3. Në ditën në të cilën kjo rregullore publikohet në ueb faqe të komunës do të përcaktohet si dita e shpalljes.

**Emri dhe Mbiemri
Hajdar Sutaj
Kryesues i Kuvendit Komunal**

**01.Nr.XI-6 i aprovuar më
Deçan , dt. __.12 .2023**



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E DEÇANIT
MUNICIPALITY OF DEÇAN
OPSTINA DEÇAN



KUVENDI I KOMUNËS SË DEÇANIT

Nr. _____
Deçan

Bazuar në nenet 11 dhe 12, paragrafi 2, pika c, të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr. 28/2008), nenin 13 shkronja c), Ligjin Nr.04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, Ligji Nr. 03/L-068 për Arsimin në komunat e Republikës së Kosovës, në Rregulloren (MAPL) Nr.02/2021 për Procedurën e Hartimit dhe Publikimin e Akteve të Komunës, Statutit të Komunës Nr. 01/38717, të datës 07.11.2019, Kuvendi i Komunës së Deçanit, në mbledhjen e mbajtur me datë 31.12.2023 miraton këtë:

RREGULLORE NR. ____/2023 **PËR PËRZGJEDHJEN E MËSIMDHËNËSIT TË DALLUAR** **(DRAFT)**

Dispozitat hyrëse

Neni 1 **Qëllimi**

1.1 Kjo rregullore ka për qëllim motivimin e mësimeve në drejtim të avancimit të punës së tyre në procesin edukativo-arsimor, kryerjen e detyrave me përkushtim dhe shtimin e angazhimit të tyre për arritjen e pritshmërive dhe përmbushjen e objektivave.

1.2 Me këtë rregullore përcaktohen procedurat dhe kriteret për përzgjedhjen e mësimeve të dalluar në nivel të institucionit edukativo-arsimor dhe në nivel komune.

1.3 Mësimdhënësi i dalluar në nivel institucioni edukativo-arsimor dhe në nivel komune zgjidhet në çdo vit shkollor.

Neni 2 **Fushëveprimi**

Dispozitat e kësaj rregulloreje duhet të zbatohen nga të gjitha institucionet edukativo-arsimore në komunën e Deçanit, për nivelet e arsimit 0,1,2 dhe 3.

Neni 3

Përkufizimet

Për qëllim të kësaj rregulloreje, termet e përdorura në këtë rregullore kanë kuptimet si në vijim:

3.1 Institucioni edukativo-arsimor i përfshinë të gjitha institucionet e niveleve të arsimit 0, 1, 2 dhe 3.

3.2 Mësimdhënës i dalluar përfshinë mësimdhënësit/edukatorët e nivelit 0, 1, 2 dhe 3.

Neni 4

Kriteret për përzgjedhjen e mësimdhënësit të dalluar

Kriteret për përzgjedhjen e mësimdhënësit të dalluar janë:

- 4.1 Kualifikimi adekuat;
- 4.2 Përvoja e punës në procesin edukativo-arsimor, së paku pesë vite;
- 4.3 Realizimi i punëve dhe detyrave me ndikim në procesin edukativo-arsimor;
- 4.4 Puna që e veçon nga të tjerët (rezultatet);
- 4.5 Organizimi i mësimit shtues dhe plotësues me nxënës;
- 4.6 Organizimi dhe mbajtja e aktiviteteve jashtë kurrikulare (ekstra kurrikulare);
- 4.7 Raportet dhe bashkëpunimi me kolegët, drejtuesit e institucionit dhe prindërit;
- 4.8 Trajnime profesionale të përfunduara, të cilat janë të licencuara dhe të akredituara;
- 4.9 Plotësimi i dokumentacionit zyrtar pedagogjik;
- 4.10 Kontributi në aktivin profesional;
- 4.11 Nismëtar i iniciativave në kuadër të shkollës për përmirësimin e procesit edukativoarsimor;
- 4.12 Portofolia e mësimdhënësit (shkollimi, mirënjohje, trajnime, lëvdata etj);
- 4.13 Bashkëpunimi me prind;
- 4.14 Rezultatet e nxënësve në gara në shkollë, DKA, etj;

Neni 5

Kriteret janë të bazuara në këto standarde

Standardi 1: Njeh dhe i mbështetë vlerat dhe kriteret kryesore që janë vendosur nga MASHT-i /përgjegjësi karshi detyrimeve dhe obligimeve të punës.

Standardi 2: Demonstron qëndrime dhe sjellje pozitive dhe objektive për mirëqenien e nxënësve dhe mësimit.

Standardi 3: Demonstron njohje të kurrikulës/përmbajtjes lëndore dhe metodikës së didaktikës profesionale të lëndës.

Standardi 4: Planifikon zbatimin efektiv të mësimdhënies dhe mësimnxënies.

Standardi 5: Planifikon vlerësimin e vazhdueshëm (vlerësimin për të mësuar), ofron komente kthyesë dhe raporton sa i përket mësimit të nxënësve.

Standardi 6: Angazhohet për zhvillim të vazhdueshëm profesional.

Standardi 7: Angazhohet profesionalisht me kolegë, prindër dhe bashkësi

Neni 6

Procedurat e përzgjedhjes së mësimdhënësit të dalluar

5.1 Procedura e përzgjedhjes së mësimdhënësit të dalluar realizohet në dy javët e fundit të muajit janar, të çdo viti shkollor.

5.2 Drejtori i institucionit edukativo-arsimor e cakton dhe e udhëheq mbledhjen e Këshillit të Mësimdhënësve për përzgjedhjen e mësimdhënësit të dalluar.

5.3 Në këtë mbledhje duhet të formohet komisioni në përbërje prej tre anëtarëve.

5.4 Për shkollat fillore dhe të mesme të ulëta, në komision duhet të përfshihet një edukatore e klasës përgatitore, një mësimdhënës nga cikli fillor (Klasa 1-5) dhe njëmësimdhënës nga cikli i mesëm i ulët (Klasa 6-9), kryetari i këshillit të prindërve në shkollë, pedagogu ose psikologu i shkollës.

5.5 Për shkollat e mesme të larta, në komision duhet të përfshihen tre mësimdhënës (një për klasat e dhjeta, një për klasat e njëmbëdhjeta dhe një për klasat e dymbëdhjeta), kryetari i këshillit të prindërve në shkollë, pedagogu ose psikologu i shkollës.

5.6 Këto komisione përkatëse e organizojnë dhe mbikëqyrin procesin e votimit dhe kanë për obligim të krijojnë kushte dhe të sigurojnë një proces të rregullt dhe transparent dukemundësuar kështu që të zgjidhet mësimdhënësi i dalluar mbi baza të meritokracisë.

5.7 Në procedurën e propozimit për përzgjedhjen e mësimdhënësit të dalluar, mësimdhënësit mund të propozojnë, të jenë të propozuar dhe vetë-propozuar, për t'i hyrë garës për t'u përzgjedhur mësimdhënës i dalluar në nivel të shkollës, nëse i plotëson kriteret sipas nenit 4 të kësaj rregulloreje.

5.8 Pas propozimeve dhe verifikimit të plotësimit të kriterëve sipas nenit 4 të kësaj rregulloreje, komisioni fillon me krijimin e këndit të votimit dhe procedurën e votimit.

5.9 Numri i votave të vulosura duhet të jetë në përputhje me pjesëmarrësit në mbledhje dhe votimi bëhet në mënyrë të fshehtë, në një mjedis që garanton fshehtësinë e votës.

5.10 Nëse pas raundit të parë të votimit, dy ose më shumë kandidatë janë të barabartë me vota, atëherë vazhdohet me raundin e dytë të votimit, deri në përzgjedhjen e mësimdhënësit të dalluar në nivel të institucionit edukativo-arsimor.

5.11 Komisioni duke u bazuar në rezultatet e votimit shpall mësimdhënësin e dalluar në nivel të institucionit edukativo-arsimor.

5.12 Drejtori i shkollës luan rol mbështetës dhe mbikëqyrës të procesit si dhe merre pjesë në votim.

5.13 Këshilli Drejtues i Shkollës (KDSH) duhet të jetë i pranishëm në cilësinë e vëzhguesit të procesit të përzgjedhjes.

5.14 Pas përzgjedhjes së mësimdhënësit të dalluar në nivel të shkollës, kërkohet edhe aprovimi nga Këshilli Drejtues i Shkollës.

Neni 7

E drejta në ankesë

Kandidatët e pakënaqur me procesin e përzgjedhjes së mësimdhënësit të dalluar dhe me vlerësimin e tyre, kanë të drejtë ankesë në institucionin edukativo-arsimor, në afatin prej tre ditësh dhe në Drejtorinë Komunale të Arsimit, në afatin prej 7 ditësh.

Neni 8

Procedimi në DKA

7.1 Pas aprovimit nga Këshilli Drejtues i shkollës, të dhënat për përzgjedhjen e mësimdhënësit të dalluar në nivel të shkollës dërgohen në DKA, pas afatit tre ditësh të ankesave.

7.2 Në DKA, në javën e parë të muajit shkurt, dorëzohet kopja fizike e dosjes së mësimdhënësit të dalluar, e cila duhet të përmbajë biografinë dhe të gjitha dëshmitë për punët dhe aktivitetet e kryera.

7.3 DKA formon komisionin për përzgjedhjen e mësimdhënësit të dalluar në nivel komune i cili përbëhet prej pesë anëtarëve.

7.4 Në përbërje të komisionit për përzgjedhjen e mësimdhënësit të dalluar në nivel komune, duhet të përfshihen tre zyrtarë të DKA-së, një përfaqësues i Këshillit të Prindërve të Komunës dhe një drejtor i institucionit edukativo-arsimor.

7.5 Komisioni i DKA-së do të bëjë vlerësimin e dosjeve sipas kriterëve për përzgjedhjen e mësimdhënësit të dalluar në nivel institucioni edukativo-arsimor dhe përzgjedh mësimdhënësin e dalluar në nivel komune, i cili propozohet kandidat për çmimin tradicional “Shaban Jashari”, mësimdhënës i dalluar në nivel vendi.

Neni 9

Ndarja e shpërblimeve

8.1 Mësimdhënësi i dalluar në nivel të institucionit edukativo-arsimor shpërblehet me shumën monetare prej 400€ (katërqind euro).

Në komunën e Deçanit aktivitete biznesore ushtrojnë 1296 biznese. Në bazë të kriterëve mbi vlerësimin e madhësisë së bizneseve dhe atë numri i të punësuarve të gjitha bizneset individuale janë të vogla ku aktiviteti i tyre është prodhues, tregtar, ndërtimor dhe shërbyes.

Në vitet e fundit qeverisja lokale në Deçan² ka zbatuar një sërë masash reformuese me qëllim të përmirësimit të ambientit të biznesit në komunë. Si rrjedhojë e këtyre reformave, tani ndermarrjet e vogëla dhe të mëdha- NVM-të regjistrohen përmes Qendrës Komunale për Regjistrimin e Bizneseve.

Tabela 4 :Ndërmarrjet ekonomike sipas sektoreve ekonomik për vitin 2022

²Draft –Plani Zhvillimor Komunal 2023-2028

Ndërmarrjet ekonomike, sipas sektoreve ekonomik për vitin 2022 ³	
Seksioni - Titulli	Ndërmarrje (nr.) 2022
A - Bujqësia, pylltaria dhe peshkimi	10
B - Xehoret dhe gurëthyesit	0
C - Industria përpunuese	9
D - Furnizimi me energji elektrike, gaz, avull dhe ajër për kondicionim	2
E - Furnizimi me uje; kanalizimi, menaxhimi me mbeturina dhe aktivitetet rehabilituese	1
F - Ndërtimitaria	17
G - Tregtia me shumicë dhe pakicë; riparimi i mjeteve motorike dhe motoçikletave	22
H - Transporti dhe magazinimi	1
I - Akomodimi dhe aktivitetet e shërbimit të ushqimit	12
J - Informimi dhe komunikimi	5
K - Aktivitetet financiare dhe te sigurimit	0
L - Aktivitetet e patundshmërive	2
M - Aktivitetet profesionale, shkencore dhe teknike	7
N - Aktivitetet administrative dhe shërbimet mbështetëse	7
O - Administrata publike dhe mbrojtja; sigurimi social i obligativ	0
P - Arsimi	1
Q - Shëndetësia dhe aktivitetet e punës sociale	4
R - Arte, argëtimi dhe rekreimi	4
S - Aktivitetet tjera shërbyese	2
T - Aktivitetet e ekonomive familjare si punëdhënës; mallera të padiferencuara - dhe shërbime - aktivitetet prodhuese të ekonomive familjare për shfrytëzim vetanëk	0
U - Aktivitetet e organizatave dhe organeve të huaja	0
Gjithsej	106

Tabela 5: Ndërmarrjet ekonomike, punësimit sipas pronësisë për vitin 2022

Ndërmarrjet ekonomike, punësimi sipas pronësisë për vitin 2022	
Pronesia	Te punësuar (nr.) 2022
Private	2294
Publike- Komunale	52
Publiko (Komunale) - Private	0
Publike- Shoqërore	0
Publiko (Shoqërore) - Private	872
Gjithsej	3218

³<https://www.institutigap.org/documents/reports/De%C3%A7ani.pdf>

Tabela 6: Ndërmarrjet ekonomike, punësimi sipas vendbanimeve për vitin 2022⁴

Ndërmarrjet ekonomike, punësimi sipas vendbanimeve për vitin 2022	
Vendbanimet	Të punësuar (nr.) 2022
Urbane	458
Rurale	1836
Gjithsej	2294

Është inkurajues fakti që numri i përgjithshëm i të punësuarve në sektorin privat ka shënuar rritje ndër vite, duke u bazuar në statistikën që mirret gjatë aplikimit për bizneseve. Ndërmarrjet e llojit SH.P.K kanë mesatarisht numrin e të punësuarve 3-7 ndërsa bizneset individuale 1-3 të punësuar.

Tregtia, prodhimi, ndërtimtaria dhe arsimiti vazhdojnë të punësojnë pothuaj gjysmën e personave të punësuar. Sa i përket pjesëmarrjes në fuqinë punëtore është 44.0 % në këtë periudhë, numri i femrave që i përkasin fuqisë punëtore është 20.0 % ndërsa meshkuj është 65.7 %. Shkalla e papunësisë tek të rinjtë është 50.9 %. Papunësia afatgjate e të rinjve (15-19), që kanë qenë të papunë për më shumë se 12 muaj për këtë tremujor është 50.0 %. Përqindja e të rinjve që nuk janë të punësuar, as në shkollim, as në trajnim – NEET (të intervistuarit e moshës 15-24 vjeç), është 27.1 %.⁵

Duke parë parasysh këtë normë kaq të shprehur, strategjia për zhvillim ekonomik lokal synon të adresoj zgjidhje për përmirësimin e politikave për zhvillim ekonomik lokal duke filluar nga bizneset Individuale që kanë qenë kryesisht START UP, por që kanë gjetur mbështetje dhe disa prej tyre janë përfituese të grandeve nga niveli qëndror dhe një numër i caktuar tyre nga donacione të ndryshme.

Tabela 7: Ndërmarrjet ekonomike, punësimi sipas sektoreve ekonomik për vitin 2022⁶

Ndërmarrjet ekonomike, punësimi sipas sektoreve ekonomik për 2022	
Seksioni- Titulli	Të punësuar (nr.) për vitin 2022
A - Bujqësia, pylltaria dhe peshkimi	413
B - Xehoret dhe gurëthyesit	0
C - Industria përpunuese	43
D - Furnizimi me energji elektrike, gaz, avull dhe ajër për kondicionim	15
E - Furnizimi me uje; kanalizimi, menaxhimi me mbeturina dhe aktivitetet rehabilituese	7
F - Ndërtimtaria	700
G - Tregtia me shumicë dhe pakicë; riparimi i mjeteve motorike dhe motoçikletave	698
H - Transporti dhe magazinimi	6
I - Akomodimi dhe aktivitetet e shërbimit të ushqimit	284
J - Informimi dhe komunikimi	16
K - Aktivitetet financiare dhe të sigurimit	0

⁴<https://www.institutigap.org/documents/reports/Let%C3ABrnjoftim%20%20Komun%C3%Abs%20s%20>


⁵ Agjencia e Statistikave e Kosovës: Seria 5: Statistikat Sociale Anketa e Fuqisë Punëtore TM2 - 2022

⁶<https://www.institutigap.org/documents/reports/Let%C3ABrnjoftim%20%20Komun%C3%Abs%20s%20>

⁷ Agjencia e Statistikave e Kosovës: Seria 5: Statistikat Sociale Anketa e Fuqisë Punëtore TM2 - 2022

L - Aktivitetet e patundshmërive	3
M - Aktivitetet profesionale, shkencore dhe teknike	17
N - Aktivitetet administrative dhe shërbimet mbështetëse	23
O - Administrata publike dhe mbrojtja; sigurimi social i obligativ	0
P - Arsimi	3
Q - Shëndetësia dhe aktivitetet e punës sociale	39
R - Arte, argëtimi dhe rekreimi	18
S - Aktivitetet tjera shërbyese	9
T - Aktivitetet e ekonomive familjare si punëdhënës; mallera të padiferencuara - dhe shërbime - aktivitetet prodhuese të ekonomive familjare për shfrytëzim vetanake	0
U - Aktivitetet e organizatave dhe organeve të huaja	0
Gjithsej	2294

Tabela8: Përfaqësimi gjinor në biznesë në muaj dhjetor 2023⁷



8. SFIDAT E ZHVILLIMIT EKONOMIK LOKAL

Në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale Nr.03L/-040, përkatësisht në nenin 17, zhvillimi ekonomik lokal është në mesin e kompetencave vetanake të komunave, që, mes tjerash, nënkupton se komunat kanë hapësirë që ta planifikojnë zhvillimin ekonomik lokal të tyre, t'i përcaktojnë përparësitë zhvillimore dhe strukturore, si dhe ta definojnë përkrahjen për zhvillimin ekonomik lokal. Përkundër rregullimit të mirë ligjor dhe përpjekjeve ndër vite, komuna e Deçanit në lidhje me planifikimin e zhvillimit ekonomik lokal, ballafaqohet me sfida ndër sfidat kryesore me të cilat ballafaqohet në aspektin e

⁷Agjencioni për regjistrim Bizneseve – Zyra për Regjistrim Bizneseve në Deçan (Bizneset Aktive) 2023

zhvillimit ekonomik janë kapacitetet pakta komunale për ta ndihmuar zhvillimin ekonomik, mungesa e përkrahjes në nxitje të investimeve në sektorët me prioritet siç është turizmi, shpërputhja e aftësive në tregun e punës, mungesa e qëndrueshmërisë financiare me varësi të madhe në nivelin qendror, pengesa në zhvillimin ekonomik lokal veçanërisht sektorin e turizmit, infrastruktura ligjore centralizuar (Parkun Kombëtar, Zona e Posaçme e mbrojtur) etj. Gjithashtu sfidë tjetër është edhe zhvillimi i ulët i sektorit të prodhimit, mungesa e teknologjisë të avancuar në ferma dhe kultivimi i produkteve bujqësore me vlerë të shtuar, siguri në cilësisë në arsim dhe mjedisë shkollor, ofrimi i shërbimeve sociale cilësore, rritja e numrit të shërbimeve nga institucionet e kujdesit primar shëndetësor si dhe zhvillimi i kulturës dhe sportit.

Një ndër sfidat kryesore të sektorit privat mbetet prania e madhe e ekonomisë joformale, qoftë në aspekt deklarrimit të punëtorëve, poashtu edhe në aspekt të pagesës së tatimeve dhe pajtueshmërisë ligjore. Ky fenomen e bën shumë të vështirë për kompanitë që veprojnë konformë ligjit që të konkurrojnë në të njëjtin ambient me ato biznese që për një arsye apo tjeëter operojnë në mënyrë joformale. Mungesa e shkathtësive më së shumti vërehet në sektorin e prodhimit, kryesisht përshak të mungesës së punës praktike tek të rinjtë e interesuar për punë. Një përqindje shumë e madhe e bizneseve nga sektori i prodhimit apo hasin më shumë vështirësi në rekrutimin e punëtorëve me aftësi të larta dhe shkathtësitë e nevojshme. Bizneshet nga sektori i prodhimit kanë vështirësi në gjetjen e punëtorëve me kualifikime specifike, që janë të nevojshme në procese të prodhimit, si: saldatorë, makinistë, zdrukthtarë, teknikë të ushqimit, kuzhinierë etj. Për më tepër trajnimi i punëtorëve të rinjë paraqet shpenzime të larta për biznese, por njëkohësisht ata nuk kanë garanci që personat e trajnuar do të qëndrojnë të punojnë në bizneset e tyre. Sfidë kryesore për bizneset e Deçanit emigrimi i fuqisë punëtore po ashtu mbetet plasimi i prodhimeve në tregjet e huaja, ndërtimi i kapaciteteve të brendshme për eksport, planifikimi i eksporteve, certifikimi i produkteve dhe bizneseve të tyre me standart të cilësisë si: ISO9001, ISO 14001, ISO 22000/HACAP; ISO 27001, etj.

Strategjia e Zhvillimit Ekonomik Lokal dhe Plani i Veprimit 2023-2030 i adreson të gjitha problemet aktuale me të cilat ballafaqohet komuna dhe ofron zgjidhje praktike që përmirësojnë komunën e Deçanit në raport me komunat e tjera. Në pajtueshmëri me pozicionin e synuar konkurrues dhe mundësi buxhetore janë përcaktuar objektivat dhe synimet për periudhën 2023-2030.

Realizimi i projekteve strategjike të komunës duhet të bëhet edhe përmes thjeshtimit të procedurave për përdorim të pronës komunale në raport me investitorët potencial. Siç dihet është e hartuar korniza ligjore nga niveli qendror për investime strategjike e cila mundëson nxitjen, tërheqjen dhe krijimin e kushteve për realizimin e investimeve strategjike⁸. Komuna e Deçanit ka bërë kërkesë për zonë të zhvillimit me inetres në kuadër të Bjeshkëve të Nemura të Parkut Kombëtar. Ky fond i tokave mund të planifikohet për dhënie në shfrytëzim, krijimi i kushteve për infrastrukturë përcjellëse në pronat komunale, për të mundësuar realizimin e projekteve strategjike në nivel lokal për sektorin e turizmit.

Implementimi i kësaj strategjiekërkon bashkëpunim të ngushtë në mes nivelit qendror dhe lokal, poashtu të komunitetit të bizneseve dhe qytetarëve. Përmes bashkëpunimit në zbatim, krijohen kushte që të ndërtohet një ekonomi lokale që nxit rritjen dhe zhvillimin për të gjithë.

⁸Republika e Kosovës, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal: "Strategjia për vetëqeverisje lokale 2016-2026", Prishtinë, Shkurt, 2016

9. TË DHËNAT GJEOGRAFIKE

Komuna e Deçanit ka një pozitë mjaftë të mirë gjeografike. Ndodhet në pjesën Perëndimore të Kosovës dhe të Rrafshit të Dukagjinit. Gjendët pothuajse në qendër të Ballkanit, në vijën ajrore nga Deti Adriatik më gjatësi 90 km, kurse 220 km gjatësi nga Deti Egje. Në Perëndim kufizohet më Republikën e Shqipërisë që shtrihet prej PT-1660 deri PT-2366 në gjatësi prej 13850 m. Në Veri-Perëndim kufizohet me Malin e Zi PT-2366 deri 2424 me gjatësi 9750 m.

Në Veri kufizohet me Komunën e Pejës PT-2424 deri 460 [Maznik] me gjatësi prej 50550m.

Në Jug-Lindje dhe Jug kufizohet me Komunën e Gjakovës dhe Junikut nga PT-460 deri PT- 1660 [Rajoni i gjerë i Rrasës së Koshares].

Komuna e Deçanit shtrihet në një sipërfaqe prej 293,948,468.50 m² ose 293,94 km² dhe përfshinë 136 banorë për km²

- 5504.53 sipërfaqe e shfrytëzuar e tokës bujqësore/sipërfaqe ha
- 4302.07 tokë e punueshme /arë sipërfaqe ha
- 198.6 ha kopshte ha
- 1873 livadhe ha
- 150.4 ha - tokë bujqësore e papërdorur sipërfaqe ha
- 15995.4 ha - tokë pyjore sipërfaqe ha-park kombëtar Bjeshket e Nemura
- 790.7 Zona e vecantë e mbrojtur rreth manastirit të Deçanit ha
- 378.6 tokë jo bujqësore sipërfaqe ha
- 200.75 tokë e degraduar (depone, ndërtime) sipërfaqe ha

Komuna e Deçanit ka një qendër administrative dhe 38 fshatra. Qyteti i Deçanit nga kryeqyteti (Prishtina) ka një largësi prej 90 km.

Në këtë hapësirë jetojnë rreth 40,019 banorë, sipas regjistrimit të popullsisë të vitit 2011.

Lartësia mbidetare varion nga 412 lartësi mbidetare në fshatin Maznik deri në 2530 m lartësi mbidetare në majën e Marjashit. Në sajë të krijimit të relievit Komuna e Deçanit ndahet në dy pjesë:

- Në Ultësi që është pjesë e rrafshit të Dukagjinit;
- Dhe në Lartësi që përfshin masivin e Bjeshkëve të Nemuna (Alpet shqiptare)

Bjeshkët e Nemuna, apo Alpet shqiptare, shtrihen në pjesën Perëndimore të Komunës së Deçanit, që i takon nga sipërfaqja e përgjithshme e parkut, ka përfshirje me këtë sipërfaqe prej 16,786 ha, apo 27% nga territori i Bjeshkeve të Nëmuna.

Lartësitë e Bjeshkëve të Nëmuna pak ndryshojnë nga lartësia e vargmaleve alpine. Këto janë pjesët më të larta dhe më shkëmbore të vargmaleve të siujdhesës Ballkanike.

10. TË DHËNAT KLIMATIKE

Deçani ka klimë kontinentale me ndikim të klimës mediterane. Gjatë vitit në Deçan ka 1975 orë me diell. Viset e ulëta të Deçanit karakterizohen me temperatura relativisht të larta me vlerë mesatare vjetore më tepër se 11°C, me muajt më të nxehtë gushtin dhe korrikun 21.7° C dhe 21.68°C dhe me muajin më të ftohtë janarin – 0.5°C.

Lagështia mesatare e ajrit gjatë vitit është 70.2% në të cilin rast rritja është dukshëm më e madhe prej verës nga dimri për 17.5% se sa zvogëlimi prej dimrit në drejtim të verës.

Në këtë rajon vranësirat mesatare vjetore janë 58% gjatë së cilës frekuenca e ditëve të kthjellëta është 60.5 (16.6%) në vit, ndërsa e ditëve pa diell 119,3 ditë (32.6%). Zgjatja mesatare vjetore e zënies së diellit për shkak të ndikimeve orografike është më e vogël se sa mesatarja për Kosovë dhe është 1972 orë, nga e cila në Korrik 293,6 orë, ose 72.1% diell në vit. Sasitë e të reshurave në këtë rajon janë ndër më të mëdhatë në Kosovë. Në viset e ulëta është 724,6 lit/m², në viset malore të Bjeshkëve të Nemuna sasitë mesatare të të reshurave arrijnë më tepër se 1.300 lit/m².

Era, shpejtësia mestare e erës gjatë vitit është 16 m/s, ndërsa ajo maksimale arrin deri më 26,5 m/s. Më së shumti fryn era nga veriu dhe veriperëndimi;

Trashësia e borës në viset kodrinore-malore, gjatë dimrit arrinë deri më 50 cm, në viset më të larta (bjeshkë) edhe mbi 1m, kurse në lartësitë e mëdha malore (alpine) qëndron gjatë tërë vitit.

Shi bie më së shumti në pranverë dhe vjeshtë edhe atë mesatartisht 900-1500 mm. Elementet kryesore që i përkasin komunës janë: moti i kthjellët, lartësia e lartë mbidetare e bjeshkeve të Deçanit, temperatura të freskëta gjatë verës dhe mjaft të ftohta gjatë dimrit, reshjet atmosferike me sasi të bollshme të ujërave. Kushtet e këtilla klimatike mundësojnë zhvillimin e aktiviteteve rekreative gjatë gjithë vitit e sidomos ato sportive (skijimit) gjatë sezonës së dimrit.

11. TË DHËNAT DEMOGRAFIKE

Bazuar në regjistrimin e popullsisë të vitit 2011, është 40019 banor ku dendësia e popullsisë në komunën e Deçanit është rreth 136 banorë në 1 km², që është nën mesataren në nivel vendi prej 165 banorë në 1 km². Në disa vendbanime që kanë numër më të madh të popullsisë edhe dendësia është shumë më e lartë dhe e kundërta në vendbanimet që kanë numër të vogël të popullsisë edhe dendësia është shumë më e vogël. Sipas Raportit për Vlerësimin e Popullsisë së Kosovës i publikuar nga ASK-ë në fund të vitit 2021 komuna e Deçanit kishte 42,755 banorë⁹.

Tabela 9: Të dhënat nga Regjistrimet e popullsisë në periudhat 1948–2011 për komunën e Deçanit

Viti	Ekonomia Familjare		Popullsia		Madhësia e Familjes (Numri i antarëve në familje)	
	Komuna	Qyteti (Vendbanimi mi Deçan)	Komuna	Qyteti (Vendbanimi mi Deçan)	Komuna	Qyteti (Vendbanimi mi Deçan)
1948	23	188	17840	1205	7.6	6.4
1953	2	226	19223	1339	7.8	5.9
1961	2	327	22230	1829	7.7	5.6

⁹ASK-ë; Vlerësimi i Popullsisë së Kosovës 2021, Prishtinë, qershor 2022

1971	3	431	27478	2585	8.4	6.0
1981	4	519	35577	3280	8.8	6.3
1991 ¹	5 0	721	42898	4440	8.5	6.1
2011 ²	5 8	602	40019	3803	6.8	6.3

Të dhënat e shtimit natyror për vitin 2021 janë vlerësuar duke i shfrytëzuar të dhënat për lindjet dhe vdekjet nga Agjencia e Statistikës së Kosovës për vitin 2021 për komunën e Deçanit. Gjatë vitit 2021 në komunën e Deçanit janë shënuar 554 lindje dhe 279 vdekje. Bazuar në këto të dhëna është llogaritur shkalla e shtimit natyror për vitin 2021 është 275, gjithsej popullsia dhe shtimi natyror për 31 dhjetor 2021 është 42.755. Nëse i analizojmë të dhënat për numrin e popullsisë për komunën e Deçanit prej vitit 1948– 2011 del se numri i popullsisë ka rritje për 22,179 banorë.

Sipas moshës: Mosha e re 0-14 vjeç merr pjesë me 26.2% në popullsinë e Deçanit, ndërsa grup-moshat 15-64 që është popullsi aktive (e aftë për punë) merr pjesë me 66.4%, kurse mosha 65 vjeç e më tepërt kanë pjesëmarrje të vogël me rreth 7.4% të popullsisë së përgjithshme. Në përgjithësi grup moshat e popullsisë 15-64 vjeç dominojnë në popullatën e përgjithshme.

Sipas gjinisë: në grup moshat 15-19 vjeç, raporti meshkuj/femra është 50.3% / 49.7% femra, derisa në grup moshat 30-44 vjeçare dhe 50 e më shumë vjeç dominon gjinia femrore. Gjatë vlerësimit të popullsisë për komunën e Deçanit në vitin 2028 është marrë për bazë komponenti themelor që ndikon drejtpërdrejtë në rritjen demografike siç është shtimi natyror. Sipas të dhënave të vlerësuar nga Agjencia e Statistikave të Kosovës për periudhën 2011 deri 2028 del se në komunën e Deçanit për çdo vite kemi shtim natyror të popullsisë prej 225 banorë. Në fund të vitit **2021** komuna e Deçanit kishte **42,755** banorë¹⁰. Si rezultat përlogaritja e rritjes se popullsisë për vitin 2028, popullata e komunës së Deçanit do të jetë rreth **44,126 banorë**.

12. ZHVILLIMI EKONOMI

Komuna e Deçanit ka një bazë mjaft të mirë të zhvillimit ekonomik, bazuar në resurset ekzistuese. Ekziston mundësia e zhvillimit të shumë sektorëve ekonomik, filluar nga veprimtaritë primare ekonomike, ato sekondare, terciare e shërbyese. Sipërfaqet e konsiderueshme me tokë bujqësore, pyje, ara, livadhe e kullosa, ofrojnë një bazë të mirë për zhvillimin e aktiviteteve primare ekonomike. Gjithashtu, kjo komunë ka bazë të mirë edhe në veprimtari të lehta industriale, ndërsa bukuritë natyrore ofrojnë mundësi të mirë për zhvillimin e turizmit. Komuna e Deçanit duhet të ofroj shërbime edhe më efikase në të ardhmen dhe kjo mund të realizohet me një angazhim serioz dhe profesionalizëm në ngritjen e kapaciteteve human ne fushën e turizmit. Tërë planifikimi për zhvillimin e ardhshëm ekonomik të komunës duhet të mbështetet në potencialet ekzistuese natyrore dhe kulturore dhe në avancimin e mëtejshëm të resurseve humane.

Qëllimi kryesor është që të arrihet një zhvillim i qëndrueshëm ekonomik duke i shfrytëzuar resurset në mënyrë racionale, por gjithsesi duke i lënë mundësinë edhe gjeneratave që vijnë për t'i shfrytëzuar ato resurse. Hapësira e komunës së Deçanit ka dallime të theksuara sa i përket strukturave ekonomike, sociale dhe natyrore. Bazuar në këto dallime, edhe propozimi i zhvillimit ekonomik do të ketë një diversitet të pasur. Tri mundësi që ofron kjo komunë si pjesa rurale për zhvillimin e eko turizmit, pjesët historike dhe bjeshkët e Deçanit.

¹⁰ASK-ë; Vlerësimi i Popullsisë së Kosovës 2021, Prishtinë, qershor 2022

Zhvillimi i industrisë së lehtë dhe i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme NVM-ve

Komuna e Deçanit, për krijimin e një ambienti tërheqës për biznes dhe një strukturë e industrisë së lehtë konkurruese bazohet në potencialin e resursit natyror, i cili ka një ndikim të konsiderueshëm në ekonominë e komunës së Deçanit, në veçanti zhvillimin e agro turizmit dhe agro industrisë.

NVM-të tashmë kanë një ndikim të konsiderueshëm në ekonominë e komunës dhe konsiderohet që zhvillimi i mëtutjeshëm i tyre krijon kushte për rritje të shpejtë të punësimit dhe njëkohësisht mundëson shfrytëzimin e potencialeve lokale: produkteve bujqësore si lëndë e parë dhe fuqisë punëtore në dispozicion. Politikat zhvillimore në komunë bazohen në rritjen e potencialit intensivë të këtij sektori, formimi i grupimeve në degët konkurruese dhe shpërndarja efikase hapësinore e aktiviteteve ekonomike.

Koncepti i zhvillimit ekonomik të NVM-së për ushtrimin e veprimtarisë së tyre komuna e Deçanit duhet të planifikoj zona për ushtrimin e veprimtarisë së industrisë së lehtë, agro turizëm dhe shtrirjen e veprimtarive të NVM-së sipas ndikimit të tyre në mjedis.

Veprimtaritë ekonomike terciare-sektori shërbyes si tregtia me pakicë, hoteleria, zejet, bankat, etj. do të promovohen për zhvillim përgjatë korridoreve kryesore në zonën urbane. Zhvillimi i rrjetit të kapaciteteve për furnizim dhe shërbime do të bëhet në përputhje me frekuencën e përdorimit të tyre: kapacitetet e furnizimit të përditshëm duhet të bëhen në përputhje me shpërndarjen hapësinore të popullsisë. Edhe në zonat rurale gjithashtu është e nevojshme të ofrohen shërbime për të përmbushur nevojat themelore të përditshme të popullatës.

Të mbështeten dhe përkrahen NVM-ve sipas një plani afatmesëm që nënkupton edhe intensifikimin e bashkëpunimit komunë-biznese për ndërtimin e partneriteteve publiko-private, ku në fshatin Dranoc është caktuar hapësira për parkune biznesit

¹¹ **Harta1 : Parku I biznesit në fshatin Drenoc**



¹¹Draft-Plani Zhvillimor Komunal 2023-2028

TURIZMI

Në komunën e Deçanit turizmi është një perspektivë që paraqet një shtyllë kryesore të qëndrueshme për zhvillimin ekonomik lokal. Komuna e Deçanit, shquhet për vlera të rralla të trashëgimisë natyrore dhe trashëgimisë kulturore me asetë unike turistike. Pozita gjeografike, relievi, klima, burimet ujore, peizazhet, grykat, bota e pasur bimore dhe shtazore janë parakushte ideale dhe potencial i lartë për zhvillimin e turizmit dhe ekoturizmit. Deçani ka mundësi të mira të tëllojeve të turizmit si:

- Turizmimalorë;
- Turizmi rekreativ-sportiv;
- Turizmi verorë dhe dimëror;
- Speleoturizmi (shpellave);
- Turizmi rural (ekoturizmi rural);
- Turizmi edukativ arsimor;
- Destinacion ekoturistike në zonën e veqanta të mbojtura.


Turizmi malor dhe ecja në natyrë

Në zonat e thella malore të bjeshkëve të Deçanit ekzistojnë shumë shtigje malore të cilat paraqesin mundësi reale për zhvillimin e ecjes në natyrë, shëtitjeve malore me biçikleta por edhe të ekspeditave dhe kampingjeve, Bjeshka e Belegut e cila ka shenjëzimin me gjatësi 4.2 km (sinjalistikë) gjithashtu është tabelat orientuese të cilat janë dhe vendosura në të gjitha bjeshkët me vendpushimore-pika pushuese dhe pikat ushqyese për kafshët.

Turizmi rekreativ dhe sportiv

Bjeshka e Belegut gjendet larg qytetit të Deçanit me një distancë 28 km. Kjo bjeshkë ofron natyrë me pamje magjepsë të majës së Marijashit dhe varg maleve të “Bjeshkëve të Nemuna”. Në vitin 1978 është hartuar plani i fizibilitetit ekonomik nga “Instituti për zhvillim ekonomik” i Zagrebit si qendër e skitarisë. Infrastruktura rrugore është e mirë dhe e asfaltuar me gjatësi 6 km, e pa asfaltuar 6 km në zonën e mbrojtur ndërsa parashihet të asfaltohet edhe 12 km e cila rrugë ndërlidhe Deçanin me Malin e Zi. Bjeshka e Belegut, ofron kushte të mira për turizmin dimëror, pasi trashësia e borës shkon 3-5 m në lartësinë 2200 m, me gjatësi shtigjesh 1-5 km. Vetë ekspozicioni i këtyre terreneve, veri-perëndim, verilindje dhe jug-lindje, ofron kushtet e krijimit të shtresave cilësore të dëborës, prej fundit të muajit dhjetor, deri në muajin qershor. Pranvera dhe vjeshta i japin një koloritet të jashtëzakonshëm kësaj natyre, ku tërë territori derdhet në spektrin e ngjyrave të llojllojshme. Bjeshka Belegut paraqet një pikë të rëndësishme jo vetëm për zhvillim lokal, por dhe për Kosovën në përgjithësi ku duhet të shtohet numri i bujtinave dhe infrastruktura përcjellëse, rrugore, elektrifikim, uji (sanitacion), dhe hotele.

Harta 2-Projektii Qendrës Turistike Bjeshkë e Belegut



Turizmi veror dhe dimëror

Është i përshtatshëm për zhvillimin e kësaj pjesë duke u bazuar nëburimet e shumta ujore, peizazhet piktoreske, terrenet e përshtatshme për ndërtimin e shtigjeve të skijimit si dhe prania e bujtinave qëjanë parakusht i mirë edhe për zhvillimin e turizmit. Lokacionet që ofrojnë kushte të mira dhe kanë vlera turistike janë: Bjeshka e Belegut dhe Deçanit.

Shtegu i hekurt “VIA FERRATA”, është një atraksion i veçantë turistik për ecje dhe ngjitje, që ndodhet përgjatë Grykës së Deçanit të Kërshi i Qelisë, 4 km larg qendrës së qytetit, shtegu i ngjitjes është me gjatësi 407 metra

Speleoturizmi (shpellave)

Për opinionin e gjerë nuk janë të njohura bukuritë natyrore të Shpellës së Bojkut dhe shpella në fshatin Belle, në të cilën shihen gjurmët e njerëzimit që kanë qenë aty brenda po ashtu nën shpellë ka edhe liqen dhe burime të tjera ende të pa hulumtuara dhe studiuar që janë pasuri për vendin.

Gjithashtu speleoturizmi në komunën e Deçanit nuk është i hulumtuar aq sa duhet ku mund të ketë edhe shpella të tjera në territorin e komunës.

Turizmi rural

Në shumë zona rurale të komunës së Deçanit, ka potencial arkitektonik-kullat monumente materiale duke përfshirë edhe kulturën shpirtërore ku ende ruhen shumë zakone, tradita, lojëra, këngë, veshje e ushqime tradicionale që ofrojnë kushte të mira për zhvillimin e këtij lloji të turizmit. Këto pasuri të jashtëzakonshme kulturore janë një mundësi e mirë e zhvillimit të turizmit rural dhe promovimit të këtyre vlerave. Në veçanti për këto vlera shquhen fshatrat që shtrihen në pjesën malore dhe pjesën rurale të cilat janë:

- Pleqe;
- Belle;
- Hulaj;
- Voksh;
- Drenoc;
- Gllogjan;
- Isniq;
- Dubovik etj.


Turizmi edukativ arsimor

Ekosistemet e paprekura malore, prania e llojeve të rralla bimore e shtazore, shpellat e pa hulumtuara, kanionet e lumenjeve, rrjedhat e shumta ujore dhe pasuritë nëntokësore të Deçanit kanë potencial edhe për zhvillimin e aktiviteteve edukative e kërkimore me nxënës, studentë dhe shkencëtarë nga Kosova por edhe për ekspedita të huaja hulumtuese.

Destinacion ekoturistike në zonat e veqanta të mbojtura

Burimi i ujit mineral është një ndër pikat më të rëndësishme turistike që ka Deçani. Kjo pasuri i jep mundësi Deçanit për ngritjen e infrastrukturës për kurim të sëmundjeve ngjitëse, sëmundjeve të lëkurës, sëmundjeve të eshtrave, etj. Burimi mineral është në masivin gëlqeror, në pjesën e majtë të lumit. Është burim i tipit karstik. Uji, nga këta gurë gëlqerorë, del nga disa çarje dhe plasa në sipërfaqen e tokës dhe një pjesë në aluvionet e lumit. Kapaciteti i burimit mineral, sipas një pompimi testues, vërtetoi se me këtë sasi të prurjes së ujit mineral: $Q = 16 \text{ l/s}$, 80 metra më poshtë nuk kishte rrjedhje të ujit, ndërsa në metrin 175 m rrjedhja e ujit ishte $Q = 1,4 \text{ l/s}$. Mbi metrin 170 m, rritet kapaciteti në $Q = 5,6 \text{ l/s}$, në metrin e 80 m, $Q = 7,0 \text{ l/s}$ dhe mbi 31 m, prurja e ujit ishte $Q = 16 \text{ l/s}$. Ky burim derdhet në një bazen të krijuar nga vet banorët e Deçanit, në mënyrë që të shfrytëzohet për nevojat e tyre, edhe pse kushtet e këtij bazeni nuk janë shumë të mira për t'u përdorur si duhet. Konflikti me manastirin e Deçanit ka penguar që në këtë vend të investohet dhe të krijohen kushte më të mira për shfrytëzimin e këtij burimi. Edhe pse në këto kushte jo të mira, ky vend vizitohet shumë jo vetëm nga banorët e Deçanit, por edhe nga mbarë Rrafshi i Dukagjinit, pasi siç e kemi cekur më lart, ky ujë ka veti shëruese, si për sëmundjet e lëkurës, ashtu edhe për shumë sëmundje të eshtrave, duke përfshirë edhe problemet reumatike.

Harta 3- Harta e pikave dhe zonave turistike



12.3

12.3

Priotitetet per zhvillimin e turizmit në komunën e Deçanit

Duke pasur parasysh se për ndërtimin e një qendre bashkëkohore, turistike me sezon aktive verore dhe dimerore duhet një kohë e gjatë dhe mjete te konsiderusheme investive si dhe përkrahja e nivelit qendror. Ndërtimi që parashikohet të kryhet është në të gjitha Bjeshkët e Nemuna te Komunës se Deçanit. Ndërtimi i këtyre qendrave parashihet të kryhet në disa etapa. Investimet në fillim duhet te orientuar në zhvillimin e lokaliteteve që lidhen më mirë në rrjete rrugore dhe kanë potencial të pasur resursesh, ku duhe të respektohet parimi i koncentrimit të ndërtimeve turistike dhe të konceptit të marketingut (brendit). Në procesin e ndërtimit dhe të organizmit të përmbajteve turistike malore një kujdes i veçant duhet t'i kushtohet ruajtjes dhe përparimit të sistemit ekzistues ekologjik të Bjeshkëve të Nemuna. Çdo cenim i barazpeshes do të kishte pasoja negative në mundësitë e valorizimit turistik. Prandaj organizimi i parkut kombëtar në rajonin e hapësirës të komunës se Deçanit është një hapë i rëndësishëm në shfrytëzimin e organizuar optimal të mundesive potenciale të këtij rajoni.

Destinimi i Komunsë sëDeçanit si vend turistik brendaBjeshkëve të Nemuna, zonat që duhet të përcaktohen si zona zhvillimore dhe lokalitete me potencial në ofrim të turisteve, të cilat zona do të jenë në funksion të rëndësishëm i zhvillimit ekonomik lokal. Dihet që turizmi, fale funksionit të tij ekonomik si shtylle kryesore zhvillimore në komunën e Deçanit, shfaqet si katalizator i rëndësishëm hapësinore i veprimtarive ekonomike si dhe një nga faktorët e rralle të integritetit rajonal. Në një të ardhme të afërt për një zhvillim të qëndrueshme dhe koordinim të aktiviteteve duhet të harmonizohen planet e zhvillimit të turizmit të kësaj zone me shtetet fqinje. Në konceptin e zhvillimit të turizmit janë identifikuar zonat me kapacitete:

ZonatdhelokalitetetTuristiketëDeçanit:

- Lokaliteti i Luginës sëLumëbardhit;
- LokalitetiLuginës sëLloqanit;
- Lokaliteti i Podit të Gështejave;
- Lokaliteti i Pishavetë Deçanit;
- Lokaliteti i Bellesë dhe Pleqës;
- Lokaliteti i i Kozhnjerit;

- Lokaliteti(Bjeshka e Belegut,Prejlepit,Roshkodolit,Milishevcit,Zllonopoja,Baballoqit),
- LokalitetiBjeshka:Zallii Rupës,Carrabregu,Deqani,Pllaqica eVokshit,Stanishta eZogut,Dobroshit,Kurvalla.
- Lokaliteti i Bjeshkëve tëStrellcit
- Lokaliteti i Radoniqit,
- Trashëgimia natyrore dhe kulturore në Qytetin e Deçanit
- Trashëgimia kulturore në fshatrat e Deçanit.

Zyra Turistike Informuese dhe Produkti trustike

Zyra informuese për turizëm ofron të dhëna për turizmin në Komunën e Deçanit.



Foto: Logoja, Deçani një destinacion i shkëlqyer i natyrë

Edhe përkundër të shumë të mirave që posedon kjo pjesë ekziston edhe databazë e dhënave të prezantuara në formë të ueb faqes turistike,¹²ku janë të prezantuaranga komuniteti, shoqëria civile po ashtu janë edhe organizimet të evenimenteve tradicionale (dita e qethave të deleve, dita e lames, dita e mjalit, dita egështenjës, dita e rakisë) etj. Është e domosdoshme të bëhet digjitalizimi dhe rrjetëzimi me qendrat e tjera turistike ndre-komunal dhe rajonal.

Zhvillimi i turizmit ndërkufitar Kosovë-Mali i Zi-Shqipëri në Bjeshkët e Nemuna

Një prioritet që duhet kushtuar rendësi është edhe bashkëpunimi ndërkufitar, i cili konsiston në turizmin malor, ecjen nëpër shtigjet që lidhin këto tri shtete nëpër viset më të larta dhe fshatrat e largëta malore të Bjeshkëve të Nemuna. Shtegu turistik “Majat e Ballkanit” (Peaks of the Balkans), është i gjatë 192 km që krijon një rreth të mbyllur në të tria shtetet, Shqipëri (Theth), Mali i Zi (Plavë) dhe Kosovë (Deçan bjeshka e Milishevcit dhe përfundon në Bjeshkët e Rugovës-Pejë).

Vizita mund të filloj nga cilido shtete. Këto shtigje mund të kalohen për 10-13 ditë varësisht nga interesimi, kërkesat dhe kondicioni i vizitorëve, shëtitja është e organizuar dhe shoqërohet me udhëheqës turistik që do t’i sjellin përmirësim gjendjes socio-ekonomike.Këto aktivitete do të kenë ndikim direkt në ngritjen ekonomike të banorëve duke krijuar mundësi mbështetje për ndërtimin e kapaciteteve për shërbime, bujtinat dhe infrastrukture përcjellëse hotelerie.Mundësitë për bashkëpunim ndërkufitar mes tri shteteve-Kosovë, Shqipëri, Mali i Zi janë të mëdha, pasi që këtë e mundëson pozita e cila i lidh ato me zonat përtej kufijve si:

- Lugu i Shkodrës lidhë Roshkodol me Shkodrën;
- Tre kufiri qe lidh Plave (Malin e Zi) dhe Shkodër (Shqipërinë) Roshkodoli, Bjeshka e Belegut.

¹²decanitourism.org

Harta 4: Shtegu i shetitjes – Shqipëri, Kosovë, Mali i Zi



Shtegu i ecjes- Via Dinarica

Shtrirja në shtegun Via Dinaricës përfshinë gjatësinë për 120 km përmes Parkut Kombëtar të Bjeshkëve të Nemuna. Itinerari është i ndarë në tre shtigje të ndryshme: Shtegu i Bardhë është shumë sfidues, pasi kalon majat më të larta; Gjurma e Gjelbër shkon më në jug përmes luginave, pyjeve, lumenjve dhe fshatrave; Gjurma Blu që ndjek bregun e Adriatikut në jug. Via Dinarica kalon nëpër mjedise të pacenuara natyrore, por edhe vende historike me shtëpi barinjsh tradicionale, fortesa guri dhe mbetjet e gjurmëve të lëna ndër shekuj nga ilirët, romakët, sllavët, osmanët dhe serbët, si kishat katolike, xhamitë myslimane dhe manastiret ortodokse.

Projekti synon të krijojë një turizëm të qëndrueshëm që mund të nxisë rritjen e komuniteteve në fjalë. Projekti synon zhvillimin e industrisë së turizmit në zhvillim të Kosovës. Për Bashkimin Evropian Via Dinarica simbolizon rimarrjen e një rruge të lashtë që bashkon popujt ballkanikë. Turizmi i qëndrueshëm është një shtyllë e politikave evropiane dhe atyre të Agjencisë Italiane për Bashkëpunim dhe Zhvillim (Aics) pasi është një mjet për promovimin e përfshirjes sociale të komuniteteve malore dhe zhvillimit të gjerë ekonomik.

PRODUKTI TURISTIKE

Ndër fushat kryesore të zhvillimit të një vendi është padyshim turizmi. Qyteti ynë Deçani, është një nga komunat që është e bekuar me bukuri të rralla, me një natyrë mahnitëse, me vende atraktive turistike e kulturore. Bjeshkët që e karakterizojnë qytetin tonë, kullat si vlerë e veçantë e trashëgimisë tonë kulturore, mullinjtë e vjetër, panairët e ndryshme, atraksionet turistike janë vetëm disa nga të mirat që ofron qyteti ynë i bukur. Andaj, Komuna e Deçanit me Drejtorinë për Zhvillim Ekonomik dhe Turizëm po kujdesen që promovimi i resurseve turistike dhe informimi i duhur në lidhje me ato që ofron Komuna jonë në fushën e turizmit, të jetë në nivelin e duhur. I tillë është lëshimi i website-it online, në bazë të cilit mund të orientohet secili njeri dhe turist që është i interesuar të dijë sa më shumë për turizmin, atraksionet dhe mundësitë që ofron qyteti ynë.


Komuna e Deçanit është duke punuar rreth zhvillimit dhe ofrimit të shërbimeve turistike dhe mekanizmi i funksionimit të jetë i koordinuar me Qendrën Informuese Turistike. Deri me tani janë ofruar një varg i shërbimeve për të përmbushur të gjitha nevojat e turistëve në periudhën e udhëtimit, qëndrimit në komunën tone, produktet turistik (paketa e nevojshme shërbimi), sfidë mbetën akomodimi numri i vogël i hoteleve dhe bujtinave, struktura e tij përbëhet nga katër elemente:

- Qendra turistike.
 - Transportit.
 - shërbime të akomodimit.
 - Transfer (shërbimi i sigurtuar transportin turistik nga pika e mbërritjes në banesën tuaj dhe anasjelltas).
1. Bjeshkët e Nemuna, janë vazhdimësi e Maleve Dinarike, të cilat shtrihen në perëndim të Kosovës, në veri të Shqipërisë dhe në jug-lindje të Malit të Zi. Këto male me maja të larta e të thepisura hyjnë në radhën e maleve më të “egra” jo vetëm të vendit tonë por edhe të Evropës. Bjeshkët e Nemuna në Kosovë kanë një shtrirje në drejtimin veri-jug me gjatësi 50 km dhe gjerësi 26 km, ku pjesën më të bukur e përbëjnë bjeshkët e qytetit të Deçanit. Nuk mund të shtegëtohet nëpër shtigjet e bjeshkëve të Deçanit dhe të mos mahnitesh nga natyra e egër, e thepisur dhe përthyrjet e shumta të masivit që ofrojnë këto bjeshkë; më tutje takoni trashëgimin etno-kulturore të banorëve të shtigjeve, trashëgimi kjo e ruajtur përmes këngës, gojëdhënave dhe tregimeve. Do të takoni plakun me plis duke ruajtur delet nepër kullosat e bukura të masivit të Bjeshkëve të Nemuna; në një tjetër hapësirë të këtij masivi malor do të vërtetoni Rrafshin e Dukagjinit, i cili mrekullohet me Liqenin e Radoniqit! Për këto dhe eksplorime të tjera, hidhni një hap drejt këtyre shtigjeve! **Foto 1 dhe 2: Bjeshkët e Deçanit**



2. Ecjet në male në Bjeshkën e Bellesë, është produktë tjetër i radhës që dëshmojnë mrekullitë e natyrës, me të cilat jemi begatuar. Ecjet bëhen më të bukura dhe interesante në secilën stinë të vitit ku gjithçka është e bukur në Bjeshkën e Bellesë, e cila shëndritë nën petkun e borës. Pas disa orë ecjeje, në Belle Resort, përveç shijës së kafës, mbrëmjet janë edhe më magjike nën tingujt e zjarrit, në vatrën e turizmit dimëror! Disa gjëra nuk imponohen, ato janë traditë!

Foto 1 dhe 2: Bjeshka e Bellesë



3. Produkti turistikë i shtigjeve përgjatë pjesës së Kullës së Çelisë, lartë në Grykën e Deçanit. Deçani, një destinacion i shkëlqyer i natyrës!

Foto 1 dhe 2: Shtegu përgjatë Kullës së Çelisë



4. Produkti turistikë-Projekt ndërtimi i ZipLine në Deçani, i cili projekt shumë shpejt do të fillojë të realizohet.

Fotot 1 dhe 2: Matjet e terrenit për vendosjen e ZipLine




5. Shtigjet për çiklistë

Komuna është duke zhvilluar punime intensive në lidhje me projektimin e shtigjeve të biçikletave në qytetin e Deçanit. Këto punime kanë arritur në fazën përfundimtare sa i përket pjesës virtuale, duke i paraqitur këto shtigje në platformat më të kërkuara siç është Open Street Map, aty ku orientohen pothuajse i tërë komuniteti bjeshkatar e në veçanti komuniteti i çiklistëve. Kjo nismë përfshinë katër shtigje, të cilat janë emëruar si në vijim:

- Shtegu “Fluturave”
- Shtegu “Liçeni i Dukagjinit”
- Shtegu “Rruga e Gurtë”
- Shtegu “Gushavci”.

Harta 5: shtegu i çiklizmit



6. Gryka e Deçanit

Kjo grykë shfaqet me peizazhe malore dhe atmosferë të qetë. Restaurantet e veçanta në këtë zonë ofrojnë një përvojë të paharrueshme, duke integruar mjeshtërisht elegancën me bukurinë natyrore dhe duke sjellë pamje të mrekullueshme.



Për ata që janë gati të shijojnë më shumë nga Gryka e Deçanit, restaurantet e kësaj zone ofrojnë një gastronomi autentike dhe shije të rralla. Produkte të freskëta dhe të lokalizuara përdoren për të krijuar gatime tradicionale, duke sjellë një përvojë ushqimore që reflekton kulturën dhe traditat vendore.

Pas një dite të shkëlqyer në natyrë, vizitorët mund të eksplorojnë rrugët malore, të marrin pjesë në aktivitete kulturore dhe të shijojnë harmoninë e kuzhinës autentike.

7. Një mundësi e mirë për të vizituar është konsolidimi i **shtegut Via Dinarica**, në Bjeshkën e Madhe në “**Shtegun e Ngjyrave**”, shteg ky i cili do të jetë një ndër shtigjet më atraktive të Bjeshkëve të Nëmuna.

Fotot 1 dhe 2: **Shtegun e Ngjyrave**



8. Kënaqësi të ecësh nga Dervishkomi për në Logun e Prellsh (Maja e Gramarit 2305 m/lmd), pastaj Bjeshkën e Madhe, Livadhin e Margegës, e krejtë në fund; shijimin e ambientit të Kolonia e Artistëve në Podin e gështenjave. **Fotot 1 dhe 2:Dervishkomi**




9. Shtëpinë Bjeshkatore Alpine “Shkëlzen Haradinaj”, Kompleksin Turistik “Fitnete Ramosaj”, Qendra Informuese Turistike dhe shtegu alpinist Via Ferrata dhe Resorti në fshatin Belle janë projekte të themeluara nga programi IPA CBC të mbështetura nga BE-ja. Këto pika turistike ofrijnë të gjitha mundësitë për ta njohur trashëgiminë natyrore dhe kulturore të Deçanit po ashtu është krijuar mundësia për akomodim.

Foto: Kryetari i komunës Bashkim Ramosaj me përfaqësuesin Bashkimit Evropian



Foto:Turizmi- perspektiva e Deçanit



10. Bjeshkët e Deçanit njihen për bukuritë natyrore që kanë. Stina e dimrit u ka dhënë edhe më shumë bukuri Roshkodolit e Milyshevcit, kurse Dervishkomi ofrojnë mundësinë për sporte dimërore veqanërisht të skijimit në rajon. Relevi dhe kushtet klimatike e bëjnë këtë vend ideal për pasionantët e këtij sporti.

Foto: Dervishkomi



Foto 1 dhe 2: Dervishkomi në stinë dimrit



11. Në Deçan, kullat janë të parat që gërshëtohen më së bukuri me ngjyrat e tyre.

Foto 1 dhe 2: Kompleksi i kullave në Dranoc



12. Manifestimi tradicional “Dita e Gështenjës”, manifestim tradicional ku prezentohet tradita, foklori vallet dhe perlat e pikturuara nga piktorë të shumtë me motive kryesisht me natyrë dhe kulturë Deçani; gatimet tradicionale dhe frutat e Bjeshkëve të Deçanit u kujdesen i prezentojnëblegtorët dhe fermerët deçanas.

Foto 1 dhe 2: “Dita e Gështenjës”



12. Bjeshka e Prilepit, ecja drejt Majës së Marijashit 2533m\lmd. Tërheqja e vizitorëve dhe turistëve në bjeshkët e bukura që ka Deçani me rrethinë .

Foto: 1 dhe 2 Bjeshka e Prilepit



13. Shtegu Via Dinarica njëri ndër shtigjet më të bukura malore, ku ecja ka tjetër ndjesi; dhe shtegu të çonë drejt majave më të larta ballkanike!

Foto: Shtegu Via Dinarica



14. Mullinjët janë pjesë e mozaikut të trashëgimisë kulturore të Deçanit, njëherit përfaqësojnë arkitekturën e bukur dhe të lashtë të popullit shqiptar. Njëri ndër mullinjët më të vjetër të kësaj trashëgimie është Mulliri i Mustafë Haxhosaj, i cili gjendet në fshatin Prokulluk, i vjetër rreth 250 vjet. Po duhet të përmenden edhe mullinjtë e tjerë në Deçan, Isniq, Strellcetj. Mullinjtë ka qenë në shërbim të popullit duke shërbyer për bluarjen e misrit; arkitektura e tyre është e ndërtuar nga guri dhe druri në formën e një drejtëkëndëshi dhe me dritare të vogla karakteristike për të gjithë mullinjët!

Foto: Mulliri i Mustafë Haxhosaj në fshatin Prokolluk



15. Atraksion tejet i veçantë është Via Ferrata, një shteg i fiksuar në struktura metalike për të gjithë admiruesit e sporteve ekstreme dhe ngjitjeve në natyrë. Ky atraksion ofron eksperiencë të paparë me pamje 360 shkallë përballë Bjeshkëve të Nemuna dhe pamjes magjepsëse të qytetit të Deçanit. **Foto: Via Ferrata në Deçan**



16. Pikniku pranë Lumbardhit të Deçanit është një mundësi tjetër që ofrohet për të gjithë ata që dëshirojnë të përjetojnë aventura dhe çaste të veçanta rekreacioni. Turistët mund t'i përdorin bicikletat me qira nga Qendra Informuese Turistike - Visit Deçani, dhe të kalojnë një ditë plot emocione dhe pamje mahnitëse në Grykën e Deçanit. **Foto: Pikniku përgjatë Lumbardhit**



17. Kajakimi në Liqenin e Dukagjinit është një përvojë e jashtëzakonshme. Ajri i pastër dhe natyra e bukur bënë të mundur për të kalu një kohë të mrekullueshme në ujë. Ky aktivitet i veçantë kërkon përkrahje të vazhdueshme që ka të bëjë me promovimin e turizmit në komunën tone.

Foto: Liqeni i Dukagjinit



18. Komuna e Deçanit ofron edhe një përvojë unike, është shëtitja nëpër komplekset e kullave, pasi që Deçani njihet si qytet i trashëgimisë arkitekturore. Turistët kanë mundësi të njihen nga afër me traditën, kulturën, zakonet, doket dhe gjithçka tjetër rreth kullave; këtë përjetim lehtësisht mund ta gjejnë të Kulla: Osdautaj, Kukleceve, Gecëve e Demukaj etje.

Foto: Kullat e Deçanit



19. Turizmi me bicikleta ka fillua në vitet e 1990, fillimisht në qendrat urbane. Në komunën e Deçanit, ky produktë tejët i rëndësishëm për eksplorimin e bukurive të kësaj zone turistike.

Foto: Qendra Turistike Informuese



20. Bjeshkët tona po e dëshmojnë potencialin e turizmit në të gjitha kategoritë e sporteve të bjeshkatarisë. Një sport i tillë është ngasja me motor në një terren që të jep adrenalinë dhe kënaqësi të paharruara; ku tjetër përveç se në Pllaqicën e Vokshit mu në zemrën e Bjeshkëve të Nemuna, në shtigjet më atraktive në Ballkan. **Foto: Gara me motor**



21. Territori i Bjeshkëve të Deçanit është i pasur shumë me bimë mjekuse. Duhet të veçohet *Gentiana lutea* apo siç quhet ndryshe *Gentiana e Verdhë*. Një barishte shumëvjeçare e jashtëzakonshme e njohur ndryshe edhe si bima mbretërore ilire që rritet në lartësi 1-2 metra dhe zbukuron peisazhet me lulet e saj të verdha e të gjalla. Kjo bimë alpine po përballlet me kërcënime për zhdukje si rezultat i dëmtimit të habitatit dhe aktivitetit njerëzor që këpusin me rrënjë ekzemplarët e saj për nevoja komerciale. Ta mbrojmë këtë bimë të mrekullueshme dhe të kontribuojmë në një botë plot bimë shëruese.

Foto: Bimë mjekësore



22. Shtegu i çiklizmit Milishevc - Zllonopojë - Gryka e Deçanit - Gushavc - Deçan, është një itinerar i larmishëm, ku përfshinë pjesë të shtruara me asfalt, zhavorr dhe shtigje malore të thjeshta. Për shkak të shtegut me lartësi të ndryshme, duhet të jeni të përgatitur për një ngjitje intensive, por në të njëjtën kohë do të përjetoni një peizazh përrallor.



Pasi të ngjiteni në Bjeshkën e Milishevcit, mund të pushoni dhe të shijoni ushqime tradicionale, çaj me barishte malore në bujtinat përreth, udhëtimin mund ta vazhdoni drejt Grykës së Deçanit. Pas Grykës së Deçanit, zbritni poshtë ujit të thartë në Gushavc, ku mund të freskoheni me freskinë e tij dhe pishave përreth. Sapo të mbërrini në Deçan, mund të gjurmoni trashëgiminë kulturore; shembull Muzeun Etnologjik apo kullat në fshatin Dranoc apo Isniq.

Koncepti i zhvillimit hapësinor për zhvillimin ekonomik në Bjeshkët e Deçanit

Koncepti i përgjithshëm Hapësinor

Ky koncept buron mbi bazën e identifikimit të pozitës gjeografike, resurseve dhe begative natyrore, nxitur nga mundësitë për zhvillim si hapësirë me potenciale të mëdha, përballë një procesi të shtrirjes së balancuar dhe të qëndrueshëm të aseteve në gjithë hapësirën - si i tillë jep ofertën me qenë një Qytet me Vlera të Veçanta. Nisur nga vizioni për të ardhmen, përcaktimi i qëllimeve të kahjeve zhvillimore dhe fokusimi i objektivave në fushën turistike, ekonomike, resurseve njerëzore e gjithë këto duke u interferuar me procesin e shpërndarjes së baraspeshuar, arrihet të koncepti koherent i zhvillimit hapësinor të Komunës së Deçanit.

Turizmi

Si shtyllë e fort e zhvillimit komuna e Deçanit bazohet në potencialet e mëdha që ka qoftë nga aspekti kulturor qoftë nga begatitë natyrore. Përcaktimi për ndërtimin e kapaciteteve të reja në Bjeshkët e Deçanit, zhvillimi dhe avancimi i infrastrukturës në këtë zonë ruajtja dhe kultivimi i objekteve të trashëgimisë natyrore dhe kulturore paraqet ofertën e integruar turistike për një zhvillim të qëndrueshëm afatgjatë.

Bjeshka e Belegut; Qendra turistike Dimërore dhe Verore Bjeshka e Belegut

Realizimi i këtij projekti e futë në funksion potencialin më të madh turistik që e ka Republika e Kosovës në sektorin e Turizmit, duke pas parasysh Qendrën e Skitarisë në Bjeshkën e Belegut, si qendëra më e madhe në Ballkan e më gjerë. Realizimi i këtij projekti, ndikon drejtpërdrejtë në standardin ekonomik të familjeve tona dhe hapë perspektiven e sigurt për mijëra vende të punësimit.

Bjeshka e Belegut; Qendra turistike Dimërore dhe Verore Bjeshka e Belegut (Qendra e Skijimit) me sipërfaqe $S=2270345 \text{ m}^2$ (227 ha) pasuri shoqërore OPPB Kosovodrvo OP Gjeravica ZONA Kadastrale Irzniqi II. Në parcelat më numër”



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada-Government
Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor / Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja / Ministry of Environment and Spatial Planning
 AGENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTRALSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY


Zyra kadastrale komunale / Optinska katastarska kancelarija: Deçan Nr. i njësive kadastrale / Br. katastarske jedinice : 47-0,...

